



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 SHKURT 2024, ora 10:30**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. FEBRUARA 2024. GODINE, 10:30 časova**

**SHKURT - FEBRUAR
2024**

Rendi i ditës

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
2. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
3. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-234 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë për programin e financave publike dhe rritjes ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar,
4. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-236 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve daneze,
5. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-253 për Aderimin e Republikës së Kosovës në Konventën për Importin e Përkohshëm,
6. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-254 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Kosovës nga njëra anë dhe Bashkimit Evropian nga ana tjetër për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e bashkimit programi i tregut të vetëm,
7. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-259 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin “Projekti për forcimin e qeverisjes digjitale për ofrimin e shërbimeve”,
8. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-263 për ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime sociale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës,
9. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-271 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Sekretariati shtetëror për çështje ekonomike për Projektin e “qëndrueshmërisë klimatike në sektorin e ujërave në Kosovë”,
10. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-273 për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), dhe KFW, Frankfurt Am Main, për Programin e energjisë solare I (solar4kosovo I) Fotovoltaik,
11. Votimi i Projektligjit nr. 08/L-281 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare, për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Bashkimit Evropian “Evropa digjitale për periudhën 2021-2027” ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian,
12. Themelimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit
13. Propozimi për zëvendësimin e anëtarëve nga Grupi i VV-së në komisionin parlamentar
14. Votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me nivelin e menaxhimit të marrëdhënies së punës të anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës,
15. Votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në raport me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore,

zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit dhe çdo veprimi e mosveprimi të kësaj ministrie që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti,

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-277 për sport,
19. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile.

Dnevni red

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Izjave van dnevnog reda,
3. Glasanje o N/zakona br. 08/L-234 o ratifikaciji Sporazuma o zajmu za program javnih finansija i ekonomskog rasta između Republike Kosovo i OPEK fonda za međunarodni razvoj,
4. Glasanje o N/zakona br. 08/L-236 o ratifikaciji Sporazuma između Republike Kosovo i Kraljevine Danske za korišćenje kazneno-popravne ustanove u Gnjilanu radi izvršenja kazni izrečenih u Danskoj,
5. Glasanje o N/zakona br. 08/L-253 o pristupanju Republike Kosovo Konvenciji o privremenom uvozu,
6. Glasanje o N/zakona br. 08/L-254 o ratifikaciji Međunarodnog sporazuma između Kosova s jedne strane i Evropske unije sa druge strane za učešće Kosova u programu Unije, programu jedinstvenog tržišta,
7. Glasanje o N/zakona br. 08/L-259 o ratifikaciji Sporazuma o finansiranju između Republike Kosovo, koju zastupa Ministarstvo finansija, rada i transfera, i Međunarodnog udruženja za razvoj za projekat “Projekat za jačanje digitalnog upravljanja za pružanje usluga”,
8. Glasanje o N/zakona br. 08/L-263 o ratifikaciji Sporazuma o socijalnom osiguranju između Republike Kosovo i Kraljevine Holandije,
9. Glasanje o N/zakona br. 08/L-271 o ratifikaciji međunarodnog sporazuma između Vlade Kosova, koju zastupa Ministarstvo finansija, rada i transfera i Vlade Švajcarske Konfederacije, koju zastupa Državni sekretarijat za ekonomiju Poslovi za projekat “klimatska održivost u sektoru voda na Kosovu”,
10. Glasanje o N/zakona br. 08/L-273 o ratifikaciji Sporazuma o finansiranju između Republike Kosovo, koju zastupa Ministarstvo finansija, rada i transfera, Kosovska energetska korporacija (KEK) i KFW, Frankfurt am Main, za program solarne energije I (solar4kosovo I) fotonaponski,
11. Glasanje o N/zakona br. 08/L-281 o ratifikaciji međunarodnog sporazuma, za učešće Kosova u programu Evropske unije “Digitalna Evropa za period 2021-2027” između Republike Kosovo i Evropske unije,
12. Osnivanje Nezavisnog tela za izbor za izbor člana Tela za razmatranje nabavki
13. Predlog zamene članova VV grupe u skupštinskom odboru
14. Glasanje za formiranje Anketne skupštinske komisije o stepenu rukovođenja radnim odnosom pripadnika Službe spoljnih poslova i službenika Ministarstva spoljnih poslova i dijaspore,
15. Glasanje za formiranje Anketne skupštinske komisije o izvršnim odgovornostima Ministarstva pravde u vezi sa sumnjivim požarima u Institutu za sudsku medicinu, nestankom uzoraka u slučaju Astrit Dehari i bilo kakvom radnjom ili nečinjenjem ovog ministarstva koje je narušilo nezavisnost i zakonske odgovornosti ovog instituta,

16. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-249 o izmenama i dopunama Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova,
17. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-289 o Nezavisnoj komisiji za medije,
18. Prvo razmatranje N/zakona br. 08/L-277 o sportu,
19. Izbor jednog (1) člana Tužilačkog saveta Kosova, predstavnika civilnog društva.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

E hapim seancën e re dhe e kemi pasur një kërkesë. Jam lajmëruar qysh para fillimit të seancës që do ta kemi një kërkesë për plotësim-ndryshimin e rendit të ditës të kësaj seance. Urdhëroni, zonja Kusari-Lila, fjalën për plotësim-ndryshim.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Ashtu siç kam informuar edhe sekretarin e Kuvendit, si dhe drejtuesit e grupeve parlamentare, propozojmë plotësimin e rendit të ditës me dy pika, të cilat janë pika që parashihen me një votim të thjeshtë.

E para ka të bëjë me themelimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik. Do të thotë, në pajtim me nenin 53, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të Rregullores së Kuvendit propozojmë plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare të datës 15 shkurt 2024, me këtë pikë të rendit të ditës.

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-92 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-044 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237 dhe Ligjin 05/L-068, Organi Përzgjedhës i Pavarur, i cili interviston, vlerëson dhe klasifikon kandidatët për kryetar dhe anëtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik themelohet nga Kuvendi dhe përbëhet nga tre gjyqtarë të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në takimin e mbajtur në takimin e mbajtur më 8 shkurt 2024 ka emëruar anëtarët e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Prandaj, ju ftoj që ta votoni mocionin për plotësimin e rendit të ditës të seancës së sotme dhe të formojmë Organin Përzgjedhës të Pavarur, i cili do t'u japë rekomandime Qeverisë dhe Kuvendit për emërimin e anëtarëve të OSHP-së. Këtë e propozojmë si pikë të 12-të të rendit të ditës.

Nëse mund të vazhdoj gjithashtu me propozimin tjetër?

KRYETARI: E hedhim në votim këtë fillimisht, pastaj jua japim fjalën prapë, nëse keni plotësim-ndryshime të tjera. Sa jemi? 86 deputetë qenkan të pranishëm.

E shikojmë edhe një herë numrin, i cili na nevojitet për t'u bërë ky plotësim-ndryshim, pastaj e hedhim në votim.

Kjo ishte kërkesa për plotësim-ndryshimin e rendit të ditës, që të përfshihet edhe përzgjedhja e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Të nderuar deputetë,
Kush është për këtë plotësim-ndryshim të rendit të ditës?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

Sa për informim: 58 ishte numri i nevojshëm për të kaluar kjo, 58 duhet.
Na thonë që 84 deputetë morën pjesë, 2 deputetë nuk votuan fare, 63 e votuan për propozimin dhe 21 ishin kundër kësaj.

Kështu që plotësohet rendi i ditës. Pikë e 12-të vendoset kjo.

Urdhëroni, zonja Kusari-Lila, a e keni edhe një pikë tjetër?

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetar!

Plotësimi i dytë, me të njëjtën dispozitë në Rregullore të Kuvendit, ka të bëjë me propozimin për ndryshimin e përbërjes së Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal.

Duke u bazuar në nenin 32 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar ndryshimin në përbërje të këtij komisioni, deputetja Tinka Kurti të zëvendësohet me deputeten Adelina Grainca. Ftoj deputetët që ta votojnë këtë propozim si pikën e 13-të të rendit të ditës në seancën e sotme.

KRYETARI: Pra, është propozim nga Grupi Parlamentar vetëm që të zëvendësohen këta anëtarë. Është procedurë normale kjo në Kuvend, e kemi bërë shpesh. Urdhëro! E hedhim në votim, po! 88 deputetë jemi.

Kush është për këtë propozim, që të përfshihet si pikë e rendit të ditës?
Kush është kundër?
Kush abstenon?

80 për, asnjë kundër, 1 abstenim, kështu që kalon. Kjo bëhet pika e 13-të e rendit të ditës.

Fillojmë me procesverbalin:

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Nëse nuk keni vërejtje në procesverbal, e konsideroj atë të miratuar dhe menjëherë dalim te:

2. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Duam ta bëjmë një përjashtim. Meqenëse sot është Dita e Ashkalinjve, së pari ua japim fjalën atyre, pastaj juve të tjerëve. Ia japim fjalën Bekim Arifit. Urdhëroni, zoti Arifi!

BEKIM ARIFI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zotëri Glauk Konjufca, Të respektuar kolegë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kabinet qeveritar, Zonja dhe zotërinj, Shumë të dashur bashkëqytetarë nga radhët e komunitetit ashkalinj të Republikës së Kosovës e më gjerë, Bazuar në Ligjin për festa zyrtare të Republikës së Kosovës 15 shkurti shënon Ditën Komunitetit Ashkalinj, andaj në kuadër të saj, si përfaqësues legjitim i këtij komuniteti në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më lejoni që të gjithë pjesëtarëve të komunitetit ashkalinj në Republikën e Kosovës t’ua uroj ditën e tyre dhe 21 Dhjetorin, Ditën e Flamurit Kombëtar.

Jam i privilegjuar që përfaqësoj një komunitet të tillë, i cili ka kontribuar në të gjitha proceset shtetndërtuese të vendit tonë dhe vazhdon të kontribuojë edhe sot, si pjesë e pandashme e këtij vendi dhe kësaj shoqërie.

Pikërisht në këtë vend, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, para 16 vjetëve, me shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës komuniteti ashkalinj kishte fatin që të përfaqësohet nga tre deputetë, të cilët përkrahën fuqishëm procesin historik të atëhershëm dhe kishin fatin që të jenë nënshkrues të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Në emër të gjithë komunitetit ashkalinj të Kosovës, faleminderit të gjitha institucioneve vendore, ndërkombëtare, miqve tanë, që na kanë mbështetur dhe vazhdojnë të na mbështesin. Kosova është vendi ynë, e ne të gjithë bashkë jemi Kosova.

Pafundësisht i uroj komunitetit tim në këtë ditë të veçantë, duke u bërë thirrje edhe institucioneve për më shumë mbështetje dhe përkrahje. Faleminderit!

KRYETARI: Urime, edhe një herë, zoti Arifi, për komunitetin tuaj! Kush e merr fjalën nga Lëvizja Vetëvendosje? Kryetarja e grupit, Mimoza Kusari-Lila. Urdhëroni!

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të republikës sonë,

Sot, më 15 shkurt, sikur me çdo datë të 15-të muajit kalendarik, qytetarët e moshës së tretë në Kosovë, afër 150 000 sosh, do të marrin në llogaritë e tyre bankare pensionet e moshës. Nga këta pensionistë 20 000 janë të komunitetit serb, të cilët sikur të gjithë të tjerët do të pranojnë

pensionet në llogaritë e tyre bankare në valutën Euro. Sikurse është e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 11, Republika e Kosovës si mjet të vlefshëm pagese përdor vetëm një valutë, ndërsa Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës është institucion i pavarur.

Po ky autoritet, Banka Qendrore e Kosovës, më datë 27 dhjetor 2023 nxori Rregulloren për operacione me para të gatshme. Nëse mban i mend, e vetmja informatë që nxiti diskutim publik, gati tre muaj më parë, ishte ajo nga neni 37 i kësaj rregulloreje, në të cilin përcaktohej ndalesa për institucionet financiare bankare dhe jobankare që të riqarkullonin kartëmonedhën ekzistuese në vlerë prej 500 eurosh.

Në të njëjtën rregullore, menjëherë pas këtij neni, kreu 7, nenet 38 dhe 39, në të cilët përshkruhet importi dhe eksporti i kartëmonedhave, monedhave euro dhe valutave tjera në Republikën e Kosovës, në të cilin qartësohet përdorimi i euros si valutë e vetme e pagesës dhe mospërdorimi i valutave të tjera si mjet pagese në Republikën e Kosovës në përputhje të plotë me Kushtetutën.

Pagesat për pensionistët e lartpërmendur nga komuniteti serb, të dërguara më herët nga Serbia në dinarë, kesh, lehtësisht dhe pa asnjë vonesë mund të transferohen dhe konvertohen në valutën euro në llogaritë aktive të qytetarëve të këtij komuniteti. Asnjë vendim bazuar në ligj apo në Kushtetutë nuk cenon dhe nuk rrezikon të drejtat elementare të ndonjë komuniteti joshumicë, aq më pak të atyre të komunitetit serb, për të cilin parashihen dispozita të veçanta në Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

E drejta e financimit dhe transfereve të ndihmës nga Serbia në Kosovë parashihet me Ligjin për financat e pushtetit lokal, ligj ky i miratuar që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Ndërsa, për gjashtëmbëdhjetë vjet kjo ndihmë ka ardhur fizikisht, me kamionë të mbushur me thasë me para, të shpërndara derë më derë tek përfituesit e tyre. Në vitin 2024, kur legjislacioni dhe rregulloret po ndryshojnë për t'ju përshtatur parasë elektronike, produkteve të reja financiare online, diskutimi ynë po graviton tek domosdoshmëria e bartjes fizike të parasë. A ka kuptim kjo?

Duke qenë synim lehtësimi dhe mbrojtja e së drejtës dhe mirëqenies së qytetarëve të komunitetit serb, Banka Qendrore e Kosovës më 12 shkurt publikoi edhe planin e veprimit për tre muajt e ardhshëm, në të cilin, në mes tjerash parashihet: lehtësimi për hapjen e llogarive bankare, pezullimi i tarifës për hapjen e degëve të institucioneve bankare dhe jobankare e këmbimoreve, vendosjen e bankomatëve në komunat në veri, si dhe shtatë rregulla të tjera lehtësuese. Me këtë plan veprimi, BQK-ja nuk ka paraparë asnjë masë ndëshkuese, përveç masave lehtësuese të lartpërmendura, me qëllim që qytetarët të kenë qasje sa më të lehtë në financa dhe në shërbime financiare.

Në debatin që është krijuar para dhe pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, është krijuar përshtypja sikur Kosova ka ndaluar qarkullimin e dinarit serb në Republikën e Kosovës. Kjo nuk është e vërtetë, pasi me këtë rregullore dinari mund të posedohet dhe përdoret, sikurse çdo valutë tjetër e huaj në Republikën e Kosovës, pra njëjtë siç përdoret dollari amerikan, funti britanik, leku shqiptar, frangu zviceran, apo valutat e tjera.

Vitin e fundit kemi qenë dëshmitarë të disa veprimeve, të cilat kanë ndryshuar realitetin në terren në veri të vendit. Prej marrjes së targave RKS për të gjitha automjetet, lëvizjes së lirë në gjithë territorin e vendit, faturimit dhe pagesës së energjisë elektrike, shtrirjes së autoritetit dhe funksionimit të ndërmarrjeve publike si: Posta dhe Telekom i Kosovës, hapjes së Zyrës së Regjistrimit të Bizneseve, hapjes së Zyrës së Punësimit për qytetarët atje, investimet në infrastrukturë dhe lirim të hapësirave publike, veprime këto që tregojnë për shtrirjen e autoritetit të shtetit dhe ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët, pa dallim etnie.

Për mirëqenien dhe progresin ekonomik janë ofruar mundësi dhe mbështetje për punësim për dy mijë të punësuar në ndërmarrjet e reja, apo ekzistuese, punëtorëve të të cilave do t'u subvencionohet paga me deri 70% për gjashtë muaj. Veprimet e mekanizmave shtetërorë kaluan jo me pak sfida...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni edhe një minutë, që ta përfundojë fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: ...një numër i të cilave vazhdon edhe sot. Sfidë mbetet ende reagimi i Bashkimit Evropian dhe vënia e masave padrejtësisht ndaj Kosovës, pas shkuarjes së kryetarëve të zgjedhur në zyrat e tyre komunale, në maj të vitit 2023. Sfidë mbetet edhe komunikimi i qartë për veprimet kushtetuese, afatet e veprimit të tyre në zbatimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në veri.

Është e rëndësishme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të kuptojnë që reagimet e miqve dhe partnerëve nuk kanë të bëjnë me parimin e vendimeve të marra, apo me moskushtetutshmërinë tyre, por me shqetësimin për njëanshmërinë e vendimmarrjes dhe mirëqenien e qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë.

Këto shqetësime nuk kanë të bëjnë me orientimin e shtetit tonë. Kosova nuk ka devijuar në asnjë moment nga orientimi paqësor dhe rreshtimi me vlerat demokratike. Ajo asnjëherë nuk ka mbështetur vendet agresore, sikur Rusia, nuk ka rrezikuar demokracinë, apo proceset zgjedhore të brendshme dhe liria e veprimit të shprehjes në Kosovë është e nivelit evropian.

Të gjithë duhet të dinë dhe të kuptojnë se Kosova është vend demokratik...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë në cilësinë e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dua t'ua uroj të gjithë qytetarëve ashkalinj 15 shkurtin, pa Ditën Kombëtare të tyre.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në prag të shënimit të gjashtëmbëdhjetë vjetorit të Pavarësisë së vendit tonë. Kush do ta kishte menduar gjashtëmbëdhjetë vjet më parë, që në 16-vjetorin e Pavarësisë, Kosova do të jetë vend i sanksionuar nga Bashkimi Evropian. Kush do ta kishte menduar gjashtëmbëdhjetë vjet më parë, që në prag të përvjetorit të gjashtëmbëdhjetë të Pavarësisë sonë të marrim kërcënimet më të ashpra nga Qeveria amerikane për shkëputjen e partneritetit tonë, pra me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është e papranueshme dhe është e patolerueshme. Kjo nuk mund të tejkalohet në heshtje.

Pra, sot marrim kërcënime, ashtu siç kemi marrë dy herët e fundit, si në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit nga ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që prezanton Qeverinë amerikane në Këshill të Sigurimit me një qasje mjaft indiferente ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe, siç ishte qëndrimi para dy netëve i Jim O.Brajan, ndihmës sekretar i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kjo është e papranueshme. Ata janë duke kërcënuar direkt Qeverinë e Republikës së Kosovës për shkëputje të partneritetit, por fatmirësisht, jo shtetin e Kosovës dhe jo qytetarët e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk mund të rrimë duarkryq karshi kësaj situatë. Edhe ne si deputetë të opozitës në këtë Kuvend, duhet të marrim përgjegjësitë tona dhe me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kemi në dorë, gjithmonë demokratike, duhet të angazhohemi që t'ia shkurtojmë jetën kësaj Qeverie. Pra, sot i kemi një numër të marrëveshjeve ndërkombëtare. Çfarë kuptimi ka votimi i atyre marrëveshjeve, kur ne po sanksionohemi çdo ditë. Asnjëherë përvjetor më të zbehtë të Pavarësisë nuk kemi pasur. Deri në vitin 2018, në çdo vit, në çdo përvjetor të Pavarësisë, kemi pasur delegacione nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për vizitë në Kosovë për të festuar së bashku me ne kremten e përvjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Është hera e parë, apo mund të them, prej kur kemi ardhur në pushtet, asnjëherë, asnjë delegacion nuk vjen për të festuar ditën tonë, të shtetit tonë, nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pra, vendi ynë nuk e meriton të jetë nën sanksione nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne gjithmonë e kemi parë dhe do ta kemi udhëtimin tonë strategjik së bashku me partnerin tonë strategjik, pra me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo zbehje e kësaj feste po reflekton edhe nëpër ambasadat tona, kudo që po organizohen festat për përvjetorin e Pavarësisë. E kishim edhe para dy netëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut një festë të zbehtë, ku u bojkotua nga shumica e institucioneve shtetërore dhe nga partitë shtetfomuese, pra dhe nga ato shqiptare që janë përfaqësues në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo është e papranueshme dhe nuk mund të degradohet. Kjo festë kaq e rëndësishme, e cila është arritur pas një sakrifice jashtëzakonisht të madhe dhe të gjatë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë të opozitës, sot nuk ka as edhe një kuptim të vetëm t'i votojmë marrëveshjet ndërkombëtare. Duhet të angazhohemi të gjithë së bashku që kësaj Qeverie t'ia shkurtojmë mandatin dhe ta çojmë vendin sa më parë në zgjedhje. Kosovës i duhet Qeveri që rikuperon marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kosovës i duhet Qeveri, e cila e nxjerr Kosovën nga sanksionet. Vetëm vitin e kaluar i kemi humbur rreth 300 milionë euro, pra si rezultat i sanksioneve të Bashkimit Evropian. Edhe sa duhet humbur Kosova në vitin 2024? Pse duhet paguar një çmim, të cilin nuk e meriton Kosova? Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën deputetja Rrezarta Krasniqi.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Janë bërë të plotë tre vjet nga ardhja, kur kjo Qeveri merr drejtimin e shtetit për ta futur atë në një rrugë pa dalje. Për tre vjet qeverisje ky pushtet arriti ta bëjë atë që nuk e ka bërë askush më herët, duke kthyer vendin me dekada mbrapa dhe këtë e bën në shumë drejtime, nisur nga gjendja ekonomike, arsimore, shëndetësi, diplomaci, e çfarë jo tjetër.

Puna, ose më mirë të themi, mospuna e këtij pushteti për tre vjet mund të përkufizohet me tri fjalë: afera korruptive, sanksione dhe dështime të njëpasnjëshme.

Tani, për tre vjet të qeverisjes Kurti dështimet janë më se të qarta, sidomos në fushën e diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, për çka në vazhdimësi ne si opozitë kemi shprehur shqetësimet tona për paaftësinë e kësaj Qeverie për të arritur rezultate konkrete në diplomaci dhe për të siguruar njohje të reja të shtetit të Kosovës. Për tre vjet asnjë njohje, asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare, asnjë takim në Shtëpinë e Bardhë, asnjë takim i rëndësishëm, përveç atyre partiake që i mbajnë në ambasada, ku të gjithë anëtarët e dy partive në pushtet nuk lanë pa u bërë “diplomatë”.

E, vendi sot ndodhet nën sanksione të Bashkimit Evropian nga moskoordinimi i kësaj Qeverie me aleatët tanë ndërkombëtarë, ku janë bllokuar projekte me vlerë prej 295 milionë euro. Disa nga këto projekte të bllokuara janë: 92 milionë euro rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimeve të Prishtinës, 9,95 milionë euro menaxhimi i mbeturinave dhe ekonomisë rrethore, 9 milionë euro menaxhimi i integruar ndërkomunal i mbeturinave në rajonin e Dukagjinit, 7,2 milionë euro përmirësimi i rrjetit të transformimit.

Ndërkohë, çohet dhe del Besnik Bislimi dhe akuzon BE-në se na dëmtoi imazhin ndërkombëtar dhe zhvillimin ekonomik të vendit me sanksionet e vendosura. Pra, përveç sanksioneve, ky pushtet ka dëmtuar edhe marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo kuptohet qartazi edhe nga deklaratimet e tyre publike dhe mesazhet që përcjellin ndaj kësaj Qeverie të papërgjegjshme, nisur nga paralajmërimi i Departamentit Amerikan të Shtetit për kufizimin e avokimit për Kosovën, pastaj deklarimi i ndihmës sekretarit amerikan të Shtetit, të cilit po ia citoj se çfarë ka deklaruar: “Unë nuk do të bëj kërcënime të vakëta publikisht, unë do të thosha se nëse nuk trajtohem si partnerë, edhe ne nuk do ta trajtojmë Qeverinë e Kosovës si partnere”. Pastaj, paralajmërimet e të dërguarit special të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Eskobar, se lëvizjet e njëanshme do të kenë pasoja. Deklarimi i ambasadorit amerikan në Kosovë mbi partneritetin me Kosovën dhe ndikimi negativ, si pasojë e veprimeve të pakoordinuara nga ana e këtij pushteti.

Të gjitha këto paralajmërimet dhe mesazhe që vijnë nga aleatët tanë përbëjnë shqetësime të mëdha për të ardhmen e vendit tonë. Dhe, krejt ky rezultat vjen si pasojë e asaj që ky pushtet e sheh shtetin e Kosovës si diçka të përkohshme. Pra, me këtë mendësi kanë qeverisur dash e sa vjet. E për rrjedhojë, duke abuzuar me pushtetin, këta kanë harruar përfaqësimin e interesave të vendit në skenën ndërkombëtare. Ndërkohë që Gani Jakupi merr pagë mujore 7 500 euro pa bërë asgjë në diplomaci, qytetari i gjorë mezi arrin të kalojë muajin me të hyrat që ka, sepse rritja e çmimeve është e papërbalueshme për shumicën dërmuese të popullsisë.

Është gënjeshtër e kulluar dhe manipulimi me zhvillimin ekonomik, për të cilin flasin drejtuesit e këtij pushteti, sepse realiteti është krejt ndryshe tek qytetarët. A janë përmirësuar kushtet e jetesës për tre vjet për qytetarët? Përgjigjja është e thjeshtë, jo, nuk janë përmirësuar. Përkundrazi, është rënduar më shumë dhe këtë e tregojnë edhe matjet e fundit të bëra për kushtet e jetesës, ku tregohet se mbi 55% të pagës e shfrytëzojnë vetëm për gjëra elementare: ushqim dhe pije, kurse pjesa tjetër nuk mbulon nevojat as për veshmbathje, kur llogariten edhe faturat e shtrenjtuara të energjisë elektrike.

Prandaj, e keqja duhet të ndalet, bashkë me të edhe kjo Qeveri shkatërrimtare, e cila nuk mbahet mend për asnjë projekt apo vendim madhor për qytetarët e këtij vendi, vetëm për dëme të brendshme dhe të jashtme në shumë aspekte. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Po i kthehemi edhe një herë jetës, pra po i kthehemi edhe një herë kërkesës për llogaridhënie ndaj Qeverisë, e cila sot e ka ditën e parë të vitit të katërt, prej kur i ka fituar zgjedhjet. Pra, jemi duke folur për ditën e parë të vitit të fundit të një mandati të Qeverisë Kurti e për të cilën në një demokraci normale duhet të kërkohet llogari, po edhe të bëhet një bilanc.

Ajo që unë do të flas sot në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është kryesisht për çështje që i japin kuptim jetës së qytetarit, për shkak se për tema të tjera, të cilat kanë kërkuar dhe kërkojnë konsensus nacional, duke filluar nga shtrirja e sovranitetit në veri të Kosovës e deri tek raportet tona me fqinjët dhe luftën kundër agjendës armiqësore të Serbisë nuk kemi çfarë flasim, se këtu jemi vërtetuar se nuk kemi dallime.

Po, atëherë ku është dallimi substancial, të nderuar deputetë e qytetarë të Republikës së Kosovës? Në tre vjetët e fundit kostoja e jetës për qytetarët e Kosovës, për secilën ekonomi familjare, si për ata të punësuar edhe për ata që janë të papunë, është rritur në masë dramatike. Pra, për ta thjeshtuar, situata sot, tre vjet pas, është e papërbalueshme dhe si rrjedhojë kërkon që t'i kërkohej llogari kësaj qeverisjeje. Janë ngritur çmimet e energjisë elektrike, janë ngritur çmimet e konsumit publik, është rritur tatimi në pronë, ndërsa pagat, si në sektorin publik, si në atë privat, kanë mbetur të njëjta, përveç disa kategori, po flas këtu për sistemin shëndetësor, në të gjitha nivelet e tjera kanë mbetur të njëjta.

Për tre vjet rresht kjo është agjenda e katërt legjislativë, në mos qofsha gabim është e pesta, se u amendamentua agjenda legjislativë, sillen e pëshillen disa ligje, të cilat veç shtyhen e të cilat nuk krijojnë asnjë efekt në terren.

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kjo Qeveri, ministri i Financave nuk qenka këtu, për dy vjet e nëntë muaj nuk ka arritur t'i ekzekutojë në investime kapitale 1 125 000 000 euro, të dhëna që vijnë prej raporteve të vetë Ministrisë së Financave. Çfarë nënkupton kjo? Kjo nënkupton që gjithçka që lidhet me ekonominë e Kosovës është e dëmtuar, për shkak se investitori kryesor në sektorin privat në Kosovë vjen drejtpërdrejt prej investimeve publike, që i bën Qeveria e Kosovës. Ekonomia, në qoftë se duam, apo s'duam ta pranojmë, është para kolapsit. Sektori privat, ju jeni deputetë të komunave të ndryshme, diskutoni me ta, ka një situatë emergjente, e cila është kah vjen në buzë të një shtete të një katastrofe të shtetit të Kosovës, të një bankrotimi total dhe të një mosreflektimi absolut të Qeverisë.

Po dua të ndalem pak edhe te një temë tjetër dhe me këtë po e përmbyll për sot, për arsimin. A e kuptoni, që ata që i kanë pasur fëmijët e vet në shkolla publike dhe unë fëmijën tim të parë e kam pasur në shkollë publike, e kam edhe të dytin, cilësia, menaxhimi, interesimi për ta ndihmuar këtë sektor, është zero, përveçse kritika dhe targetimi i sindikatave si armik i këtij sistemi. E po e kuptojmë, a duam ta kuptojmë, që Kosova e ka vlerësimin më të ulët në Ballkanin Perëndimor dhe më të ulët në qendër të Evropës dhe ka marrë nga raporti i PISA-s. A e kuptoni që nuk ka asnjë reflektim prej ministres, veç këqyrin me ikë diqysh. Gjithçka që ndodhë, është njëfarë synimi me e zënë arsimin e lartë e arsimit të lartë, në fakt, është i kontrollueshëm, është në sistem.

Të nderuar deputetë, ajo e fundit që po e them është raporti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ka një eksperimentim dhe ka një mungesë të leximit të historisë së Kosovës. Historia e Kosovës i ka tri etapa: etapën e Presidentit Ibrahim Rugova, etapën e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe etapën e mbështetjes së Amerikës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Tani e ka fjalën deputeti Gani Krasniqi.

GANI KRASNIQI: E nderuar kryesuese, zonja nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Siç dihet, shqiptarët e Luginës janë vetëm të përjashtuar nga çdo institucion i pushtetit real ekzekutiv, siç janë të përjashtuar nga drejta ekonomike dhe siguria si fusha kryesore për lirinë.

Thelbi i problemeve qëndron në Kushtetutën aktuale dhe ligjet në fuqi të Serbisë, modeli administrativ territorial i brendshëm si dhe klima e thellë antishqiptare që dominon në elitat e tanishme politike publike në Beograd.

Në kohën kur në Kosovë pakica serbe mbipërfaqësohet në Qeveri, në Kuvend dhe në të gjitha institucionet e tjera publike, shqiptarët etnikë në trojet e tyre në Serbi u nënshtrohen metodave më brutale administrative, përmes të cilave zbatohet spastrimi etnik, forma këto të cilat janë aplikuar edhe në shekujt e kaluar.

Duhet thënë qartë se kurrë në Kosovë pakicës serbe i është garantuar gjuha zyrtare në tërë republikën, shqiptarëve në Serbi u është ndaluar madje me ligj përdorimi i flamurit dhe i simboleve të tjera kombëtare. Derisa në Kosovë pakicave etnike, sidomos asaj serbe, me qëllim të ofrimit të shërbimit administrativ i janë hapur dhjetë komuna, Serbia mijërave shqiptarë etnikë ua ka çaktivizuar adresat atyre atje.

Sa i përket shkollimit, serbët në Kosovë kanë nivelet më të larta të arsimit, ndërsa shqiptarët në Luginë u mungojnë hapësirat shkollore, mësuesit, madje edhe librat në gjuhën shqipe. Madje, nuk u lejohet as t'i pranojnë ato nga Kosova apo Shqipëria.

Si pasojë e kësaj, numri i nxënësve shqiptarë për njëzet vjetët e fundit ka rënë mbi 58 për qind. Derisa në Kosovë, për pakicën serbe janë dy nivele të gjykatave, ajo themelore dhe e Apelit, në Preshevë me mbi 90 për qind shqiptarë, gjykata themelore dhe prokuroria themelore në Bujanoc u janë bartur në Vranjë.

Sa i përket përfaqësimit të shqiptarëve në ato institucione, kjo mund të jetë vetëm një ëndërr e mirë. Shqiptarët në Luginë ballafaqohen me shkelje të përditshme të të padrejtave të tyre...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

GANI KRASNIQI: Është e drejta e ruajtjes dhe e kultivimit lirisht të identitetit, gjuhës, traditës dhe kulturës së tyre. Nga tri komunat shqiptare, shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë autoktone, tani mungojnë pothuajse tërësisht në Medvegjë. Pasi është koha dhe jemi dëshmitarë të angazhimit të aparatit shtetëror serb në pazarin e tij intensiv zgjedhor, që synon të heqë mandatin legjitim të deputetit të vetëm shqiptar përmes numërimit, këto të drejta të kufizuara për ne janë një kontrast i plotë me Kosovën ku serbët kanë dhjetë vende të rezervuara.

KRYESUESJA: Të lutem, ta përmblihdni, për shkak që e kemi kohën e limituar të deklarimeve. Edhe një minutë, edhe të lutem e përfundon.

GANI KRASNIQI: Ata të cilët garantojnë pakicave në Kosovë, kemi të drejtë të bartim obligimet shtetërore dhe kombëtare, të kërkojmë për motrat dhe vëllezërit tanë në Luginë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka radhën deputetja Floretë Zejnullahu.

FLOETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, kryesuese!

Dikur e kishte të ndaluar të hynte në Kosovë, por sot kontrollon shumë nga institucionet e shtetit. Është veç koordinatorë e komiteteve me rol statutor këshillues në Lëvizjen Vetëvendosje, por jep instruksione e diktate apo thënë më mirë, ua thotë troç deputetëve kë të votojnë e çfarë vendimesh të marrin. I përcjell si hije ministrat, u jep detyra deputetëve të zgjedhur nga qytetarët, sulmon mediat, e madje merret edhe me opozitën. Kontrollon skenën publike e politike në Kosovë.

Të dashur qytetarë,

Nuk bëhet fjalë për Mimosën, por për Dejonën. Dejona Mihalini, e cila nuk është ministere, nuk është deputete, madje nuk mban asnjë pozitë drejtuese në Republikën e Kosovës. Absurditet ky që ndodh veç në Kosovën e udhëhequr nga Albin Kurti, i cili mendësinë e tij autoritare për të nënshtruar secilin, e ushtron përmes Dejonës Mihalit, e cila mori shtetësinë e Kosovës në mënyrë dhe shpejtësi të pashpjegueshme.

Kontrolli që ka vendosur Dejona Mihali mbi këtë Kuvend përmes fjalimeve të shkruara e të filtruara, si dhe përmes instruksioneve se kë ta votojnë, tashmë është fakt publik që nuk e mohon askush. Është fjala për zgjedhjen e komisionerit parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Dejona Mihali mbikëqyr, kontrollon e filtron fjalimet që bëhen në emër të Vetëvendosjes brenda e jashtë Kuvendit që nga viti 2010. Nëntoka e vërtetë e Vetëvendosjes është sa e rrezikshme, aq edhe hipokrite. Përderisa Mimosë Kusari, bartësja reale e Dejonës Mihalit, merrej vesh tinëz me Listën Serbe dhe kriminelin Milan Radojçiq për votimin e gjyqtarëve për Gjykatën Kushtetuese, largimin e veteranëve nga paga minimale e kundërshtimin e tërheqjes së Trustit, Dejona shpifte në mënyrë të pafytyrë kundër deputetëve të Partisë Demokratike. Përtej kësaj, Dejona është pjesë e hajnisë e mafisë energjetike në lidhje me Nagip Krasniqin e Martin Berishën e aferës korruptive të keqpërdorimit me rezervat shtetërore.

Pra, në njërin anë kontroll, e në tjetrën anë korrupsion, keqpërdorim e zhvatje të buxhetit të shtetit.

Mua më vjen keq që ju si deputetë të pozitës që keni marrë votë e besim nga qytetarët i dorëzoheni diktatit të Dejonës Mihalit, e cila nuk ka as votë, as besim, as pozitë. Ju që deri dje jeni thirrur në përfaqësim të qytetarëve, sot jeni shndërruar në përfaqësues të Dejonës.

Nëntoka e Lëvizjes Vetëvendosje, Dejona Mihali, që kontrollon Kuvendin, ministrat e ministritë, Ushtrinë e Kosovës, Radio Televizionin e Kosovës, bën lista punësimesh e largimesh nga puna, është pjesë e mafisë energjetike, për ne dhe qytetarët e Kosovës është e panjohur.

Prandaj, dua të shtroj disa pyetje që lidhen me sigurinë nacionale të shtetit. Mbi çfarë baze ligjore i është dhënë shtetësia e Republikës së Kosovës, Dejonës Mihalit? Pse i është dhënë asaj shtetësia nga Presidenca?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Edhe një minutë që ta përfundojë fjalën.

FLORETË ZEJNULLAHU: Cili ka qenë interesi i veçantë ekonomik, social, kulturor, politik apo profesional i Kosovës në rastin e dhënies së shtetësisë? A ka certifikatë të sigurisë dhe a ka

qasje në informatat dhe dosjet e Policisë dhe AKI-së? Në çfarë cilësie ajo merr pjesë në takimet e nivelit të lartë? Bashkë me kryeministrin Kurti takohet me ministrin e Mbrojtjes në një kafiteri në Prishtinë dhe me ministrin e Brendshëm në veri të vendit? Çfarë kombësie kanë prindërit e saj? Pra, kujt i jep llogari dhe për kë punon Dejana Mihali?

KRYESUESJA: Para se t'ua jap fjalën deputetëve të tjerë, të pranishëm tani kemi studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit Mesdhetar në Tiranë, të shoqëruar nga dekani profesor Ksenofon Krisafi dhe profesor Arsim Bajrami nga Universiteti i Prishtinës. Mirë se keni ardhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës!

Tani, e ka fjalën Tinka Kurti, është me kartelë të Yllza Hotit.

TINKA KURTI: E nderuar nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht, të përdorësh foltoren e Kuvendit për të sulmuar njerëz që nuk janë këtu, janë komplet partiak, me ndërtimin e hipotezës dhe mbi anonimizitetin, është totalisht e pandershme dhe e papranueshme. Kurse, marrja e shtetësisë është e rregulluar me ligj dhe personi që u përmend këtu, jeton mbi një dekadë në Kosovë.

Dje janë bërë tri vjet prej revolucionit elektoral që e solli legjislaturën e referendimit dhe Qeverinë Kurti. Në këtë fitore vendimtare ishin gratë. Ndoshta ato e dinin më së miri se çka i duhej dhe çka i mungonte Kosovës. Andaj, Qeveria sot po mundohet të shpaguajë qytetarët e Republikës, për ato çka padrejtësisht u është mohuar më parë, për ato çka realisht u takon. Krahas luftës kundër dhunës ndaj grave, për të cilat institucionet e Kosovës po mobilizohen çdo ditë e më mirë, po zbatohen politika publike të cilat i ndikojnë direkt jetët e grave.

Sot ndahen shtesa për mbi katërqind mijë fëmijë, kurse shtesat për lehonat i kanë marrë mbi 45 mijë gra. Për vitin 2024 janë ndarë gjithsej 95 milionë euro për shtesat për lehonat dhe fëmijët. Kjo masë ka rritur edhe mundësinë për qasje të grave në bankim, pra rreth nëntëdhjetë mijë gra kanë hapur llogari bankare për herë të parë. këto janë masa të reja në Kosovë. Tri vite më parë, familja për fëmijën e lindur nga shteti e merrte vetëm certifikatën e lindjes. Tash mbështetja është institucionale dhe e disaanshme.

Një aspekt tjetër që trajtohet me rëndësi është papunësia. Nëpërmjet platformës SuperPuna janë angazhuar 9 364 të rinj, prej të cilëve, gjysma janë vajza e gra. Kurse, në Kosova Generation Unlimited janë angazhuar 578 vajza me punë praktike, nga 912 në total sa janë pranuar aty.

Përderisa ka ende shumë punë për t'u bërë, për t'u rritur përqindja e grave në institucione e ndërmarrje publike, veçanërisht në pozita udhëheqëse, në bordet e ndërmarrjeve publike dyzet

për qind të anëtarëve të emëruar sot janë gra. Kjo përqindje ta zëmë në vitin 2017 ka qenë vetëm dhjetë për qind.

Sa i përket kohës së studimeve, 1882 janë studente gra e vajza të regjistruara për herë të parë në programet e studimit Stem. Studentet të cilat e kanë përfunduar vitin e parë dhe të dytë të studimeve, kanë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

TINKA KURTI: Një mijë euro në shumë totale prej 1 882 000 euro. Kjo vetëm për vitin 2023 dhe është pra shumë më shumë sesa ishte premtuar.

Ndërkaq, për nxënëset në shkolla, Ministria e Arsimit është marrë edhe me një aspekt tjetër. Për herë të parë, në kuadër të pakos higjienike, Ministria e Arsimit kërkon edhe pajisjen me peceta menstruale falas nëpër shkolla. Për t'i hapur rrugë kësaj, Ministria është dashur ta ndryshojë udhëzimin administrativ dhe tashmë 31 shkolla janë në këtë proces.

Ndërkaq, nga shumë prej grave që kanë kaluar kancerin e gjirit, kishte ardhur një kërkesë ndër vite, që është kërkesa për rikonstruktimin e gjirit për ato të cilat e kanë mposhtur kancerin. Në kuadër të muajit rozë, tetorit, Klinika e Kirurgjisë Plastike për herë të parë në institucionet publike ka filluar me këtë shërbim shumë të rëndësishëm.

Një hap tjetër i rëndësishëm për shëndetin e grave është edhe përfshirja e vaksinës HPV.

KRYESUESJA: Tani e ka radhën Mërgim Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar kolegë deputetë!

Të nderuar përfaqësues të Universitetit të Prishtinës, profesorë dhe studentë,

Të nderuar qytetarë,

Sot duhet të flas për një temë shumë të ndjeshme dhe shumë shqetësuese, që është çështja e invalidëve të luftës së fundit të Kosovës. Fatkeqësisht, kategorive të dala nga lufta, duke theksuar sot në seancë kategorinë e invalidëve të luftës, e kemi parë që nuk gëzojnë respektin dhe mbështetjen e duhur nga Qeveria aktuale.

Gjendja në të cilën ndodhen invalidët është më se e dhimbshme dhe e mjerueshme. Atyre nuk u ofrohet kurrfarë lloj ndihme për të menaxhuar sadopak vështirësitë që rrjedhin si pasojë e kësaj gjendjeje. E tmerrshme që kemi ardhur në këtë pikë, ku atyre personave që sakrifikuan nga vetja

për lirinë e shtetformimin, nuk u ofrohet ndihma e domosdoshme po nga shteti për të cilin vetë dhanë kontribut në të.

Çfarë niveli i ulët duhet të ketë një Qeveri për t'i trajtuar në këtë mënyrë invalidët e luftës. Kjo pohohet edhe vetë nga invalidët e luftës që kam pasur rastin t'i takojë. Por dua t'ju prezantoj edhe konkretisht me disa invalidë të luftës që treguan për pasojat e neglizhencës së tyre. Në këtë fotografi shihet një invalid i luftës, Feim Krasniqi që i ka dhënë gjymtyrët e tij për të luftuar për çlirimin e vendit dhe për të mbrojtur pragun e shtëpisë. Ai sikur shumë ushtarë të luftës çlirimtare, luftoi për të mbrojtur dhe sigurisht që në këtë pjesë disa dhanë jetën e disa humbën edhe gjymtyrët e trupit. Ai tash shihet edhe me këmbën e adaptuar.

Në këtë pjesë me protezë. Në këtë pjesë shihet që edhe neglizhenca e Qeverisë, ku ka pasur pasoja dhe rrezikohet të këpusë krejt këmbën dhe të jetë i paralizuar. Kjo neglizhencë e institucioneve, Feimit mund t'i shkaktojë humbje totale të këmbës dhe të shkaktojë edhe paralizë të plotë.

Sot, Fehimi dhe shumë invalidë të tjerë janë duke vuajtur nga dhembjet e tmerrshme. Nuk ka trajtim dhe ndihmë nga institucionet, e që e kanë obligim ligjor. Tashmë, paramendoni këmbën që e ka dëmtuar nga aparati kriminal serb i Milosheviqit e sot rrezikohet shëndeti i tij por edhe shumë të tjerëve nga vetë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

MËRGIM LUSHTAKU: Sot rrezikohet shëndeti i tij dhe shumë invalidëve të luftës, po nga Qeveria e Kosovës e udhëhequr nga Albin Kurti.

Prej ardhjes në pushtet të Albinit, siç tregojnë disa prej tyre nuk kanë pasur rregullim të protezave, nuk u është mundësuar shërimi jashtë QKUK-së, nuk u është ofruar rehabilitim në banja etj. Nuk kanë pasur as rritje të pensioneve, kur e dimë që kemi një rritje gjigante të jetës ekonomike e sociale në vend.

Andaj, kërkuj që të ofrohet ndihma financiare e t'u mundësohet mjekimi i nevojshëm. Medikamenteve pa pagesë e t'u sigurohet ndërrimi i protezave sa herë që është i paraparë nga komisionet përkatëse.

Besoj që sadopak, edhe pse nuk keni moral në këtë pjesë, e keni obligim ligjor, sepse është e sikletshme kur një invalid i luftës më përpara ndjen neveri të jetojë.

KRYESUESJA: Ka përfunduar koha për deklaram jashtë rendit të ditës Në vazhdim e kemi pjesën e votimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ftoj deputetët që të kthehen në sallë që të mund të procedojmë tutje.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

A marrim pushim? Se nuk po duket që janë marrëveshjet ndërkombëtare afër kështu.

Ministrat s'i pyes, qysh thotë populli "jeni bërë ikail" për pushim, se po punoni shumë.

Në orën 15:00? Shihemi pra në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E vazhdojmë këtë seancë. Konstatoj që prej pikës së 3-të deri në pikën e 11-të nuk kemi kuorum. Janë marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk po më duket që janë kushtet në Kuvend. S'i kemi as 60 deputetë, e lëre më 80.

Konstatoj që të gjitha këto pika, 3 deri 11 t'i barten një seance të radhës, kurdo që ajo mbahet. Nuk kemi kuorum për marrëveshje ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,
Tash kalojmë në pikë e radhës, e cila është:

12. Themelimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Të nderuar deputetë,
Qeveria e Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit për prokurimin publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin përkatës, ia ka parashtruar Kuvendit propozim-vendimin për emërimin e 1 anëtari në Bordin e OSHP-së.

Unë kam kërkuar që nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të propozohen 3 gjykatës për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur. KGJK-ja i ka propozuar 3 gjykatës. Ata do ta përbëjnë Organin Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve për 1 anëtar në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Të nderuar deputetë,
Ata janë: zoti Rustem Thaçi, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës, zonja Naime Ahmeti, gjyqtare e Gjykatës së Apelit, dhe zotëri Shyqri Hoxha, gjyqtar nga Gjykata Themelore e Prizrenit.

Këta duhet të votohen që të mund të bëhen anëtarë të këtij Organi Përzgjedhës të Pavarur. Por, ne duhet të jemi së pari 61 deputetë që kjo të mund të ndodhë, e pastaj e shohim edhe nëse mund t'i marrin votat këta.

Sa jemi, më fal?! 50 deputetë jemi ende. 58 deputetë. 61 deputetë jemi të pranishëm dhe mund të vazhdojmë. E qesim në votim këtë përbërje për Organin Përzgjedhës të Pavarur. 60 mbetëm, sepse 1 deputet doli.

Sa jemi tash, ju lutem?! 73 deputetë janë në sallë. Po e hedhim në votim Organin Përzgjedhës të Pavarur. Për t'u zgjedhur ky organ duhet që 3 anëtarë t'i votojmë. Janë gjyqtarë nga gjykata të ndryshme të Kosovës, Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore në Prizren. Dhe, pastaj këta merren me përzgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të OSHP-së. Këtë detyrë e kanë nëse zgjidhen. E qesim në votim.

Të nderuar deputetë,
Kush është për këtë përbërje?
Kush është kundër kësaj përbërjeje?
Kush abstenon?

Nuk ka kuorum. Vetëm 57 deputetë votuan. S'e votoni ju. Mirë. S'ka kuorum për këtë, mbetet në seancën e ardhshme.

13. Propozimi për zëvendësimin e anëtarëve nga Grupi i VV-së në komisionin parlamentar

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar që Adelina Grainca që të bëhet pjesë e Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, ku do ta zëvendësojë deputeten Tinka Kurti.

Përgatituni për votim. Kush është për këtë zëvendësim? Kush është kundër? Kush abstenon? 64 deputetë e mbështetën këtë zëvendësim. Kështu që, zëvendësimi ndodhë. Asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Zini vendet tuaja, ju lutem! Pika e radhës është:

14. Votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me nivelin e menaxhimit të marrëdhënies së punës të anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Diskutimet i kemi përfunduar më 8 shkurt. Lëvizja Vetëvendosje nuk i ka dhënë anëtarët e vet. E ftojme edhe njëherë Lëvizjen Vetëvendosje që t'i propozojë anëtarët. S'i propozoni ju anëtarët a?! Po, e qesim në votim këtë.

E qesim në votim themelimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar. Kush është për këtë komision? Kush është kundër? Kush abstenon? Vetëm 26 vota i mori ky Komision Hetimor Parlamentar, kështu që nuk themelohet ai. Nuk kemi kuorum, domethënë.

Kështu që, vetëm shtyhet pika. Nuk është që ka dështuar, por mbetet peng për një moment tjetër.

Edhe në pikën e rashës e kemi votimin e një komisionit tjetër:

15. Votimi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar mbi përgjegjësitë ekzekutive të Ministrisë së Drejtësisë në raport me zjarret e dyshimta në Institutin e Mjekësisë Ligjore, zhdukjen e mostrave në rastin e Astrit Deharit dhe çdo veprimi e mosveprimi të kësaj ministrie që ka cenuar pavarësinë dhe përgjegjësitë ligjore të këtij instituti

Edhe për këtë kanë përfunduar diskutime. Këtu i kam unë të gjitha grupet parlamentare që i kanë dhënë propozimet e tyre për përbërjen se kush duhet të jetë anëtar i këtij komisioni hetimor, përveç Lëvizjes Vetëvendosje. A i jepni ju anëtarët? E qesim në votim.

Kush është për themelimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar? Kush është kundër? Kush abstenon? Vetëm 22 deputetë e mbështeten themelimin e këtij komisioni. Pjesa dërmuese e deputetëve nuk morën pjesë në këtë votim, kështu që nuk kemi kuorum për ta themeluar atë.

Pika shtyhet, në kuptimin që bëhet pjesë e një seance të ardhshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kurdo që e cakton atë Kryesia e Kuvendit.

Dalin në pikën tjetër, e cila është:

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar këtë projektligj. Neve na e ka rekomanduar miratimin e tij.

Unë kam kërkuar më 1 gusht të vitit të kaluar që Komisioni i Venecias të jap opinionin e tij sa i përket këtij projektligji, kurse kryetari i Komisionit Funkcional, zoti Adnan Rustemi më 8 shkurt të këtij viti ka kërkuar që ky të përfshihet në rend të ditës për shqyrtim meqenëse tashmë e kemi pranuar opinionin e Komisionit të Venecias për këtë projektligj.

Prandaj, me këtë rast, këtu e kemi të pranishme edhe ministren e Drejtësisë, zonjën Albulena Haxhiu. Ajo e paraqet para nesh projektligjin edhe arsyeton atë. Urdhëroni, ministre!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar ministër Çeku,

Më lejoni që para jush të paraqes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Ky është projektligj bazë për funksionimin e Këshillit Prokurorial, dhe si i tillë, ne si Ministri e Drejtësisë e paraqesim me ndryshime të rëndësishëm përmes të cilave po synojmë që të kemi një Këshill Prokurorial në të cilin dominon pluralizmi, pavarësia, integriteti, transparenca, por po ashtu edhe sundimi i ligjit.

Ndryshimi kryesor në këtë projektligj ka të bëjë me ndryshimin e përbërjes së Këshillit Prokurorial nga një përbërje që aktualisht është e dominuar plotësisht me prokurorë. Pra, 9 anëtarë prokurorë, kryeprokurori i Shtetit dhe vetëm 3 anëtarë jo-prokurorë, në një përbërje permanente të këshillit me 7 anëtarë, 3 prokurorë, kryeprokurori i Shtetit dhe 3 anëtarë jo-prokurorë, e cila do të fillonte së funksionari prej muajit janar të vitit 2026, dhe kjo bëhet me qëllim të eliminimit të njëtrajtshmërisë së mendimeve dhe veprime në këshill, i cili vlerësohet edhe nga Komisioni i Venecias, por edhe nga vetë Gjykata Kushtetuese si korporativizëm, në kundërshtim me standardet e zbatueshme ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Përmes këtij projektligji propozohen gjithashtu kritere shtesë për anëtarë të këshillit, ndër të tjera, që të kenë integritet me aftësi menaxheriale, pastaj rregulla për eliminimin e konfliktit të interesit, publikimin e vendimeve të këshillit dhe aspekte të tjera të ngritjes së transparencës, të drejtën për ankesë të palëve të pakënaqura me vendimet e këshillit, për emërim dhe rrimërim të prokurorëve, si dhe kuorumin për mbledhje të këshillit.

Siç jeni në dijeni, rruga drejt finalizimit të këtij projektligji është përcjellë me diskutime të shumta, qoftë këtu në këtë Kuvend apo në formate të tjera, dhe tanimë për fushën që e rregullon ky projektligj, kemi tri opinione të Komisionit të Venecias, dhe një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.

Madje, opinioni i fundit i Komisionit të Venecias në bazë të kërkesës së kryetarit të Kuvendit, siç e përmendi edhe vetë kryetari i Kuvendit, është miratuar në dhjetor të vitit të kaluar pikërisht për këtë version të projektligjit. Ky opinion ka ritheksuar edhe një herë fuqishëm atë që ne po e synojmë me këtë projektligj, nevojën për reformimin e Këshillit Prokurorial dhe veçanërisht balancimin e përbërjes mes anëtarëve prokurorë, por edhe atyre jo-prokurorë, të cilin e përmenda më herët.

Përbërja e propozuar prej 7 anëtarëve në Këshillin Prokurorial është validuar nga Komisioni i Venecias pasi që është vlerësuar të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, ashtu siç e keni parë që është edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje. Mirëpo, komisioni ka rekomanduar ndryshimin e disa elementeve të këtij projektligji siç janë në veçanti: largimi i përbërjes së përkohshme të këshillit deri në vitin 2026, marrë parasysh vështirësitë që Kuvendi mund t'i ketë të zgjedh një numër të madh të anëtarëve dhe mundësitë tona kushtetuese,

faktin që të gjithë këta anëtarë zgjidhen me shumicë të thjeshtë në Kuvend, ashtu siç e parasheh Kushtetuta jonë.

Pastaj, ndryshimin e formulës së zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë, duke përfshirë më shumë ekspertë në institucione të pavarura në procedurën e Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve joprokurorë.

Qëllimi i Ministrisë së Drejtësisë jo vetëm për këtë projektligj, por të gjitha reformat kyçe të ndërmarra në sistemin e drejtësisë ka qenë gjithnjë që të jemi në përputhje me standardet ndërkombëtare, sidomos me opinionet e Komisionit të Venecias.

Andaj, vlerësoj që pas miratimit sot në lexim të parë të projektligjit të propozuar në komisionin përkatës për legjislacion, mund të bëhen amendamente për t'u siguruar që jemi në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias, dhe ne si Ministri e Drejtësisë ofrojmë vullnetin, gatishmërinë tonë të plotë për të punuar bashkë me komisionin përkatës në finalizimin e këtyre ndryshimeve.

Njësoj kemi vepruar edhe për Projektligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. Pra, pasi Kuvendi ka marrë opinionin e Komisionit të Venecias për Byronë, Komisioni për Legjislacion pas leximit në parim, ka bërë ndryshimet e duhura dhe tashmë ligji është në Gjykatën Kushtetuese pas kontestimit të tij nga një pjesë e opozitës siç është PDK-ja, me shpresën që sa më parë Gjykata Kushtetuese të nxjerr aktgjykimin edhe për Ligjin për Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.

Të nderuar deputetë,

Unë jam e gatshme sot që të diskutojmë për çështjet që adresohen me këtë projektligj, por po ashtu siç e përmenda është shumë e rëndësishme që ky ligj të kalojë në lexim të parë, në mënyrë që pastaj t'i hapet rruga adresimit të opinionit të Venecias për Këshillin Prokurorial, e po ashtu për votimin e tij në lexim të dytë, sepse reforma në Këshillin Prokurorial është jashtëzakonisht e rëndësishme, prandaj kërkoj mbështetjen tuaj për këtë qëllim. Faleminderit!

KRYETARI: Po ia japim tash fjalën kryetarit të Komisionit për Legjislacion. Zoti Rustemi, urdhëroni!

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 74, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20. 7. 2023 e shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 08/L-249 për

ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, dhe Kuvendit i rekomandoi miratimin në parim.

Më 1 gusht, siç e thatë edhe ju kryetar, të vitit të kaluar, ju si kryetar i Kuvendit keni kërkuar mendimin e Komisionit të Venecias për këtë projektligj për t'u siguruar që jemi në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare e evropiane.

Tani kemi një opinion të Komisionit të Venecias, ka rekomandime konkrete të cilat do t'i adresojmë një nga një mes dy leximeve. Andaj, si kryetar i Komisionit për Legjislacion kam kërkuar nga Kryesia që të përfshihet në rend dite dhe të miratohet në parim, në mënyrë që të hapim rrugën e ndryshimeve të këtij projektligji dhe rrjedhimisht të adresimit të rekomandimeve të Komisionit të Venecias.

Besoj që tani do ta kemi më të lehtë, sepse kemi një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje dhe kemi një opinion të fundit të Komisionit të Venecias. Kjo do të na ndihmojë si komision dhe si grup punues për të shqyrtuar nen për nen projektligjin mes dy leximeve dhe trajtimin natyrisht nën rreze në njërin anë të opinionit të Venecias dhe aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në vlerësimin tonë, opinionin është pozitiv i Komisionit të Venecias. E kemi parasysh dhe do ta adresojmë përbërjen e përkohshme të KPK-së, si dhe përfshirjen e Avokatit të Popullit në nominimin e një anëtari, që janë vërejtje lehtësisht të adresueshme.

Andaj, nuk po lëshohem në vërejtjet konkrete apo në përmbajtjen e projektligjit, por natyrisht ftoj deputetët që ta miratojnë në parim, dhe Komisioni për Legjislacion bashkë me grupin punues që do të themelojë, do ta trajtojë me seriozitetin maksimal në adresimin e secilit rekomandim të Venecias, dhe në përputhje me këtë do ta sjellë në seancë për shqyrtim dhe miratim në lexim të dytë.

KRYETARI: Ky ishte raporti i komisionit. Në emër të grupeve parlamentare? PDK-ja e merr fjalën. Hajdar Beqa flet për këtë projektligj.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetari i Kuvendit!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht, sa i përket Ligjit për Këshillin Prokurorial është bërë një eksperiment me ligjin. Gati prej se e ka marrë mandatin kjo ministere, herë ka propozuar të bëhen 7 anëtarë, herë ka thënë 13 anëtarë janë shumë, tani ka thënë të zvogëlohen në 4 anëtarë e të tjera, e të tjera.

Por, unë dua ta nis kështu fjalimin, ministre. Ju po thoni ta mbështetin të gjithë deputetët, të gjitha subjektet politike, me qëllim që të kemi një Këshill Prokurorial funksional efikas edhe të kemi një reformë të thellë në drejtësi.

Si ta besoj që e ke përnjëmend këtë kërkesë kur dje, pikërisht dje në këtë sallë, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka votuar një njëri, i cili ka qenë i angazhuar në fushatën tuaj për anëtar të këshillit. Dhe, ju në një formë apo në tjetrën, apo 2 anëtarë që i keni pasur në garë i keni pasur pjesë të strukturave të partisë të cilën ju sot e udhëhiqni, ministre.

Tash, për cilin ke lobuar më shumë, e di ti. Nuk po flas po, si do të jetë 2 anëtarët kanë qenë pjesë e strukturave të Vetëvendosjes edhe nuk do të ndalemi më shumë.

Ne e kemi një opinion të Komisionit të Venecias, i cili edhe tani, e opinionit të Komisionit të Venecias e hedh poshtë dhe një ndër komentet që e jep apo vërejtjet është përbërja kalimtare.

Është edhe propozimi në të cilin keni menduar që përmes Avokatit të Popullit të keni propozime në Këshill Prokurorial, edhe atë e ka hedhur poshtë Komisioni i Venecias. Unë nuk do të ndalem tani te vërejtjet, por kërkoj prej jush që të mos e ketë të njëjtin fat ky ligj, sikurse e patën plot projekte të tjera paraprake për Këshillin Prokurorial, me të vetmin qëllim që ta keni ndikimin atje, vetëm nëse e kthen prapa edhe njëherë e analizon atë që e thatë më herët, është shumë interesant.

E thatë që atje ne duhet të ndërhyjmë, sepse fatkeqësisht, thatë, në Këshillin Prokurorial janë shumica e anëtarëve prokurorë, e ne tash duhet të ndikojmë që të mos jenë shumica e anëtarëve prokurorë, por të jenë shumica e anëtarëve jo-prokurorë.

Atëherë, qysh mund ta kemi një prokurori funksionale kur njerëzit atje janë jo kompetentë, shumica. Unë mendoj që edhe ata e japin kontributin, sikur ata që shkojnë nga fakultetet e drejtësisë, nga shoqëria civile, e të tjera, e të tjera.

Por, edhe njëherë po kërkoj, ministre, prej jush që të tërhiqni këtë ligj, ta bëni një ligj i cili është me të vërtetë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me të vetmin qëllim, që të mos bëni popullizëm, të mos ua merrni kohën e Parlamentit, sepse unë jam shumë optimist që nëse vazhdon me formën qysh ju e keni propozuar, edhe është e pamundshme që të gjitha ato vërejtje që i ka dhënë Komisioni i Venecias t'i përfshijmë në këtë fazë mes dy leximeve.

Andaj, unë mendoj që prapë Ligji i Këshillit Prokurorial do ta ketë fatin e atyre ligjeve të tjera të Këshillit Prokurorial që i ke bërë apo propozimeve të tjera paraprakisht.

Unë mendoj që nxitimi juaj dhe mos konsultimi me aktorë, na ka sjellë në këtë situatë. Ne e kemi parë edhe më herët se çfarë shqetësimesh ka pasur shoqëria civile. Çka ka deklaruar Lëvizja Fol. Çka ka deklaruar Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhe, plus nuk ka pasur konsultim paraprak me organet kompetente, në këtë rast, me aktorin kompetent, Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Andaj, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike nuk mund t'u përkrahim me këtë qasje në asnjë reformë, sepse nuk ke qëllim reformën. Qëllimi është këtu vetëm te numrat. Edhe vet e thatë, i vetmi qëllim është përbërja. Faleminderit!

KRYETARI: A doni të përgjigjeni ministre, apo të vazhdojmë me të tjerët? Urdhëro! Po! Grupet një herë. E kemi edhe Grupin e LDK-së, edhe të AAK-së. Driton Selmanaj, në emër të Lidhjes Demokratike.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Tani kjo është përpjekja e dytë, po e di edhe ministrja, për ta kapur sistemin, po e thotë vetë se po e di. E kemi pasur Këshillim Prokurorial me 13 anëtarë, kjo ministre e propozoi të kthehet në shtatë anëtarë. Madje, tha me short do t'ua ndërpreme mandatin anëtarëve aty. E dërguam në Komisionin e Venecias, Komisioni i Venecias tha nuk bën kështu, po për çudi, anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje dhe ministrja thoshin “jo, ndryshe po thotë Komisioni i Venecias dhe ne e përmirësojmë”. Unë u thosha mos i hyni kësaj pune se nuk përmirësohet, shkrimi ose letrat që na i kanë dërguar, komentet e Komisionit të Venecias nuk e përmirësojnë këtë proces, por këta thanë “jo kjo kryhet”, edhe e përmirësuan.

Kur e dërguam në Gjykatë Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi krejt. Që i bie nuk jeni duke ditur as t'i lexoni komentet e Komisionit të Venecias, po më vjen shumë keq që po ju them. Tash, kryetar...

KRYETARI: Qetësi, zonja ministre, ju lutem! Do ta keni kohën e mjaftueshme, mos i dekoncentro deputetët.

DRITON SELMANAJ: Nga 13 anëtarë që deshë t'i bëjë 7 anëtarë, tha a t'i shtoj edhe 8, ama ata 8 jo të vijnë prej sistemit, por prej politikës, ne t'i zgjedhim, ju t'i zgjidhni.

Edhe kryetari i Kuvendit, për të cilin shfrytëzoj rastin ta falënderoj, thotë “hajt po e pyesim edhe një herë Komisionin e Venecias për të tretën herë”. Komisioni i Venecias, po të lexohet raporti, besomëni, jemi duke u bërë përrallë me tupan me krejt dynjanë. Shumicën e çështjeve i ka, thotë: “Ju kemi thënë”, jemi duke u treguar që ne s'jemi duke ditur jo të shkruajmë ligje, jo të quajmë ministre të Drejtësisë këtë, por ministre të padrejtësisë. Raporti i Komisionit të Venecias tash thotë “vetëm për numrin e anëtarëve”, Shihni çka thotë në pikën 54, thotë: “Komisioni e sheh teknikën e hartimit të legjislacionit, sidomos të nenit 21, si të pazakontë”.

Ai e përshkruan veten thotë si një dispozitë kalimtare, por në thelb, propozon një përbërje të përkohshme të KPK-së, me rritjen e anëtarëve joprokurorë, e cila shkon në drejtimin e kundërt me destinacionin e synuar të KPK-së, përkatësisht reduktimin e anëtarësisë në shtatë anëtarë. Prandaj, dispozita duket të jetë një ndryshim i përkohshëm dhe jo një dispozitë kalimtare, në kuptimin e zakonshëm të këtij termi. Po, na thotë që ju nuk jeni duke ditur as të shkruani normë, nëse përkthehet ose kuptohet saktë.

Por, për të njëjtën çështje thotë kështu: “Arsyeja e ligjvënësit, për zgjedhjen e kësaj mase afatshkurtër dhe mund të jetë pjesërisht edhe ekonomike. Një Këshill prej 19 anëtarësh, me orar të plotë, në një shtet me më pak se 200 prokurorë, duket tepër i madh, megjithatë nëse kjo është arsyeja, nuk është e qartë se mbi çfarë parimi ligjvënësi propozon rritjen e anëtarësisë në mënyrë kaq dramatike, vetëm për ta ulur atë po ashtu në mënyrë dramatike pas dy vjetësh?”

Domethënë, këtë po e thotë Komisioni i Venecias, jo unë. Domethënë janë duke u çuditur ata, qysh po propozon të rritet për 8 anëtarë, pas dy vjetësh po thua do të zvogëlohen kështu, dhe përgjigjja është e saktë, ata s’po mund të na e thonë, po përgjigjja është e saktë: “Po doni me e kap Këshillin Prokurorial”. Po mos more, se kjo punë nuk shkon kështu, besomëni që kjo është e turpshme çfarë po ndodh. Të na sillni neve deputetëve kësi lloj dokumenti monstrum, po është e turpshme për vendin edhe për ata, të cilët po na përcjellin neve.

Ky dokument e ka veç një shpëtim, hiqe, ministre, merre, dërgoje në ministri, thirre ndonjë jurist aty, nëse ke, thirre le të shkruajnë diçka tjetër, kjo nuk është qasja. Kjo është e tmerrshme, kjo nuk përmirësohet, kot është, silleni në komision sa doni. Unë po e kuptoj tash këtë kjo po thotë kështu, ia kom dërguar komisionit reflektoni ju se Komisioni i Venecias ka thënë kështu, kështu. Nuk reflektohet! Ky dokument çka na kanë thënë ata me dokumentin që na ka ofruar kjo ministri nuk janë në frekuencë me njëra-tjetrën, janë të papërmirësueshme.

Dhe, çka na bëni? Çka na detyroni? E miratoni kështu, ne duhet ta dërgojmë në Gjykatë Kushtetuese, si të vetmin institucion me kredibilitet akoma që ka mbetur në këtë vend dhe shkojmë në zgjedhje, sepse vonohet nja 5-6 muaj dhe ju thoni në fushatë: “Po deshëm ne me ndreq sistemin, por s’na lanë”. Po s’kam qare, sepse kjo është e tmerrshme.

(Ndërhyrje)

Oj ministre, lidhje me reformë nuk ke, për besë, kjo veç reformë nuk është.

(Ndërhyrje)

Veç kur t’ia nis të flasë ministrja për këto gjëra, unë veç t’ia lëshoj atë këngën “Qengji i vogël rri mendueshëm be-be”. Po mos more kështu, hej, jeni duke e demoluar republikën, nuk jeni duke e

parë. Besomëni, që po detyrohem t' ju them këtë, por kjo është e padurueshme. Po ju sugjeroj, nëse nuk keni kopje, po jua bëj unë të gjithë deputetëve të Vetëvendosjes, lexojeni këtë dokument të Komisionit të Venecias dhe ejani nesër flasim për këtë. Nëse nuk e keni lexuar, mos, sepse pavetëdijshtëm jeni duke e demoluar këtë vend. Unë jam i sigurt që s'e keni lexuar, jam i sigurt, 99% të Lëvizjes Vetëvendosje nuk e kanë lexuar këtë raport. Jeni duke e demoluar këtë vend.

Sinqerisht, sa po mendoj nganjëherë, po them, o ndoshta, bre, e kanë një qëllim të mirë diku, sa herë po analizoj, besomëni që jeni duke dalë të tmerrshëm. Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, jo që s'do të bëhemi pjesë e këtij cirku tuaj dhe kësaj agjende tuaj për kapje të shtetit, të sistemit, sepse ashtu e keni lënë që dy vjet vendin pa kryeprokurorë, edhe dy javë bëhen dy vjet pa kryeprokurorë dhe s'jeni të gatshëm as të jepni zgjidhje.

Hajde, s'po doni ta lëni një emër të përveçëm, s'po na intereson ai, por jepni zgjidhje, po s'dini, s'mundeni. Dhe, këtu më flisni për rend dhe ligj, ne kemi interesim për rend dhe ligj, po qysh rend e ligj pa kryeprokurorë! Po, s'e kuptoni, as këtë s'e kuptoni, kryeprokurori është organi kryesor i akuzës që udhëheq me sistemin prokurorial në Kosovë, organi ndjekës dhe ju thirrreni në sundim të ligjit, ndërkohë nuk arrini që ta zgjidhni.

Kryetar i Kuvendit, unë edhe një herë po them të falënderoj për iniciativën për ta dërguar në Komision të Venecias, por po të lus edhe një diçka, le të jetë hera e fundit që i drejtohem Komisionit të Venecias se do të bëhemi horë! Për besë do të bëhemi horë edhe me pyetjet, se jo me reflektimin në dokumente strategjike dhe shumë të rëndësishme për shtetin. Faleminderit!

KRYETARI: AAK-ja, ju lutem, jo, jo, Besnik Tahiri tash. AAK-ja e ka radhën. E jep qëndrimin e grupit.

BESNIK TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Zonja ministre,

Qytetarë të Republikës,

Për ligjin në fjalë, për përmbajtje nuk do të flas, për shkak se kemi folur për këtë temë gjatë diskutimit në Kuvend dhe dihet shumë mirë që kemi pasur shumë mosmarrëveshje në raport me këtë dhe si rrjedhojë, kryetari i Kuvendit, zoti Konjufca, ka vendosur që këtë ligj ta dërgojë për një interpretim në Komisionin e Venecias, po e them edhe prapë po e them, po e ripërsëris, unë mendoj që ne kemi kapacitete edhe profesionale, edhe brenda Kuvendit, edhe jashtë Kuvendit t'i gjejmë vetë defektet që mendojmë janë në sistem, mirëpo kësaj radhe kemi vendosur kështu dhe unë do të reflektoj kryesisht mbi atë se cili ka qenë opinionin e Komisionit të Venecias dhe cili ka qenë reagimi i Qeverisë.

Komisioni i Venecias në opinionin e vet të publikuar më 18 dhjetor të vitit 2023, për Projektligjin e ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës nuk i ka mbështetur ndryshimet e reja sa i

përket rritjes së përkohshme të numrit të anëtarëve të KPK-së, në 19 anëtarë deri në janar të vitit 2026. Ndryshime këto të propozuara me versionin e ri të Projektligjit për KPK-në. Sipas projektligjit, deri më 11 janar të vitit 2026 KPK-së parashihet t'i shtohen edhe 8 anëtarë joprokurorë të zgjedhur me shumicë të thjeshtë në Kuvend, më lejoni pak të elaboroj këtë konstatim.

Pra, të thjeshtësojmë, secila shumicë parlamentare me 61 vota, sot i ka Vetëvendosja, nesër dikush tjetër, mund t'i shtojë tetë anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës në një trupë ku vendoset në prokurori, e që vijnë eksplicit drejtpërdrejt prej gjykimit politik dhe partiak.

Kuptojeni, do të thotë interferenca e drejtpërdrejtë politike në Këshillin Prokurorial të Kosovës është seriozisht e rrezikuar nga secila shumicë parlamentare. Ajo çka dihet është se në opinionet e 18 dhjetorit 2023, Komisioni i Venecias, ndër tjera, ka thënë: “Në Këshill prej 19 anëtarësh me kohë të plotë në një shtet me më pak a më shumë se 200 prokurorë, duket tepër i madh. Megjithatë, nëse kjo është arsyeja nuk është shumë e qartës e mbi çfarë parimi ligjvënës i propozon rritjen e anëtarësimit në mënyrë kaq dramatike vetëm për ta ulur atë në mënyrë drastike pas vetëm 2 vjetësh”.

Pra, çka po thotë Komisioni i Venecias, është a ka mundësi dikush të dalë të japë një argumentim në këtë periudhë kohore pse vëlla po i shtojmë tetë anëtarë më shumë në Këshillin Prokurorial, ku është esenca?

Tutje, më lejoni të lexoj. Komisioni i Venecias nuk e konteston në asnjë moment faktin që ka rrezik të korporatizimit në përbërjen aktuale të KPK-së. Megjithatë, sipas komisionit, shtimi i tetë anëtarëve joprokurorë në Këshillin Prokurorial të Kosovës e rrit rrezikun e politizimit të Këshillit, pasi që këta anëtarë shtesë zgjidhen prej nesh. Pra, të nderuar deputetë, a po e kuptoni çka po thonë? Po thonë, prapë që po e them ju e keni qëllimin e mirë ta reformoni. Vjen një koalicion tjetër dhe vetëm me 61 vota që e bën qeverinë, mund ta ndryshojë Këshillin Prokurorial të Kosovës, pra po e qet në peshore ndikimin politik dhe politizimin e këtij institucioni.

Tutje, se propozimi i Qeverisë ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, strategjinë e sundimit të ligjit dhe vetë opinionin e Komisionit të Venecias, ishte paralajmëruar edhe nga shumë aktorë seriozë të shoqërisë civile, jo nga partitë politike në Kuvend, mirëpo nga Instituti i Kosovës për Drejtësi përmes komenteve, të cilat pak a shumë janë të ngjashme dhe kanë shkuar te Ministria e Drejtësisë në maj të vitit 2023. Analiza dhe komentet e Institutit Kosovar të Drejtësisë dhe Lëvizjes “Fol” janë pothuajse identike me komentet që i ka dhënë Komisioni i Venecias. Kjo është kundërshtia politike, tash më lejoni pak të flas për aspektin e kuorumit.

Komisioni i Venecias në opinionin e fundit ka theksuar se çështja e kuorumit, edhe nëse zgjidhen të gjithë anëtarët e KPK-së, mund të rezultojë lehtësisht në një paralizë totale të KPK-së, pasi që ekziston rreziku i konsiderueshëm i bllokimeve nëse anëtarët joprokurorë, pra tetë anëtarë, të cilët emërohen me vendim politik nga Kuvendi, zgjedhin të mos marrin pjesë në mbledhje. Pra, me një veprim politik, me një pullë politike anëtarët joprokurorë e bllokojnë, se nuk marrin pjesë në mbledhje, kështu që veprimtaria e Këshillit Prokurorial të Kosovës si institucion i pavarur të drejtësisë mund të rrezikohet. Sipas Komisionit të Venecias, për ta eliminuar mundësinë e bllokimeve, është rekomanduar që ligji të parashikojë masa disiplinore më të rrepta dhe më efektive për mospjesëmarrje efektive në KPK.

Më lejoni dhe një element tjetër dhe me këtë po e përmbyll, është elementi i kushtetutshmërisë dhe i komentimit, respektivisht analizave dhe sugjerimeve që janë dhënë nga shoqëria civile. Instituti Kosovar i Drejtësisë dhe Lëvizja “Fol”, në reagimin e vet të bërë më 17 korrik 2023, kishin theksuar se dispozitat e projektligjit të ri për KPK nuk ishin në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, strategjinë e sundimit të ligjit dhe opinionet e Komisionit të Venecias, duke konsideruar se ndryshimet e reja paraqesin drejtpërdrejt rrezikim dhe tentim të politizimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe si rrjedhojë, sipas IKD, këto manovrime ishin vështirë të kalueshme në Gjykatën Kushtetuese, nëse eventualisht edhe ky projektligj i nënshtrohet vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Po i kthehem dhe po e përmbyll me një fjali atë që e thashë edhe më herët, të gjithë ne deputetë të nderuar jemi duke e parë elefantin në dhomë, se elefantin s’ke qysh e sheh, nuk është mizë, është elefant. Të gjithë ne po e shohim që na ka humbur busulla, orientimi, sensi i mendimit racional për të bërë reforma dhe për të bërë intervenime, të cilat duhet të ndodhin në sistemin e drejtësisë. Në qoftë se rritja, në qoftë se ju mendoni se rritja e numrit të bordit, pra të një menaxhimi korporativ është përgjigjja në reformën e sundimit të drejtësisë, unë e them me përgjegjësi të plotë, kjo është vetëm një barrë më e madhe dhe një tendencë për ta politizuar, për ta pasur njerëz, të cilët nuk arrijnë të jenë deri te një institucion si KPK-ja përmes vëzhgimit dhe kontrollit nga sistemi i drejtësisë, mirëpo hyn përmes çelësit politik dhe votimit në Kuvend.

Ju them, unë, për shembull, ne e kemi votuar dje një anëtar të KPK-së, ama kemi votuar, kanë ardhur e kanë thënë po e votojmë, po shkojmë me njërin apo tjetrin. A kemi pasur diskutim të thellë? Nuk kemi pasur, e kemi votuar. Njësoj do të ndodhë me juve, edhe me secilin në Kuvend, do të thotë kemi votuar njerëz, të cilët në esencë do të jenë nën pullën e partisë politike, po në asnjë moment nën udhëheqjen, mbikëqyrjen dhe shtyrjen përpara të reformave në drejtësi.

Faleminderit!

KRYETARI: Adnan Rrustemi në emër të Lëvizjes Vetëvendosje një herë, pastaj ia japim fjalën edhe një herë Qeverisë, ministres, për të gjitha këto që u thanë.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Proceduralisht, jemi në situatën e njëjtë sikurse te Projektligji për Byronë për Verifikim dhe Konfiskim të Pasurisë të Pajustificueshme, kur ishte dërguar në Venecia para miratimit në lexim të parë, e pas opinionit të Venecias jemi kthyer e kemi miratuar në parim dhe natyrisht që jemi zotuar që secilin rekomandim do ta adresojmë bashkërisht në mes të dy leximeve.

E njëjta gjë është, natyrisht, projektligji i propozuar krahas opinionit të Venecias kthehet në Komision për Legjislacion pas miratimit në parim dhe trajtohet dhe adresohet. Por, nga diskutimi që u bë, shikoni domethënë, nuk mund të flasim për zgjidhje të problemeve pa folur për problemin dhe madje debati kryesor duhet të bëhet për problemin, për identifikimin e problemit, për përkufizimin e problemit dhe kur definohet problemi saktë, në rastin konkret në Këshillin Prokurorial të Kosovës, natyrshëm dhe lehtësisht ofron zgjidhje.

U tha këtu që është përpjekja e dytë, po është përpjekja e dytë, more edhe do të jetë edhe përpjekja e tretë nëse është e nevojta dhe e katërt, deri në adresimin e problematikës që sot e ka Këshilli Prokurorial i Kosovës. Por, ama le të flasim për problemin. Në rastin konkret sa i përket asaj që konsiderohet ose jo problem përbërja aktuale e Këshillit Prokurorial, për bindjen time në këtë Kuvend të Kosovës ekzistojnë tri qëndrime, s'po them katër, por tri qëndrime. Qëndrimi i parë, është i sponsorizuesit të projektligjit. Sponsorizuesi me të drejtë konsideron që Këshilli Prokurorial i Kosovës në përbërjen aktuale, korporativiste në kuptimin e dominimit të anëtarëve prokurorë, por përtej kësaj të personave specifike në kuptimin se si është ndërtuar dhe se si janë emëruar, dhe çfarë interesa kanë mbrojtur dhe qysh i kanë shtyrë është një problem real në sistemin e drejtësisë. Këtu nuk ka asgjë, as personale, as politike në kuptimin partiak, por Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka reduktuar angazhimin e vet nga një organ që administron me sistemin le të themi të akuzës në kuptimin e luftimit të krimit dhe të korrupsionit, përgjatë viteve ishte shndërruar në një mekanizëm që mirëmban korrupsionin në Kosovë.

Prandaj, sponsorizuesi konsideron që këtë përbërje aktuale duhet adresuar duke ofruar një zgjidhje. Herën e parë e ka ofruar zgjidhjen më të qëndrueshme duke reduktuar numrin, por natyrisht duke ndërprerë mandatin e një pjese të anëtarëve aktual. Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që nuk mund t'u ndërpritet mandati anëtarëve aktualë për sa kohë nuk përfundon mandati i rregullt. Ndërkohë, që është ofruar alternativa e dytë, gjithmonë në raport me problemin që ekziston që të zgjerohet përbërja në kuptimin e përkohshëm të fjalës, por duke u kthyer në pikën përfundimtare në zvogëlimin e numrit, gjithmonë duke balancuar përbërjen prokurorë dhe joprokurorë.

Qëndrimi i dytë këtu është qëndrimi i Grupit Parlamentar të PDK-së. Këta nuk e konsiderojnë që ka problem në Këshillin Prokurorial të Kosovës, këta konsiderojnë që gjendja aktuale atje është e saktë, e duhur dhe duhet të mbetet. Po angazhohen politikisht vazhdimisht për ta ruajtur dhe

mirëmbajtur atë përbërje aktuale dhe atë mënyrë të funksionimit të Këshillit Prokurorial. Pse po e bëjnë këtë? Unë jam besoj që e kemi të qartë secili, u kanë shërbyer dikur, po duan në një fazë tjetër natyrisht ta përdorin si mekanizëm.

Dhe, qëndrimi i tretë, për fat të keq, është qëndrimi i Grupit Parlamentar të LDK-së, të cilët në bindjet e tyre unë jam i sigurt që ata besojnë që përbërja aktuale e Këshillit Prokurorial është problem. Ata besojnë qartë që përbërja aktuale e Këshillit Prokurorial edhe si strukturë, edhe si individë nuk është e duhur dhe nuk i ka shërbyer luftës kundër krimit dhe korrupsionit në Kosovë, por për arsye krejtësisht meskine politike, të politikës ditore, po përfundojnë duke justifikuar interesin e PDK-së edhe qëndrimin e PDK-së. Këta janë në gjendje ta ruajnë përbërjen aktuale të KPK-së, paçka se pajtohen që është gabim, vetëm për fatin që të mos ketë sukses një, të themi, politikë publike e sponsorizuar nga Vetëvendosja, ose në rastin konkret nga Qeveria.

Është për të ardhur keq, natyrisht mua më vjen shumë keq që zoti Selmanaj, koleg i Komisionit për Legjislacion, e redukton diskutimin tek teknika, le të themi e shkrimit të projektligjit. Nuk është problemi aty, problemi real është përbërja e KPK-së sot, çfarë ka bërë përgjatë viteve? Kujt i ka shërbyer? Cilat janë aktakuzat e nivelit të lartë të adresuara? Pse janë humbur rastet e korrupsionit të nivelit të lartë? Pse janë parashkruar rastet, e tjerë e tjerë. Ky është problemi real, a po do ta adresosh luftën kundër krimit dhe korrupsionit, a po do ta ruani.

PDK qartazi po do ta ruajë përbërjen aktuale dhe ta mirëmbajë gjendjen. Shumë mirë, në rregull është, transparente, gabim është për interesin publik, por po e mbron qëndrimin politik. LDK çfarë po mbron? Çfarë po përfaqëson? Nëse LDK pajtohet që problem është përbërja aktuale e Këshillit Prokurorial të Kosovës, atëherë le të vijë e të ulet dhe të ofrojë opsione për ta adresuar zgjidhjen, por jo vetëm për faktin se po propozohet na qeverisja e Vetëvendosjes, unë e bllokoj dhe e kontestoj çdo element.

Prandaj, domethënë nuk është këtu debati a 7, a 13, a 21, a 25, problemi është se si të kthehet KPK-ja në funksion të mandatit kushtetues dhe ligjor, se si i merr atributet e duhura me njerëz të duhur, me integritet, të pavarur, që as nuk emërohen nga partitë politike dhe as nuk i ruajnë interesat e dikurshme të pushteteve të mëparshme, por e ndajnë mendjen t'i përmbushin detyrat dhe ta luftojnë krimin dhe korrupsionin. Për ne nuk ka asnjë dilemë, me kritika, pa kritika, me opinionin e Venecias, pa opinionin e Venecias, mbas aktgjykimit e para tij, ne do ta çojmë deri në fund këtë punë dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës do të ripërtërihet me përbërje reale e të mirëfilltë, me profesionistë dhe që KPK-ja do të administrojë sistemin dhe organin e akuzës në përputhje me funksionin që ka.

KRYETARI: Këto ishin qëndrimet, urdhëro? A replikë? Replikë me kënd zotin Selmanaj? Me zotin Rustemi? Mirë!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

E para po thuhet që është e njëjta gjë sikur në rastin e Byrosë, nuk është e njëjta gjë. Pse nuk është e njëjta gjë? Sepse, këtu vërtet ju keni dërguar para se të miratohet, por mos harroni që i kemi pasur edhe dy opinione paraprake që ju nuk i keni reflektuar në ligj dhe keni shkelur Kushtetutën dhe s'është rast i njëjtë. Ky është rast, e kemi opinionin e tretë dhe bindja jonë është që me draftin që keni ofruar jeni tash katërcipërisht shkelës të dytë të Kushtetutës.

Në diskursin politik, narrativa që Adnani nganjëherë nuk rezervohet dhe e tepron, nuk ka të bëjnë me atë. LDK-ja e ka vetëm një qëllim: ta mbrojmë këtë republikë si sytë e ballit. T'i mbrojmë pushtetet e ndara, pushtetet, bazën kushtetuese që e kanë, sistemin politik të këtij vendi, sistemin institucional, por asnjë rast LDK-ja nuk mund të bëhet pjesë e asnjë iniciative, kur dikush nga Vetëvendosja thotë "ta çkapim prej një partie tjetër, por ta kapim ne". Jo, jo, hajde ta bëjmë këtë vend një herë e përgjithmonë të jetueshëm dhe me institucione kredibile. Nuk bëhet KPK-ja duke i dërguar tetë njerëz të politikës në KPK, nuk bëhet KPK-ja ashtu. Ashtu domethënë që Vetëvendosja po do ta kapë politikisht përmes politikës Këshillin Prokurorial, jo për t'i ndihmuar atij Këshilli, se ne folëm edhe për veting, mënyrën se si i keni sjellë amendamentet, mënyra se si e keni demoluar dhe deformuar atë proces, s'ka më veting në Kosovë. Ju e keni varrosur procesin e vetingut, duke qenë me 51% të votave, ju sot i keni dhënë vullë që veting në Kosovë nuk ka, sa është Vetëvendosja në qeveri.

Sepse, qëllimshëm e keni bërë këtë dhe jam i bindur për këtë. Po të kishit dashur veting të vërtetë, e kishit çuar një opsion dhe e kishit sjellë këtu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kundër-replikë, urdhëro zoti Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Zoti Selmanaj, e para nëse vërtet e ke në mbrojtje të Republikës dhe interesit publik, eja në Komisionin për Legjislacion dhe e trajtojmë secilën pikë të projektligjit dhe e adresojmë secilin shqetësim. Ne po e trajtojmë projektligjin në lexim të parë, nëse mendon që ka ndonjë element kundërkushtetues, e kemi komisionin, na pret faza e dytë e punës dhe do ta trajtojmë.

Unë besoj që ti nuk do të doje që përbërja aktuale e KPK-së të mbetet në fuqi, sepse e ndan bindjen që ata janë persona të dirigjuar politikisht nga një strukturë tjetër që u shërben atyre e u ka shërbyer dikur atyre. Prandaj, domethënë nuk është këtu çështja e teknikaliteteve, apo po duam ta adresojmë dhe a po duam ta kthejmë KPK-në në funksionet që duhet t'i ketë apo jo? Nëse e ke vullnetin, kthehemi në Komisionin për Legjislacion, në të kundërtën me vetëdije ose pa vetëdije, me qëllim ose jo je duke i bërë argat, le të themi strukturës së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Replikë, veç pak, zonja ministre, se i kemi edhe dy replika. Replika e zotit Abelard Tahiri me Rrustemin.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Vërtet të flasim këta për integritet, është marre, është shumë marre e madhe. Hiç më larg se dje i kemi pasur dy anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët e kemi parë, kemi qenë të detyruar të zgjedhim a po duam një aktivist të Lipjanit që i ka ndihmuar pikërisht kryetarit të Komisionit për Legjislacion në zgjedhje, apo po duam ta votojmë gruan e një analisti që flet çdo natë për Lëvizjen Vetëvendosje në televizion.

Pra, kjo ka qenë ajo që na u ka ofruar dje të votojmë për një anëtar në Këshillin Prokurorial dhe sot ky del flet për integritetin, ky sot del flet për një institucion qysh duhet qenë i pavarur. Po, mos more, se është marre e madhe, është turp i madh. Dje na keni ofruar të zgjedhim një aktivist të Lipjanit apo gruan e një analisti të VV-së, ta dërgoni në KPK.

Këtë e kemi pasur dje në komision, ne nuk mund ta ndryshojmë, sepse jeni shumicë, aty i keni anuluar të tjerët, i keni larguar të tjerët, na i keni sjellë, na i keni imponuar në seancë dy njerëz tuaj t'i votojmë. Tash, ju po lypni integritet, po mos se është marre.

KRYETARI: Jo, një herë mund të kesh kundër-replikë, e më vonë mund ta marrësh fjalën si deputet. Kjo ishte replikë e zotit Tahiri, tash kundër-replikë zoti Rrustemi, nëse do. Hajdari pas kundër-replikës.

ADNAN RRUSTEMI: Do të flas edhe si deputet më gjatë, por megjithatë si kundër-replikë. Dje për fat të keq Kuvendi i Kosovës e ka shtyrë një kandidat dhe aktivist të PDK-së po nga Lipjani, po aktivist të PDK-së, një kryetar nëndege të PDK-së, një person të Hajdar Beqës, i cili ka bërë fushatë më shumë se sa dy javë për t'u zgjedhur, është për të ardhur keq që ky Kuvend i Kosovës dje ka votuar në këtë mënyrë, është për të ardhur keq.

Mbase ndonjë deputetë ka rënë në lajthitje të informacioneve të gabuara, por personi që është votuar dje, është person i PDK-së dhe i Abelard Tahirit, por ama kjo përbërje nuk do të mbetet, unë ju garantoj për këtë gjë. Nuk do të mbetet për sa kohë jemi këtu, nuk do të mbetet një përbërje e tillë, dhe kapja e shtetit a din çfarë presupozon? Presupozon të kesh interesa personale dhe grupe që çon persona aty për t'i ruajtur interesat. Unë s'kam, e as Vetëvendosja s'ka interes të kapë institucionet, sepse s'kemi interesa personale...

(Ndërprerje nga regjia)

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

KRYETARI: Veç pak, zoti Beqa, a ishte replikë a qysh? A po do replikë? Replikë me Adnan Rrustemin, a po?

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Dola në foltore ta shoh në fytyrë Adnanin, i cili del me akuza publike për një kandidat, i cili tash është anëtar i Këshillit, për të cilin jam shumë optimist, pavarësisht çfarë filma bën Adnani sot, ka votuar edhe ky dje. Jam shumë optimist edhe e them bindje, e para.

E dyta, nëse e marrim historikun, nja 2-3 parë zgjedhje më herët edhe Adnani del që ka qenë në PDK, edhe fillimisht edhe në KQZ kur ka shkuar në punë, ka shkuar prej Shukri Bujës, nuk ka shkuar prej Vetëvendosjes, por tash i vyen ndoshta për poenë politike të tregohet këtu i afërt me liderin. Hajde tregomëni edhe ti e Albulena si juristë të zotë që i thoni vetit, sistemet janë ndarë, i kemi: legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin. Ju po mendoni pas situatës tranzitore t'i kemi shtatë anëtarë të Këshillit, katër t'i zgjedhë Kuvendi, dy t'i zgjedhë Këshilli dhe kryeprokurorin, do të thotë legjislativi të ketë shumicën në Këshillin Prokurorial, ku ka balancë këtu? Kjo menjëherë me automatizëm është në kundërshtim me Kushtetutën, edhe kush ta dërgojë këtë në Kushtetuese, e rrëzon. Andaj, mos na humbni kohën, bëhuni të sinqertë me veten, bëhuni të sinqertë me ata që ju kanë votuar, ktheni këtë ligj mbrapa dhe silleni një ligj të ri. Kurse këto akuzat, Adnan, kush i kujt është, përnjëmend edhe një herë s'po të them, po të çelen ato qitapët PDK-ja, të gjen aty si aktivist të mirë, të zëshëm, duke hipur në bandera. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, jo s'ka shkurt, gjatë aty, kundër-replika 1 minutë e ka. Urdhëro, zoti Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Më duhet ta menaxhojë kohën. Hapni çfarëdo qitapi që po thotë zoti Beqa, ama bash çfarëdo, në rastin konkret pavarësisht kushdo që të ishte edhe aktivist i Vetëvendosjes, ai është i padenjë për këtë detyrë. Duhet ta urresh vendin tënd ose të kesh interesa tepër të mëdha që ta votosh një person kaq të padenjë profesionalisht. Ata që e kanë votuar dje, i kanë bërë një dëm sistemit dhe kjo nuk do të mbetet me kaq, unë ju garantoj si kryetar i Komisionit për Legjislacion, nuk do të mbetet me kaq.

Në anën tjetër, ai personi është i PDK-së, ama është i një krahu tjetër të PDK-së, nuk është i krahut të Memli Krasniqit, është i krahut të Hajdar Beqës, Rashit Qalajt, është kundër këtyre tjerëve, ai lufton me këta, a po kupton. Por, ama sistemi i drejtësisë ka për t'u pavarësuar në këtë vend, nuk ka opion, nuk ka alternativë, nuk mundet PDK-ja më të përdorë mekanizma shtetërorë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: E tash m'u ka pështjellë matematika krejt, a mund të më kallëzojë dikush se nuk isha bash në atë moment dje, a mund të më kallëzojë qysh mund të jetë veç i gjysmës së PDK-së e të arrijë të zgjidhet, o vëlla. Hajt Besnik, provo të ma shpjegosh, se nuk e kom bash të qartë.

BESNIK TAHIRI: Qe këtu, kryetar, tash nuk e di a duhet lypur një rizë të qajmë a të qeshim. Qe po ju tregoj pse. Para veç 10 minutash fola për ndikimin politik të përzgjedhjes së anëtarëve të KPM-së që janë joprokurorë. E tash veç shikoni në çfarë shtate ka ardhur Kuvendi i Kosovës, respektivisht Lëvizja Vetëvendosje, po thotë: “Dje në Kuvend të Kosovës është zgjedhur një kandidat i cili është i PDK-së”, e tash unë po ju pyes juve qysh u zgjidh një kandidat i PDK-së kur shumicën e votave i ka VV-ja? A jeni duke e kuptuar pse nuk duhet të rritet Këshilli Prokurorial i Kosovës me anëtarë joprokurorë, se ajo domethënë përvidhen, ata që dinë sistemin, i dinë koalicionet, veç kur e sheh e çon dorën.

Kjo është arsyeja pse të mos mbështetet një rritje, për shkak se qe ju po thoni është një njeri i PDK-së, e unë po ju them ju e keni shumicën, kaq.

KRYETARI: Ti, Besnik, mos i bëj pyetjet e njëjta të miat, por jep përgjigje nëse mundesh. S'ta dhashë fjalën për këtë punë, rri rehat. Po edhe ti veç pyetje po bën, a unë përgjigje po lyp, ngadalë veç pak ku mbetëm? Çka u bë, Bekim? Replikë, a? Me kënd?

(Ndërhyrje)

Po, Besniku, nuk e pati fjalim, Bekim e pati replikë, po s'mundesh replikë në replikë. Qysh të përmendi? Ndoshta të ka përmendur më herët Adnani, a qysh? Replikë, a? Replikë Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Diskutimi që po e nxit Adnan Rrustemi, e që e vazhdoi edhe kolegu Besnik Tahiri, sinqerisht është pashije edhe atë që ndoshta ka ndodhur dje brenda Vetëvendosjes fraksione e grupime të adresohet në subjektet e tjera, edhe të adresohet këtë dhe të degradohet përpjekja për degradimin të një procesi, i cili ka kaluar dje me votat e deputetëve. Nëse Hajdari edhe Rashiti e paskan atë fuqi të madhe të ndikojnë te Lëvizja Vetëvendosje, që e ka shumicën në Kuvend, unë po i ftoj të dytë që të vazhdojnë të punojnë ashtu dhe të krijojnë shumicën, edhe këtë legjislaturë, këtë qeveri ta dërgojmë në shtëpi. Është më mirë të shkohet në shtëpi, më mirë të shkohet në zgjedhje, se sa të dëgjojmë kërcënime të tilla në foltoren e Kuvendit ndaj institucioneve të drejtësisë.

Kur një deputet që as jurist nuk është, e merr guximin t'i kërcënojë institucionet e pavarura të drejtësisë, kjo le që është interferim në sistemin e drejtësisë, po është kërcënim i përsëritur ndaj këtyre institucioneve. Qëllimin që e tha që ne kemi për të vendosur rend e ligj, e kemi parë këtë qëllim fort mirë edhe në rastin e aferës së rezervave shtetërore, edhe rastin e Nagip Krasniqit,

edhe rastin e Martin Berishës, njerëzit e korruptuar vazhdojnë të mbrohen nga pushteti me zell dhe as s'bëhet fjalë këtu për vendosje të ligjshmërisë a të reformës, qëllimi është të mbrohen të korruptuarit që po vazhdojnë ta zhvatin buxhetin e shtetit.

KRYETARI: Adnani e ka përmendur Rashit Qalajn, mirë, replikë!

RASHIT QALAJ: I nderuar kryetar!

Faleminderit që ma dhe mundësinë që të replikoj, edhe pse nuk e dëgjova vetë se çka tha kolegu deputet. Është e vërtetë që dje është zgjedhur një anëtar i Këshillit Prokurorial, një anëtar i cili në zgjedhjet e fundit lokale e ka votuar publikisht deputetin Adnan Rrustemi.

Po, është e vërtetë që deri në vitin 2019 ai ka qenë anëtar i PDK-së, por prej vitit 2019, ai nuk është i angazhuar politikisht, ti e di dhe e dinë që publikisht ka deklaruar që të ka votuar në zgjedhjet lokale. Dhe, është e drejtë e çdonjërit që të votojë kënd të dojë, s'ka asgjë të keqe aty, mirëpo të tentosh ta hedhësh topin diku tjetër është gabim, sikurse është gabim tentativa që bëhet përpjekje vazhdimisht, duke sulmuar Prokurorinë e Shtetit, e tani duke tentuar që numri në Këshillin Prokurorial të rritet, varësisht prej nevojave të partisë në pushtet, që mendoj se është e papranueshme. Mirëpo, prapë po them, çdo qytetar i Kosovës, pavarësisht ideologjive dhe bindjeve të tij, ka të drejtë ta votojë çdonjërin, edhe Adnanin, edhe dikë tjetër, që është krejt normale, s'ka kurrëgjë të keqe, mirëpo vetëm duhet të jemi të kujdesshëm që të mos flasim në adresë të dikujt dhe mos të themi të pavërteta dhe ato që nuk qëndrojnë.

Faleminderit!

KRYETARI: Kundër replikë, zoti Rrustemi, urdhëroni!

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit!

Në rrafshin e përgjithshëm, është e pamundur, është non sens të dihet se për kë ka votuar ose jo, në zgjedhjet lokale. Domethënë, është shumë me rëndësi të definohet kjo gjë, se vota është e fshehtë.

E dyta, edhe mund të më ketë votuar për zgjedhje lokale, por edhe zoti Rashit Qalaj ka mundësi të më ketë votuar mua për zgjedhje lokale, sepse Rashit Qalaj, unë e Rashiti e dimë kontekstin, zoti Rashit Qalaj është kundër strukturës aktuale të PDK-së në Lipjan dhe ai është bashkë me Rashitin kundër strukturës aktuale të PDK-së në Lipjan dhe këta kundër kandidatit të PDK-së në zgjedhjet lokale, po kanë qenë edhe përkrahës të mi. Unë shumë besoj, që Rashiti më ka votuar për kryetar komune. Unë besoj. Domethënë, unë besoj që, madje edhe në zgjedhjet e ardhshme, nëse kandidohem, e nëse nuk e kandidon PDK-ja Rashitin, Rashiti do të më votojë mua, unë jam i bindur për këtë punë. Por, ama, ai është i denjë mbase për votues, por nuk është i denjë për KPK. Edhe Rashiti është i denjë të ta japë votën, se 18 vjet si t'i kesh, ke të drejtë të votosh, ama KPK...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, Rashit, duhet pritur pak, se ishte replikë dhe kundër-replikë. Kur të vijë rendi për fjalë, mund të flasësh. I fundit ka folur Besnik Tahiri, është kryer rendi i grupeve parlamentare, tash ia japim fjalën Qeverisë. Jo, jo, veç pak, Qeverisë, pastaj... Jo, jo, në fillim fjala ishte veç prezantim i projektligjit, debatin s'e ka bërë ende zonja Haxhiu.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Së pari, uroj që zotit Selmanaj nuk i shkon mendja ndonjëherë të më lavdërojë. Pra, po e përsëris edhe një herë, uroj që Driton Selmanajt nuk i shkon mendja ndonjëherë të më lavdërojë. Në momentin që lavdërohem nga Driton Selmanaj, unë e di që s'i kam punët mirë. E di! Prandaj, uroj që nuk të shkon mendja kurrë!

Po ashtu, zoti Selmanaj, unë e di që ëndërron të jesh ministër i Drejtësisë. Nuk besoj që bëhesh! Nuk besoj që bëhesh! Por, megjithatë, nëse ndonjëherë bëhesh, je i lirë ta bësh reformën ashtu qysh ti e konsideron që është e drejtë.

T'u rikthehem çështjeve konkrete. Strategjia për sundimin e ligjit, që është një dokument që është mbështetur unanimisht, në kuptimin edhe të partive politike, edhe shoqërisë civile, edhe të institucioneve të drejtësisë, edhe të partnerëve. Pra, është një dokument që ka mbështetje të gjerë. Kërkon që numri i anëtarëve në Këshillin Prokurorial të ulet, pra strategjia për sundimin e ligjit rekomandon uljen e numrit të anëtarëve të Këshillit Prokurorial dhe për këtë arsye ne kemi nisur reformën në Ligjin për Këshillin Prokurorial, pra për ta ulur numrin e anëtarëve të Këshillit.

Por, duke qenë se në 2021-tën në janar janë zgjedhur shpejt e shpejt anëtarët e Këshillit Prokurorial, madje ju kujtohen deklaratat e partnerëve tanë, madje Ambasada Amerikane e ka quajtur "sistem të prishur" mënyrën se si janë zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial. Ka pasur deklarata të Ambasadës Amerikane, përfaqësuesve të saj, që ky është sistem i prishur, për shkak të mënyrës se si janë zgjedhur anëtarët e Këshillit Prokurorial.

Pra, duke qenë se gjashtë prej tyre e përfundojnë mandatin në vitin 2026, dy në 2025-ën dhe një në 2024-ën, edhe përkundër faktit që ne kishim marrë përgjigjen pozitive nga Komisioni i Venecias për të ndërprerë mandatin e disa anëtarëve, për hir të reformës, Gjykata Kushtetuese, sepse siç e dini, ligjin e kaluar, edhe PDK-ja, edhe LDK-ja, e ka çuar në Gjykatë Kushtetuese. Pra, po rikthehem sërish te ajo që thashë, për reformat në drejtësi është e rëndësishme të jeni të unifikuar, por ama gjatë gjithë kësaj kohe kemi parë një tendencë të vazhdueshme për të penguar jetësimin e këtyre reformave dhe nga kush tjetër, përveçse nga ju dhe jo vetëm, po sidomos nga ju.

Pra, ju e keni shfrytëzuar Gjykatën Kushtetuese për të penguar jetësimin e reformës në drejtësi dhe tani, kur unë shkoj në zgjedhjet, kur shkoj në tubimet për zgjedhjet e ardhshme, kur të më pyesin qytetarët e nderuar Albulenë, pse nuk është bërë reforma në Këshillin Prokurorial? Për besë, Driton, unë nuk mund të gënjej! Nuk mund t'ua them atyre që s'e di pse s'ua bë reforma në Këshillin Prokurorial! Unë ju them që opozita e ka bllokuar. Unë duhet t'ua them atyre të vërtetën.

Prandaj, edhe një herë ju ftoj që të kontribuoni në Grupin Punues të Komisionit për Legjislacion për ta mbërritur reformën në sistemin prokurorial, sepse gjendja në Këshillin Prokurorial është e rëndë. Çdo ditë e më shumë po përkeqësohet. Me votimin e djeshëm në Kuvend është përkeqësuar, është përkeqësuar sepse pazaret për të zgjedhur njerëz pa integritet në institucione shumë të rëndësishme janë evidente. Prandaj, ato filmat e lodhtë të Abelard Tahirit, që kinse ai person është me Vetëvendosjen, po edhe të ishte me Vetëvendosjen, e që nuk është ashtu, njerëzit që nuk janë të duhur për një pozitë të tillë, nuk mund të dërgohen në atë pozitë.

Tjetra, meqë neve Gjykata Kushtetuese nuk na ka dhënë dritën e gjelbër për ta ndërprerë mandatin e disa anëtarëve, ashtu siç na kishte rekomanduar Komisioni i Venecias dhe për ta eliminuar korporatizmin dhe për ta krijuar balancën brenda anëtarëve të Këshillit Prokurorial kemi vlerësuar që e vetmja mënyrë, deri në 2026-ën, është që ta rrisim numrin e anëtarëve në Këshillin Prokurorial. Pra, e vetmja mënyrë deri në 2026-ën ka qenë kjo. Mirëpo, siç u theksua, këtu s'e kemi marrë mbështetjen e Komisionit të Venecias.

Tash, ata që thonë: “Po dëshironi me e kap Sistemin Prokurorial, Këshillin Prokurorial...”, me përbërjen që kemi propozuar, pra me ata tre që i zgjedh Kuvendi dhe katër nga sistemi prokurorial, unë nuk e di a e keni lexuar se si është përbërja e Këshillit Gjyqësor. Përbërja e Këshillit Gjyqësor është kështu: janë trembëdhjetë anëtarë, përbërja e Këshillit Gjyqësor, që është kategori kushtetuese përbërja, për dallim prej Këshillit Prokurorial që është me ligj, pra janë trembëdhjetë anëtarë, gjashtë prej tyre zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës, shtatë nga radhët e sistemit gjyqësor.

Pra, këtu është balanca. Kjo është balanca, gjashtë i zgjedh Kuvendi, shtatë sistemi gjyqësor. Nuk po e dua të kundërtën, veç duhet ta lexoni ligjin. Shtatë, tre i zgjedh Kuvendi, katër sistemi prokurorial. Lexoje ligjin, Hajdar, se s'mund të ta lexoj! E ke përpara, ta kam sjellë, lexoje vetë, mund të ta shkruaj, por jo të ta lexoj. Lexoje vetë, e ke përpara!

Prandaj, mos manipulo në foltore të Kuvendit, sepse dëgjova që the se po do të krijosh balancë duke e rritur numrin e anëtarëve joprokurorë, kjo nuk është e vërtetë, kjo nuk është në projektligj. Kjo është shpifje. Prandaj, kur ta marrësh fjalën si deputet, fol asht siç është projektligji, mos manipuloni e mos shpifni!

Edhe një herë, po rikthehem te problemet në Këshillin Prokurorial. Vetëm së fundmi ka pasur pazare për emërimin në pozita të larta të sistemit prokurorial. Sikur ta kishim Këshillin Prokurorial në nivel të detyrës, nuk do të kishim pasur nevojë për vetingun në sistemin e drejtësisë, sepse është Këshilli si mekanizëm që e përmirëson sistemin prokurorial, është Këshilli si mekanizëm që përmes mekanizmave të disiplinon prokurorët, të cilët i kanë shkelur detyrat e tyre si prokurorë, mirëpo këtë s'e kemi. Këshilli Prokurorial i ka mbyllur sytë përballë shkeljeve të prokurorëve.

Është e vërtetë, ka shumë prokurorë që janë të mirë, por fatkeqësisht në pozita të larta janë ata, që e kanë mbytur sistemin prokurorial. Prandaj, është e rëndësishme reforma e vetingut, prandaj është e rëndësishme reforma në Këshillin Prokurorial dhe prandaj nuk do të heqim dorë asnjëherë nga kjo reformë, pavarësisht interesat e kujt mund t'i prishim. Faleminderit!

KRYETARI: Kemi disa replika. Tash së pari ia japim fjalën Hajdar Beqës. A je për replikë, Hajdar? Urdhëro!

HAJDAR BEQAJ: Unë fillimisht i them ministres, e ke obligim dhe paguan një staf të madh për t'i lexuar të paktën rekomandimet e Komisionit të Venecias. I kemi tri rekomandime dhe jam shumë optimist që s'e ke lexuar asnjërin. Kurse, sa i përket Këshillit Gjyqësor, është kategori kushtetuese, është numri i përcaktuar me Kushtetutë dhe kështu kot flet se nuk mund të bësh asgjë në atë temë.

Kjo krejt çfarë ke bërë ti, këto fizkulturat tuajat, në emër të reformës në drejtësi, është herë të rritet numri, herë të zbresë numrin, me të vetmin qëllim të kesh interferim në Prokurori, ministre. Më vjen keq, ti bile të flasësh për shpifje, nuk kisha thënë, se në njëfarë forme e ke patentën e shpifjeve. Nuk po të them diçka personale, s'po hyj, po bëhu e sinqertë para opinionit. Kurse, unë nuk kam çka të them më shumë, ky ligj nëse vazhdon në këtë formë, qysh e ka sjellë ministrja, e ka fatin e ligjit paraprak, apo propozim-ndryshimeve paraprake, sepse këta me këtë propozim, edhe një herë po e përsëris, e ndryshojnë balancën e shtetit, në mes tri pushteteve, legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Këtë pyesni juristët, po ju po flisni vetëm me ata juristët që ju dëgjojnë.

Kurse, e pata vetëm edhe një fjalë me zotin Rrustemi. Unë nuk e kam ditur se zoti Rrustemi është zëdhënës i Partisë Demokratike, të ka pushuar mandati edhe nëse ke qenë ndonjëherë në nivel dege. Mund të rikthehesh, po flasim pastaj në bazë të kontributit ta japim, në bazë të sistemit të meritokracisë, por ti nuk je këtu të tregosh, a ky grup, a ai grup. Unë po ndihem mirë, nëse përnjëmend Vetëvendosja paska votuar, qysh ka thënë një deputet i Partisë Demokratike.

Unë, edhe një herë ta bëj të qartë për opinionin publik, në komision nuk i kam votuar asnjërin kandidat, kam votuar kundër, unë dhe Blerta. Adnani ka propozuar dy kandidatët që i keni votuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, po, ke mundësi kundër-replikë, natyrisht. Fillimisht, ia japim fjalën zotit Rrustemi për një kundër-replikë me zotin Beqaj.

ADNAN RRUSTEMI: Këto dy nominime për KPK janë nga universitetet. Dy universitete, i Prishtinës dhe i Prizrenit, i kanë bërë dy nominime dhe komisioni me automatizëm ex-officio i sjell në seancë, as nuk i trajton, as nuk i interviston dhe as nuk i vlerëson. Po e përsëris, personi në fjalë është i PDK-së, po është e vërtetë, i një krahu të caktuar të PDK-së kundër një krahu tjetër. Ai edhe mund të më ketë votuar në zgjedhje lokale, por kjo nuk flet asgjë. Është person i Rashit Qalajt, sikurse Rashiti është kundër strukturës aktuale të PDK-së në Lipjan.

Edhe, e di, madje në Kuvend edhe kemi biseduar bashkërisht me të për zhvillimet lokale në Lipjan. Ata nuk po e lënë të bëhet kryetar dege, dhe natyrisht ky bashkë me grupin e tij janë kundër. Por, zotit Beqaj vetëm një gjë po i them, mos ta krijojë vetëbesimin që sistemi i drejtësisë nuk do ta përmbushë punën. Byroja për verifikim dhe konfiskim të pasurisë do të bëhet, pasuria e pajustificueshme do të verifikohet dhe do të konfiskohet dhe sistemi i drejtësisë do të bëhet i pavarur dhe secili rast do të trajtohet.

Të mos mendojë që në ditën e djeshme ju ka krijuar, mbase përshtypja që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja Haxhiu, a e patët edhe ju një replikë? Urdhëro!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Vetëm dy çështje shkurtimisht.

E para, është mirë të mësohesh të kërkosh falje. Nuk është kurrë gabim të kërkosh falje, kur gabon. Edhe unë, kur gaboj kërkoh falje. Është shumë njerëzore. Prandaj, ju thatë një deklaratë, e cila nuk është e vërtetë, u binde. U binde! Në raport me përbërjen e Këshillit Prokurorial, prandaj nëse s'është ashtu, të paktën kërkoh falje.

E dyta, se sa e rëndësishme është reforma në drejtësi, unë e di sidomos kur vij në këtë Kuvend, sidomos kur i shoh disa figura që veç në Kuvend nuk e kanë vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, jo, kundër-replika s'ka më. Kundër-replikë ishte kjo, e jotja ishte replikë, Hajdar. Jo, ky të ka përmendur, Rashit, në kundër replikë. Tash e ke, jo, jo. Replikë po do zoti Selmanaj, me kënd? Me ministren? Urdhëro, zoti Selmanaj, replikë!

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Për t'i treguar ministres dhe të tjerëve, po të kisha dashur të bëhesha ministër i Drejtësisë, do të isha bërë shumë lehtë, por e kam zgjedhur një pozitë pak më lart, zëvendëskryeministër, edhe kam pasur shumë rol edhe në Ministrinë e Drejtësisë.

Por, t' ju them të drejtën, edhe kur kam hyrë zëvendëskryeministër, edhe kam hyrë në politikë, edhe kam dalë prej Qeverisë, pa hipoteka. As s'e kisha Dalladakun, as s'e kisha teledirigjuesin, dikush me SMS të më... Jam Driton Selmanaj me integritet, aq sa kam dhe si mundem. Por, diskutimet që i bëri Adnani deri tash janë shembulli konkret, që absolutisht duhet larguar prej gjithçka që lidhet me politikën duhet larguar prej KPK-së. Pazarxhinj, pazarxhinj, "jo imi, jo yti, jo ky, jo me neve, jo me atë..." Njëjtë, i nderuar kryetar, është votuar Nikolla Kabashiqi prej Lëvizjes Vetëvendosje si rezultat i pazareve me Listën serbe. Nikolla Kabashiqi ka qenë negociator në anën e Serbisë, kur kemi diskutuar me neve, ju e keni votuar për anëtar të KGJK-së.

Prandaj, pazaret politike janë të dëmshme. Dhe, ne, për një person deri tash që kemi diskutuar, sa problem u bë. Po tetë, që po do, ministre? Tetë po thotë t'i zgjedhë Parlamenti. Dhe, nëse shkojmë me këtë logjikë, gjithmonë do të ketë njerëz që do të gjejnë edhe deputetë te ne, edhe nja 17 te ju dje, edhe te PDK-ja. Prandaj të largohemi nga sistemi prokurorial sa më shumë që mundemi. Edhe nëse janë keq, të provojmë t'i përmirësojmë me mekanizma brenda tyre, jo duke i zëvendësuar me militantë të paskrupujt politikë. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, ministrja, një minutë!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Zoti Selmanaj,

Për një moment paskam harruar krejt që ke qenë zëvendëskryeministër. Domethënë, aq paska qenë roli yt në atë Qeveri, sa që fare nuk e mbajta në mend që ke qenë zëvendëskryeministër. S'ka më keq, se ta marrësh një pozicion e të mos mbajë në mend kurrkush për kurrjë.

KRYETARI: Kundër-replikë, zoti Rrustemi.

ADNAN RRUSTEMI: Zoti Selmanaj,

Ne duhet t'i mbajmë duart larg Prokurorisë dhe sistemit të drejtësisë atë ditë kur ta krijojmë një sistem të drejtësisë të pavarur dhe të paanshëm. Nuk mund të qëndrosh indiferent për sa kohë e ke sistemin të kapur e me elemente të inkriminuara. Në anën tjetër, për këtë Nikollën që po e përmend, unë nuk po e njoh, mbase ty të ka rënë ta takosh edhe në dialog. Por ama, ju e dini që

anëtarët nga komuniteti serb, edhe në KGJK, edhe në KPK, kanë procedurë të veçantë të votimit dhe votohen nga pjesa e deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara në Kuvend. Nuk është. Komisioni e ka formale procedimin për në seancë. Askënd s'e kemi votuar, nuk është e vërtetë.

KRYETARI: Jo, jo, u krye cikli. Zotit Selmanaj do t'ia jap, kur t'i vijë rendi i fjalës. Ka të drejtë edhe një herë të flasë.

(Ndërprerje e incizimit)

Mirë, një minutë për zotin Selmanaj dhe mbyllet cikli, e pastaj kalojmë te fjalimet e tjera.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Duhet të kemi kujdes pak me gjuhën.

Nikolla Kabashiqin, ti Adnan, as në negociata, as kurrkund s'e kam takuar, por në CV-në që e ke lexuar ti, ai e ka shkruar që ka qenë pjesë e ekipit negociator dhe unë ju kam thënë juve në komision, të mos e çojmë se ky paska qenë në anën e tyre. Dhe, këta e kanë votuar në komision, e keni votuar dhe këtu. Ju e keni votuar edhe këtu, sepse i keni pasur në atë kohë punët mirë me Radojçiqin. Ama, çdo gjë tjetër... mos hyni në atë pjesë.

E dyta, çështja që po thotë ministrja, shtatë anëtarë, katër janë nga prokurorët dhe tre nga politika. Është e vërtetë, ama kuorumin e keni bërë me pesë anëtarë, kuorumin për vendimmarrje me pesë anëtarë, që i bie gjithmonë njeriu i politikës e bllokun vendimmarrjen. Lexojeni ligjin! Edhe pse, keni menduar katër me tre, përsëri kuorumin pesë, jo katër, sepse po doni ta pengoni vendimmarrjen aje.

KRYETARI: Vazhdojmë sipas rendit. Mendoj që PDK-ja është tash në radhë. Është Rashit Qalaj, pastaj Doarsa Kica-Xhelili.

RASHIT QALAJ: Kryetar, po e shfrytëzoj të drejtën e fjalës për t'i replikuar kolegut Adnan.

Të nderuar deputetë, meqenëse ne dje kemi pasur dy kandidatë, zonja Pozhari, e cila nuk është e ngjyrosur politikisht e që s'i takon asnjë partie politike, kështu do ta kishit arsyetuar ju. Po, e dinë, jo vetëm deputetët e këtij kuvendi, kush është zonja Pozhari. A është anëtare e LDK-së, apo e PDK-së, e Vetëvendosjes, apo është neutrale. E dini mirë secili që është këtu dhe çdo qytetar që është duke shikuar.

Atë brengën, Adnan, që i shprehe për Partinë Demokratike të Kosovës, faleminderit shumë! Na e ke bërë një të mirë bukur të madhe. E di që po të ishe në PDK ende, po ke dalë, edhe nuk je as në KQZ prej PDK-së, po ke dalë, besoj që do të kishim bashkëbiseduar diku tjetër, jo këtu, për këto probleme.

Po të ishte në PDK, thashë. Por, problemi është, zoti Rrustemi, që, edhe unë, edhe ti, shpesh jemi në një lokal në Lipjan, ku ka qëndruar edhe zoti Vuliqi. Meqenëse, pak a shumë Lipjani është i vogël dhe gati edhe nuk ke ku të shkosh, përveç nja katër-pesë lokaleve që ka. Dhe, e di fare mirë që ai ka vite që nuk është i angazhuar politikisht dhe po të ishte kushdo tjetër, zoti Rrustemi, nga Lipjani, apo nga Ferizaj, unë do ta votoja. Kushdo tjetër, bash s'më intereson partia hiç. Pra, po e them, po e përsëris, kushdo tjetër të ishte nga Lipjani, apo nga Ferizaj, unë do ta votoja, edhe dje, edhe nesër, edhe pasnesër. Po, jam pak lokalist, është e vërtetë.

E vërtetë që jam lokalist, po do ta votoja dhe s'do të pyesja fare kah është, a në LDK, a në PDK, apo në Vetëvendosje. Do të kemi votime edhe në të ardhmen, bjereni këtu dikë nga Lipjani, ose nga Ferizaj, shiko a po e votoj a jo. Dhe, besoj që është një mësim që duhet t'ua jap.

Sa u përket problemeve të PDK-së dhe këto që ju po i diskutoni... *(Ndërhyrje)*

Më fal, a bën... jam duke folur! Prapë merre fjalën, bisedojmë, i lodhim krejt këta që janë këtu, mirëpo mos u shqetëso shumë... Besoj që është çështje muajsh kur do të matemi në zgjedhje, besoj qendrore, dhe një vit e ca ka kur do të matemi prapë në zgjedhje lokale dhe do të shohim se si do të shkojnë punët.

Çështja, ne e kemi një kryetar të partisë, është zoti Memli Krasniqi, dhe këtu te deputetët nuk ka krah, që ishe munduar ta ndash në grupe, grupi i Hajdar Beqës dhe Grupi i Rashit Qalës. Po më vjen mirë që qenkam bërë njëfarë faktori, që po vendossha për të zgjedhur dikë në Këshillin Prokurorial! Por, nuk është ashtu. Meqenëse, i nevojitet bukur shumë kësaj opozite të bashkuar, shumë vota i duhen për ta zgjedhur dikë dhe besoj se ato vota janë këtu në qendër, se s'keni mundur t'i merrni nga jashtë, janë nga ju, se a të ka votuar apo jo zoti Vuliqi, pyeteni edhe këshilltaren e ministres, që është nga Lipjani, pyeteni. Pyeteni sekretarinë tënde në Lipjan, të Vetëvendosjes, i di me emra, mos t'i përmend. Nëse do, edhe me emra t'i përmend. Dijeni që, kur ta akuzosh dikë të jeni të kujdesshëm.

Ndërsa, sa u përket interferimeve në Prokurori, po shihet në çdo fjalim që e bëni, për çdo arrestim që është bërë, për çdo veprim që ka bërë Prokuroria e shtetit e që është në raport me ndonjë individ nga Lëvizja Vetëvendosje, gjithmonë e keni kritikuar, e keni kërcënuar këtu, nga kryeministri e tutje, dhe mendoj që edhe vetingu si i tillë, edhe pse unë jam gjithmonë pro vetingut në të gjitha nivelet, s'ka diskutim, mirëpo edhe vetingu si i tillë e çon një mesazh se përse duhet të bëhet.

Ndërsa, prapë po e përsëris, merruni me Lëvizjen Vetëvendosje, merruni me raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e kurseni partitë e tjera, sidomos PDK-në, se ka kush mërzhitet për atë punë.

KRYETARI: Replikë!

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit shumë, kryetar!

Natyrisht që më vjen keq për deputetët që po e ngarkojmë debatin edhe me zhvillimet politike, sidomos lokale. Por, unë jam shumë i singertë dhe ato çfarë kam thënë janë të vërteta plotësisht.

E para, kjo loja me dimensionin lokal, se kushdo që të ishte nga Lipjani do ta votoja, pavarësisht kushteve, kritereve e cilësisë, është shumë gabim. Unë do ta votoja dikë që është nga Lipjani, që është me integritet, që është profesionist dhe natyrisht që do t'ia zbardhte fytyrën edhe vetë Lipjanit. Por, emërimi në këso pozita të rëndësishme shtetërore, duhet të respektohen kriteret që i përcakton ligji, profesionale, të paanshme, person me integritet. Prandaj, unë besoj shumë që Kuvendi i Kosovës dje ka gabuar në mënyrën se si ka votuar. Ka gabuar për interesin publik, ka gabuar për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Dhe, këtë e them me përgjegjësi të plotë, nuk mund të qëndroj indiferent për këtë gjë.

Në anën tjetër, është e vërtetë që në Lipjan, brenda PDK-së, ekziston një grup i aktivistëve të PDK-së të cilët e përkrahin zotin Qalaj kundër strukturave aktuale atje dhe në mes, le të themi, të strukturave aktuale atje dhe kandidatëve të tjerë, atë më kanë mbështetur në zgjedhje lokale, e kanë thënë hapur. Dhe, unë ua vlerësoj këtë mbështetje. Unë e vlerësoj këtë mbështetje, sikurse është e vërtetë që zoti Rashit Qalaj ka pretendime legjitime për t'u zgjedhur kryetar i degës së PDK-së dhe që po e pengon struktura atje.

Unë e inkurajoj, e mbështes, që zoti Qalaj të mos dorëzohet, ta vazhdojë fushatën edhe atje. Por ama, kjo është e vërtetë, nuk jam duke gënjer asgjë dhe nuk po i jap asnjë konotacion, as politik. Kjo është krejtësisht e vërtetë. Dhe, këta persona përreth zotit Qalaj në zgjedhjet lokale nuk e kanë votuar kandidatin e PDK-së, por më kanë votuar mua për kryetar të komunës. Unë i falënderoj të gjithë ata që më kanë votuar, pavarësisht. E, disa prej tyre që nuk janë të njollosur, i ftoj edhe që të bashkëngjiten në Vetëvendosje atje, sepse nuk ka asgjë prej PDK-së atje, ata e dinë. Po presin në mos po kthehet Rashit Qalaj dhe organizohen, po është e pamundur që zoti Qalaj të kthehet në Lipjan. Ata e shohin si të Ferizajt.

KRYETARI: Mos jemi larguar pak prej KPK-së? Rashit, do të dalësh tash të na kallëzosh pse e ke votuar Adnanin, apo qysh?

RASHIT QALAJ: Adnan, edhe po të ishe njeriu i fundit në botë, unë jashtë subjektit tim politik nuk votoj. Absolutisht, dhe po të ishe njeriu i fundit në këtë botë. E kam votuar personin që ka qenë kandidat për kryetar, kryetarin e Partisë Demokratike në Lipjan, së bashku e familjen time.

Po, të lutem, meqenëse e di që, ndoshta me zemër jeni ende PDK, na mbështesni. Na duhet mbështetja që të dalim sa më mirë në zgjedhjet qendrore dhe lokale. E di që të ka mbetur merak,

meqenëse në zemër, prapë po them, goxha je në PDK. Adnan, nuk ka filluar kampanja ende, do t'i kemi zgjedhjet e brendshme pak më vonë. Na u bashkëngjit ekipit tim, je i mirëseardhur, kthehu në shtëpinë tënde ku ke qenë e që ende të mungon. Por, problemi është, Adnan, ti e di që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Një minutë...

RASHIT QALAJ: Arben, më fal të lutem, se... o Arben, mos na e merr, se në PDK vjen ky. Në PDK vjen, burrë, po s'mund të bëj konkurrencë tash. Kuptohet, nëse e pranojnë, e pyes Hyzerin a po të pranon a jo dhe s'është problem.

Edhe një herë, përtej kësaj, se e kemi bërë shou këtë vend, mendoj se nuk është vendi i duhur të bisedojmë për këto çështje. Ju kisha lutur të gjithëve që të jemi pak më seriozë dhe të mos etiketojmë grupet parlamentare. Këtu kemi votuar për procese të ndryshme në këtë Parlament. Në disa kemi qenë pjesëmarrës, në disa jo, por s'e kam akuzuar askënd me emër kurrë deri sot, nuk bie aq poshtë. Pra, po e përsëris, nuk bie aq poshtë, së paku kur nuk është dikush prezent në sallë. Është keq, kur e përmend dikë që nuk është në sallë, është e ulët, është e ligë. Por, ja që nuk jemi të gjithë njësoj.

KRYETARI: Ia japim fjalën Doarsa Kica-Xhelilit.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Po marr shkas prej pjesës së fundit të diskutimit të deputetit parafolës, që, meqë dje kemi hyrë në atë proces të votimit dhe dje në asnjë medium nuk keni parë aktorë tanë t'i përmendin individualisht emrat e njerëzve që janë votuar dje. Po të kthehem në retrospektivë, na kujtohet që kjo pak a shumë ka qenë logjika e politikëbërjes së mëhershme, që gjithmonë kur ka pasur aktorë që kanë kandiduar në pozicione të caktuara me afrimetet të partive politike, para se të shkohet në votime, gjithmonë ata emra janë përcmuar, nënvlerësuar e shkelur në publik.

Dhe në fakt, fakti që kjo dje nuk u bë flet shumë për opozitën e sotme, që nuk dëshiron t'i zgjedhë mjetet e njëjta përcmuese e denigruese për këta individë, që fundja janë qytetarë të kësaj Republike, t'i bëjë tema politike. Mirëpo, ky diskutim që sapo u bë, megjithëse unë do doja të mos bëhej për një temë sikurse ristrukturimi i KPK-së, nuk është të kemi as goditje nën brez nga deputetë të caktuar për diskutime private e personale, sepse këto diskutime nuk janë të karakterit politik, apo vendimmarrës në Kuvend. Po të kishim cenueshmëri të proceseve në Kuvend, ndoshta edhe do të ishte në rregull, por janë diskutime private dhe në fakt, nuk është lloj diskutimi që duhet të bëhet për këtë proces.

Por, ekziston një arsye pse ky diskutim ishte shumë i rëndësishëm dhe shpërfaqti një arsye pse ky ligj nuk duhet të votohet. Sepse, nëse ne vijmë në Kuvend dhe duhet të vendosim, nëse duhet të votohet një aktor i PDK-së, apo i VV-së, për Këshillin Prokurorial, ne problemim e kemi që në start. Beteja, sikurse e patë këtu, ishte nëse aktori që u votua është i PDK-së, apo Vetëvendosjes. Pra, në çdo variant duhej të përfundonte, të ishte, o juaji, o juaji. Në çdo variant ne duhej ta vendosnim një person me afrimetet politik, kjo ishte zgjedhja para nesh, a me PDK-në, a me VV-në? Pastaj, dikur me PDK-në, sot me VV-në, po a është kjo pyetja. A është pyetja, PDK a VV, apo është pyetja e duhet i pavarur politikisht, apo i varur politikisht?

Pra, ministre, kjo që sapo ndodhi këtu jep shumë arsye për ne për ta rikonsideruar krejt këtë projektligj, sepse nëse ende, akoma pa hyrë në fuqi një projektligj, që e bën herë tetë këtë problematik, atëherë që në start e paskemi gabim. Që në start ne po rrezikojmë, që herë tetë të jetë nesër dëmi i këtij lloj diskutimi: A është PDK, a VV? Nesër dikë tjetër! Dhe, mua, sinqerisht, as s'po më intereson a është PDK, a është VV. Mua po më intereson, dhe tash m'u dëshmuua fakti që kemi afrimetet politik. Dje e zgjodhëm dhe s'kemi ku t'i ikim tash, sepse sot na e treguat këtë çështje. Sot na e përmendët këtë temë, dje jo.

Dhe, është edhe një problem tjetër që nuk është bash-bash krejtësisht etike që kryetari i Komisionit për Legjislacion nga Lëvizja Vetëvendosje të flasë për aktorin e PDK-së, apo VV-së, sikurse të mos e keni votuar vetë. Nga opozita dje ishin rreth njëzet e pesë persona. Afër pesëdhjetë vota i ka marrë kandidati në fjalë. Njëzetepesë vota i ka pasur të Lëvizjes Vetëvendosje. Atëherë, shtroni pyetjen, pse e keni votuar? Pse e keni votuar?

Unë e kuptoj që alternativa tjetër ka qenë gruaja e një personi që flet vazhdimisht pro Lëvizjes Vetëvendosje, po pse atëherë nuk e votuat atë tjetrën? Pra, mos akuzoni sot që qenka votuar një person i PDK-së e jo i Vetëvendosjes, kur e keni votuar vetë me njëzetepesë vota, apo njëzetekatër, jo më pak, gjysma e juaj prezentë dje. Pra, kjo i bie që gjysma e Vetëvendosjes qenka e ndarë në PDK, ndryshe si ta lexojmë këtë koncept. Gjysma qenka e ndarë nga PDK-ja?!

Sidoqoftë, unë nuk pajtohem me atë që u tha më herët. Dhe, nuk e di saktë kush e tha, qëndrimi i LDK-së përkon me atë se duhet t'i lëmë gjërat si janë e të mos bëjmë asgjë. Jo, ky nuk është qëndrimi. Qëndrimi është se nuk duhet të shkatërrohet gjithçka e që mos rastësisht po del diçka. Ky është qëndrimi i LDK-së. Nuk mund të eksperimentosh me sistemin e drejtësisë e rastësisht mos po ia qëllojmë diku pak diçka. Me këtë të djeshmen dëshmohet që është huq, që po shkatërrohet, që s'është ide e mirë, që ligji do të ketë kundër efekt akoma pa hyrë në fuqi.

Për fund, nuk po e kuptoj, edhe një herë, e kam thënë disa herë, madje LDK-ja ka dalë edhe në konferencë për këtë çështje, si bre është e mundur të akuzohet një individ, apo një parti politike që ua rrëzon ligjin në Gjykatë Kushtetuese? Domethënë, ju, ose në momentin kur keni dalë në fushatë keni supozuar që e njihni Kushtetutën e vendit, keni ardhur në këtë Kuvend, jeni betuar

që do ta mbroni, po s'e keni ditur çka po betoheni, s'e keni ditur çfarë po mbroni. Nuk e kam idenë! Unë jam betuar për mbrojtje të Kushtetutës, unë jam betuar për mbrojtjen dhe Mefail Bajqinovci, natyrisht si gjithmonë që ma ndërpret fjalimin, sepse diçka të bluan brenda. Nuk e di nëse po të mungoj, që më ke pasur afër, ose jo...

KRYETARI: Zoti Bajqinovci, ju lutem, mos e ndërprisni deputeten!

DOARSA KICA-XHELILI: ...më vjen shumë keq, por tash e kemi... më vjen keq, dhe nuk jam duke biseduar me ty, jam duke mbajtur fjalën time. Dhe, në fakt, e keni një lloj principi, sa herë flas reagoni. Por, kjo flet më shumë për ju e shumë më pak për mua.

Gjykata Kushtetuese nuk rrëzon kotësi bllokuese, nuk rrëzon çështje vetëm për faktin që janë çështje të ngritura nga dikush, për të njëjtën arsye që edhe ju vetë keni fituar lëndë në Gjykatë Kushtetuese, për të njëjtën arsye që një Qeveri, që ju ka ndihmuar të vini në pushtet, në fakt, atë vendim e ka sjellë Gjykata Kushtetuese. Prandaj, ligjet nuk po ju rrëzohen sepse po i dërgojmë ne, ligjet po ju rrëzohen sepse nuk po dini t'i bëni në përputhje me Kushtetutën. Kaq e thjeshtë është kjo punë. Dhe, secilën herë që ju dilni në foltore dhe argumentoni që e kemi ne gabim dhe, ministre, the më herët të kërkojë falje për dikë, duhet të kërkonin falje ju që po insistoni që ky shtet të shndërrohet në anarki, që këtu të mos vlejë Kushtetuta dhe ligjet. Për këtë duhet të kërkojë falje ministrja e Drejtësisë, jo të kërkojnë falje që ka persona këtu që e kontrollojnë Qeverinë kur të sjellë ligje kundër kushtetuese.

Në foltore të këtij Kuvendi s'mund të dilni e të flisni qysh duhet shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës. E keni gabuar vendin. Në Parlamentin e Serbisë ndoshta! Këtë do ta thoshit ju në çdo variant tjetër, sepse kur shkelej Kushtetuta nga aktorë më parë, ju i quanit "superkriminelë", "të afërt me pushtetin e Vuçiqit...". E sot? Sot po e bëni të kundërtën!

Çka i bie kjo? Që keni ardhur në pozicionin e atyre që i keni sharë më herët, apo që realisht, krejt çfarë keni dashur është që të vini në karrige dhe të bëni atë që e kanë bërë ata më herët? Kjo nuk është në rregull dhe për KPK-në, për Këshillin Prokurorial, për Trupën Akuzuese, ku çdo ditë themi se po keqkualifikohen rastet, te prokurorët aty poshtë, nuk është problemi gjithmonë te krerët, dhe kur diskutimi vjen në pikën për të folur, a është i PDK-së, a është i Vetëvendosjes, ne e kemi huq këtë temë. Ky ligj është gabim dhe nuk guxon të votohet, sepse nuk po e dua anëtar në KPK as PDK-në, as Vetëvendosjen, as LDK-në, as AAK-në e askënd tjetër, po e dua një person të pavarur.

Po e dua një person, që nesër, larg qoftë, na ndodh dikujt diçka, të mos dyshojmë kush është aty. Ndoshta, vërtet disa persona janë të komprometuar aty, por nuk i takon ministres së Drejtësisë në mënyrë selektive të vendosë kush është e kush s'është, këtë punë nuk e ka ekzekutivi, nuk e ka

politika. Dhe, nëse reformat që synojnë të bëhen dukshëm që në start janë të dështuara, sepse ja ku e pate shembullin, Adnan versus Rashit, a PDK, a Vetëvendosje, kjo s'guxon të bëhet.

KRYETARI: Replikë, ministrja Haxhiu!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Për dallim prej zonjës Doarsa Kica-Xhelili, unë mendoj që jam një person që nuk dorëzohem lehtë, në kuptimin që nëse Kuvendi e ka bërë dje një gabim, kjo mua nuk më bën të dorëzohem që të ndal përpjekjen për të pasur reformën në Këshillin Prokurorial. Dhe, nuk më pëlqejnë njerëzit që dorëzohen lehtë. Prandaj, ju inkurajoj që të luftoni deri në fund, kur besoni që keni të drejtë. Dhe, prandaj besoj që përpjekjet e mia janë të drejta, sepse janë kërkesë qytetare, e nderuar deputete.

Zonja Doarsa Kica-Xhelili tha “po e dua një person të pavarur”. A është ai person ashtu si kryeprokurori Sylë Hoxha, ish-kryeprokurori Sylë Hoxha?

Sapo përfundoi mandatin e kryeprokurorit, u anëtarësua në LDK, a është ky personi që po e dëshiron? A është ky personi që po e dëshironi? E patët në listë për deputet, a është kështu? Po, jo. Nuk bën kështu, nuk funksionon kështu. Prokurori nuk duhet të jetë në parti politike. Edhe kur ta përfundojë mandatin, e sidomos jo menjëherë pasi ta përfundojë mandatin.

Tjetra, asnjëherë nuk kam pasur përpjekje që të kem qasje selektive te anëtarët e Këshillit Prokurorial. Mendoj se si trupë është problematike. Për të mos qenë selektivë, kemi bërë që mandati i tyre të ndërpritet me short, siç ka rekomanduar Komisioni i Venedikut. Por, këtë e keni kundërshtuar dhe kjo nuk ka kaluar, sepse Gjykata Kushtetuese e ka shpallur ligjin të pavlefshëm.

Kur përmendni anarkinë, znj. Doarsa Kica-Xhelili, uroj që dikush nga Qeveria e Serbisë nuk të ka dëgjuar, sepse ta kishte dhënë një medalje, sepse Kosova është vend që i respekton vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Nuk guxon një deputete e Kuvendit të akuzojë.

KRYETARI: Kundër-replikë, znj. Kica-Xhelili.

DOARSA KICA-XHELILI: Albulena Haxhiu,

Nuk ka person në këtë Kuvend që e ka përdorë më shumë emrin e Vuçiqit në krahasim me shqiptarët sesa Lëvizja Vetëvendosje. Nuk ka person në këtë Kuvend.

Tjetra, është e vërtetë që ti je shembull që nuk dorëzohesh, sepse as kur ia huq komplet me krejt, ti nuk dorëzohesh. Dhe për këtë, ta jap dorën ministre. Nuk kam parë në jetën time person që ti ia dëshmon huqjen dhe dështimin dhe vazhdon të mos dorëzohesh. Bravo të qoftë! Por, nëse për këtë lloj vlere ti ke shumë dëshirë, mjerë ne kush është ministre e Drejtësisë. Ta ndjesh në

kënaqësi që nuk dorëzohesh karshi budallakisë, karshi dështimit, karshi një ligji që u dëshmuar që në fakt ka kundërefekt. Ja ky është shembulli që ti e jep.

Tjetra, Kryetar, tridhjetë sekonda!

Në paskëshit mbetur t'i kapeni LDK-së kur flet veç për pensionistë, kjo flet aq shumë për ty, që s'kam nevojë as ta zgjasë më shumë.

KRYETARI: Z. Bajqinovci, replikë!

MEFAIL BAJQINOVC: M'u përmend emri dhe po dua të reagoj se nuk e pata ndërmend rreth fushatës që u habit Doarsa.

Unë e di që në fushatë gjithmonë është përmendur se qysh duhet larguar LDK-në dhe PDK-në prej pushtetit. Bile më e zëshmjja ka qenë Doarsa gjatë fushatës qysh sistemin e vjetër korruptiv kriminal t'i largojmë. Ka dalë gjithmonë kundër Arben Gashit. Arbeni dilte diçka tjetër, Doarsa dilte ndryshe. Pra, ishte me neve.

E dyta, kur jemi nëse është dikush që e ka sistemin gjyqësor dhe prokurorial në dorë, u përmendën Sylë Hoxha, zv.ministër i Drejtësisë i LDK-së, pastaj kryeprokuror i shtetit, pastaj shumë prokurorë specialë të cilët kanë qenë këshilltarë të ministrave të LDK-së e që sot janë nëpër sistem, pra punojnë në Prokurorinë e Shtetit, që s'po dua t'i përmend me emër e që i dinë edhe këta vetë.

Andaj, Doarsë, vetëm koncentrohu, na trego se çka ke folur gjatë fushatës, më brutale se ne ke qenë, kurse tash po del krejt kontra. Ndoshta ke harruar që ke kandiduar nën siglën e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Listës Guxo. Me siguri, ke harruar.

KRYETARI: Znj. Kica-Xhelili, kundër-replikë, një minutë!

DOARSA KICA-XHELILI: Obsesionimi juaj të reagoni sa herë të dalë të flas, flet shumë për juve! Flet shumë për juve, por unë kam kandiduar në Listën e Vjosa Osmanit. Pyeteni atë Listë sot pse nuk është në gjendje të gjejë guximin të reagojë për shkeljet që ia bëni sundimit të ligjit. Me dy këmbë në këtë foltore, e shkëlmi demokracinë me të dy këmbët, edhe s'ke guxim.

Më fal, unë kam kandiduar nën siglën e guximit. Atë guxim po ta dëshmoj kur nuk i jap pesë para që një grup para meje krejt çohen në këmbë, prej rendit të tretë sidomos e më lart, sa herë unë e marr fjalën. As nuk më ndalni, as nuk mund të më ndalni, as nuk e kam në plan të ndalem. Kështu që, veç ju falënderoj për fuqinë që ma jepni kur e kuptoj që reagimi juaj është fitorja jonë.

KRYETARI: E votojmë projektligjin. Uluni, ta shohim se sa deputetë jemi.

45 deputetë. As për së afërmi nuk jemi për ta bërë këtë kuorumin. Kështu që kjo kalon në seancën tjetër.

17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Administratë dhe Çështje të tjera na ka rekomanduar miratimin e projektligjit në parim.

Sot e kemi këtu për ta prezantuar këtë projektligj ministrin e Kulturës, Hajrulla Çeku. Z. Çeku, fjalë është e juaja. Urdhëroni!

MINISTRI HAJRULLA ÇEKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja ministre,

Deputetë e deputete,

Qëllimi i hartimit të këtij projektligji është harmonizimi i tij me AQUIS të Bashkimit Evropian në fushën e rregullimit të mediave audiovizive.

Me këtë projektligj përcaktohen kompetencat e Komisionit të Pavarur të Mediave në rregullimin dhe zhvillimin e një tregu të shëndoshë medial. Në këtë drejtim, në linjë me direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian, projektligji në fjalë përcakton politikat e transmetimit dhe ritransmetimit, zgjeron kompetencat e KPM-së në rregullimin, rrjedhimisht mbikëqyrjen e përmbajtjes audiovizive të paraqitura në mediat online dhe në platformat për shpërndarjen e videove.

Tutje, në linjë me direktivën, projektligji vendos standarde më të larta në çështjen e sponsorizimit, vendosjes së produktit, reklamimit në televizion e komunikimeve komerciale.

Projektligji për KPM-në zgjeron obligimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe sigurimit të qasjes së personave me aftësi të kufizuara në mediat audiovizive. Projektligji synon harmonizimin edhe me legjislacionin horizontal në Republikën e Kosovës, konkretisht harmonizimin e dispozitave ndëshkimore me Ligjin në fuqi për Kundërvajtje, dispozitat e licencimit me Ligjin përkatës për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, dispozitat e financimit me Ligjin në fuqi për Menaxhimin e Financave Publike.

Projektligji krijon shpenzime shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës, meqenëse shtimi i detyrave dhe përgjegjësisve me këtë projektligj implikon nevojën e sigurimit të resurseve adekuate njerëzore dhe financiare.

Për përgatitjen e Ligjit për KPM-në janë zhvilluar takime të vazhdueshme me Komisionin e Pavarur të Mediave.

Me qëllim të adresimit sa më të mirë të kësaj materieje, janë mbajtur edhe tryeza diskutimi me përfaqësues nga mediat, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe ju ftoj që ta miratoni!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Tani e ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Administratën Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, deputetin Valon Ramadani për ta arsyetuar raportin e komisionit.

VALON RAMADANI: Faleminderit e nderuar nënkryetare Bogujevci!

Komisioni për Administratën Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 74, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më dt. 07.02.2024, shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Faleminderit!

KRYESUESJA: A doni të deklaroheni në emër të grupit? Në rregull, e keni fjalën.

VALON RAMADANI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare Bogujevci!

Të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot jam në mënyrë të veçantë krenar që po paraqes këtu para jush një projektligj tejet të rëndësishëm dhe të nevojshëm për demokracinë, shtetin tonë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Para jush e keni Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, që sipas meje, për shtatë vjet që jam deputet, anëtar i këtij komisioni parlamentar, është i një interesi dhe i një ndershmërie të veçantë, për shkak të fushës delikate që e rregullon, pra që janë mediat ato që do të rregullohen së shpejti.

Ky projektligj pa marrë parasysh të gjitha rrethanat, konsideroj që është më i miri i kohës për fushën e vet, sepse bën rregullime të jashtëzakonshme në rëndësinë për të cilat deri më sot fatkeqësisht nuk ka pasur asnjë mekanizëm rregullativ.

Ligji mbi të cilin ka funksionuar deri më tani KPM është i vitit 2012 i cili ka qenë i bazuar në Direktivën e vitit 2010 të Bashkimit Evropian. Por, që nga ajo kohë, duke parë zhvillimin e hovshëm të teknologjisë dhe evoluimin e formave të informimit të qytetarëve, vetë BE-ja e ka zhvilluar direktivën e saj në vitin 2018 dhe pritet që të adresojë përsëri në vitin e ardhshëm.

Ne tani jemi në vitin 2024, pra veçse jemi gjashtë vite prapa krahasuar me progresin e mekanizmave rregullues që kanë ndodhur në këtë fushë në shtetet e tjera, konkretisht ato të BE-së. Andaj, është e domosdoshme që ne të kemi një ligj të tillë në vendin tonë.

Modeli i këtij ligji që sot e kemi para nesh është ai i vendeve evropiane dhe e ka të inkorporuar në vete Direktivën e vitit 2018 të BE-së. Madje, në hartimin e këtij ligji kanë qenë të përfshirë direkt dy këshilltarë evropianë që janë marrë ekskluzivisht me harmonizimin e tij me direktivën në fjalë.

Sapo ky ligj të kalojë pra, ose ky ligj kur është bërë në publik, pas kalimit të tij në Kuvend, pati mjaft kritika e reagime, e më shumë pati kritika, sepse është mirë që pati kritika, sepse kritika është ajo që e ndihmon pra dhe e përmirëson ligjin. Por, për t'u arritur te zhvillimi, kritika duhet të jetë përmbajtjesore dhe e argumentuar mirë, e mbështetur gjithashtu në fakte, assesi të jetë e mbështetur në paragjykime të atyre që as nuk mundohen ta lexojnë ligjin, ose mbase e lexojnë dhe e transmetojnë gabimisht aty me ose pa qëllim.

Është kritikuar kinse Qeveria po do t'i kapë mediat online, duke i detyruar të licencohen, duke i detyruar ato që si OJQ që regjistrohen si biznese e duke u vendosur gjoba deri në dyzet mijë euro. Që të gjitha këto janë të pavërteta dhe janë paragjykime e janë dezinformata të pastra.

Për opinionin e brendshëm ne sot këtu edhe mund t'i sqarojmë dhe do t'i sqarojmë këtu, mirëpo për këto keqinformime që po bëhen nga këto organizata të brendshme e që tashmë këto organizata kanë arritur që të shpërndahen ato lajme edhe nga organizatat ndërkombëtare. Që tashmë janë vënë në lajthitje ata dhe që kanë reaguar pa lexuar fare ose kanë bërë dezinformata të kohës.

Kush do të marrë përgjegjësi për këtë përhapje ndërkombëtare të dezinformimit? Kush do t'i sqarojë atje këto çështje? kush do të mbajë llogari për dëmin që i është shkaktuar vendit në rrethin ndërkombëtar në këto deklarime? A ka kuptim që mosdurimin tuaj ndaj Qeverisë ta ktheni në fushatë kundër Kosovës?

E vërteta për ligjin është kjo, mediat online të cilat përmbajnë dhe postojnë 'content' audiovizuel do të regjistrohen pranë KPM-së. Madje, ky regjistrim as nuk është paraparë të jetë obligativ. Pra, është lënë në dorën e tyre të vendosin nëse duan ta bëjnë këtë apo jo. Në momentin që e bëjnë këtë, ata thjesht i nënshtrohen zbatimit të Rregullores së KPM-së, të cilat për qëllim kryesor kanë mbrojtjen, integritetin dhe dinjitetin e qytetarëve, pra edhe mbrojtjen e fëmijëve.

Cilado media serioze dhe kredibile nuk e sheh fare problematike këtë, sepse e dinë që rregullimi i tillë bëhet edhe në vendet e BE-së, madje edhe ceket në Direktivën e BE-së që përmbajtja audiovizuale e mediave online duhet të rregullohet nga një organ shtetëror e që në këtë rast është KPM-ja.

Sot kemi rregullim të radiove e televizioneve nga ana e KPM-së, që asnjëherë nuk u quajt kapje e tyre nga ana e Qeverisë. Kemi një vetërregullim të mediave të shkruara, kurse sa i përket përmbajtjes audiovizuale në mediat online, nuk ka asnjë lloj rregullimi.

Mungesa e rregullit nuk është karakteristikë e njerëzve të qytetëruar dhe nuk mund të jetë prezentë në asnjë sferë të jetës së tyre, sepse rezultati është i pashmangshëm i saj e që është kaosi.

Nëse rregullimi sipas modelit evropian qenka censurë e kapje, atëherë këta që kritikojnë qenkan duke thënë se Kosova nuk duhet të shkojë drejt Evropës. Prandaj, është kaq i nevojshëm ky ligj, sepse nuk janë të rralla rastet kur në këto media kemi pamje që nuk do të duhej t'i shihnim e që nuk shihen ndonjëherë në mediat e shteteve ku tashmë ka një rregullim të tillë.

Mediat që funksionojnë si OJQ, nuk janë aspak të obliguara të regjistrohen si biznese, ashtu siç u tha, sepse nuk janë të tilla. Ato regjistrohen pranë KPM-së ashtu siç janë, pra si OJQ dhe këtu nuk ka asnjëfarë problemi tjetër.

Sa i përket gjobave, për të cilat thjesht është thënë se janë tejet të larta dhe si të tilla mund të falimentojnë mediat, duhet ditur që gjobat me ligjin aktual në fuqi janë deri në njëqind mijë euro. Për lartësinë e këtyre gjobave nuk ka pasur ndonjë ankesë deri më sot, kurse me projektligjin e propozuar, ato janë ulur në dyzet mijë euro. Pra, po kritikohet vlera dyzet mijë euro, sepse po doni që dënimet të jenë pra deri në njëqind mijë, qysh janë në ligjin aktual, apo ku e keni problemin?

Duhet ditur që këto gjoba as nuk mund të jepen pa u faktuar shkelja e as nuk janë shabllon dyzet mijë euro, por është tavan i sipërm i tyre. Ata që janë profesionalë në punën e tyre dhe që respektojnë rregullat, nuk i frikësohen e as nuk e kanë problem këtë çështjen e gjobave. Problemi në të vërtetë siç duket qëndron te regjistrimi, nuk është te gjobat. Ajo që u shkakton problem disave është rregullimi që u bën ky ligj, duke bërë të ditur burimin e financimit. Pra, përfituesi i

fundit i tyre. Një transparencë e tillë e vitalizon shoqërinë tonë, sepse është e nevojshme dhe legjitime që qytetarët ta dinë se kush i financon dhe kush është pronar i mediave në shtetin e tyre.

Është kontestuar edhe çështja e rritjes së numrit të anëtarëve të Bordit nga shtatë në njëmbëdhjetë, duke propaganduar që kjo po bëhet për kapje të këtij institucioni e rehatim të njerëzve të mazhorancës. Ky argument nuk qëndron, sepse logjika që e jep numri më i vogël i njerëzve është më lehtë i kontrolluar. Përkundrazi, rritja e numrit të anëtarëve është bërë për arsye të volumit të punës dhe janë specifikuar që katër anëtarë duhet të jenë gjithsesi pra nga katër fushat: një nga fusha e drejtësisë, një nga fusha e gazetarisë, një nga fusha e financave dhe një nga fusha e inxhinierisë së telekomunikimit.

Pra, parashihet të jetë një bord që u përgjigjet nevojave dhe kërkesave që ky institucion në raport me detyrat dhe obligimet që bien mbi të.

Përtej këtyre rregullimeve që janë kritikuar, ky projektligj ka të rregulluar edhe shumë çështje të tjera të rëndësishme që janë shfaqur dhe janë në zhvillim enorm, pra që ka pasur teknologjia e informacionit.

Përpos rregullimit e definimit të mediave online që është si risi e këtij ligji, duke u bazuar në këtë, bëhet edhe rregullimi i të gjitha formave të shërbimeve mediale të të gjitha teknologjive, pra duke përfshirë frekuencën, IPTV-në, OTT-në dhe satelitin.

Ligji gjithashtu bën definimin e kanaleve tematike, si reality-show dhe pseudo reality-show, përmbajtje këto të cilat kanë një rritje të ndjeshme dhe kanë prezencën e tyre në tregun tonë, për të cilat është e rëndësishme së veçantë që të kemi një rregullim të tillë.

Ligji edhe mund të ketë ndoshta ndonjë lëshim, nëse këto të tilla mund t'i lëshojmë dhe mund t'i rregullojmë mes dy leximeve, apo nëse e shohim që problematika shfaqen në zbatimin praktik të tij, mund të ndryshojmë përsëri, mirëpo gjithnjë duhet pasur parasysh që këto rregullime janë sipas Direktivës së Bashkimit Evropian.

E rëndësishme është që tërë fryma e këtij ligji është në drejtim të asaj që është në Direktivën e vitit 2018, pra synojmë të anëtarësohemi dhe të mbrojmë integritetin, dinjitetin e qytetarëve, mbrojtjen e fëmijëve dhe rritjen e transparencës ndaj qytetarëve, të cilëve u servohen përmbajtje mediale

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

VALON RAMADANI: Ka shumë aktorë që janë palë të rëndësishme në këtë sferë, nga KPM-ja, te mediat, nga Qeveria te Kuvendi, por pala më e rëndësishme është qytetari, sepse kur bëhen

ligjet edhe atyre u shërbejnë. Bile-bile atyre pikërisht u shërbejnë. Edhe ne që jemi këtu, prandaj duhet të punojmë, të nxjerrim ligje që janë në interes dhe në dobi të tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Nga PDK-ja është Isak Shabani.

ISAK SHABANI: E nderuar kryesuese e Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Të nderuar qytetarë,

Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave është njëri prej akteve më të rëndësishme që i propozohet këtij Kuvendi, për faktin se rregullon fushën e jetës mediale në Kosovë, i cili në shoqërinë demokratike, për shkak të rolit të tij, konsiderohet edhe si pushtet i katërt.

Një projektligj voluminoz e me shumë nene nuk është garanci se i njëjti përmirëson ambientin medial në Kosovë. Përkundrazi, cungon veprimtarinë dhe zhvillimin e mediave. Besoj se në mes të dy leximeve do të kemi mundësi t'i shprehim edhe vërejtjet e ndryshme që i ka komuniteti, por edhe ne si deputetë.

Megjithatë, sot do të theksoja shqetësimin që me këtë projektligj po zyrtarizohet edhe institucionalizohet kontrolli i mediave në vendin tonë. Qeveria në pushtet fare nuk i ka bërë përshtypje as vlerësimi negativ që Kosova ka marrë në raportin për vendin, Raportin e Progresit, ku është evidentuar qasja e papranueshme e Qeverisë në tendencat e vazhdueshme të saj për të vënë kontroll mbi mediat.

Vlerësoj se me këtë projektligj, liria e mediave nuk është avancuar, por përkundrazi është minuar dhe cunguar. Shuarja e bordit të ankesave si një trupë ankimore që ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimeve të KPM-së paraqet hap prapa në sigurinë juridike të mediave në Kosovë. Derisa, sipas ligjit në fuqi, zgjedhja e anëtarëve të Bordit për ankesa bëhet nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, në bazë të këtij projektligji, ky bord është shuar, ndërsa i është lënë KPM-së si kompetencë emërimi i një këshilli të ankesave.

Pra, me këtë projektligj organi që ka përgjegjësi shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të KPM-së do të emërohet nga vetë KPM-ja. Kjo është jo vetëm e paarsyeshme, po edhe e paligjshme, sepse ankesat e mediave ndaj vendimeve të KPM-së do të rezultojë qartazi joefektive. Si mund të pritet që organi vartës të prishë një vendim të organit epror, prandaj ky propozim është absurd dhe duhet të rishikohet patjetër.

Çështje tjetër që karakterizon këtë projektligj është edhe propozimi me të cilin synohet që videot dhe audiomaterialet e publikuara në platformat e shpërndarjes së videove dhe mediave online të kontrollohen nga Komisioni i Pavarur i Mediave? Si mund të kontrollohen këto përmbajtje, kur

të njëjtat publikohen në platformat ndërkombëtare? Pra, KPM e këtij pushtet po pretendon të disiplinojë edhe Facebook e YouTube. Kjo është skandaloze.

Çështje tjetër është edhe rritja e numrit të përbërjes së Komisionit të Pavarur i Mediave nga shtatë në njëmbëdhjetë anëtarë. Ky propozim është i paarsyetuar e që paraqet asgjë më shumë si mundësi për të punësuar militantë partiakë dhe shpenzim të buxhetit. Për faktin se ju keni propozuar që anëtarët e KPM-së të mund të shkarkohen në çdo kohë e me shumicë të thjeshtë, tregon shumë për qëllimin që ndikimi juaj në këtë institucion të garantohet. Ju nuk e doni pavarësinë e këtij institucioni, prandaj nuk keni propozuar prag më të lartë për shkarkimin nga ai emërim, si zakonisht ndodh për shkarkimin e anëtarëve të institucioneve kushtetuese.

KPM, në bazë të nenit 141 të Kushtetutës, është organ i pavarur që rregullon spektrin e frekuencave transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publikë e privatë, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj. Prandaj, duke u cenuar pavarësia kushtetuese e këtij institucioni, do të shkelet edhe neni 42: liria e mediave, me të cilin nen u garantohet liria dhe pluralizmi.

Konsiderojmë se me këtë projektligj, qartazi do të pengohet shpërndarja e informacionit dhe e ideve nëpërmjet mediave siç e garanton Kushtetuta. Prandaj, verifikimi paraprak i tij në Komisionin e Venedikut është i domosdoshëm.

Si grup parlamentar, kërkojmë nga Kryetari i Kuvendit dhe shumica parlamentare që ta bëjnë një gjë të tillë. Nëse janë për promovimin e lirisë së medias, të fjalës së lirë, atëherë dërgimi në Komisionin e Venedikut mund ta arsyetojmë. Në të kundërtën, e konfirmoni qasjen e deritanishme armiqësore ndaj mediave dhe tregut medial në vendin tonë.

Për këto dhe arsye të tjera ne si grup parlamentar këtë projektligj e kundërshtojmë dhe nuk do ta mbështesim asesi. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Nga Lidhja Demokratike, a do ta marrë fjalën dikush? Tash vazhdojmë me deputetët sipas radhës. Fjalën e ka Nijazi Isaku.

NIJAZI ISAKU: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Sot po diskutojmë një nga projektligjet më të rëndësishme në të cilën po zhvillojmë tutje një nga standardet më të rëndësishme të demokracisë. Pra, po shqyrtojmë Projektligjin për KPM-së, si rregullator që ka për detyrë të sigurojë që në mënyrë ligjore, të drejtë dhe korrekte të gjithë

transmetuesit medialë, duke përfshirë edhe atë online, respektojnë standardet e përcaktuara me kornizën ligjore të aplikueshme, e që besoj që jemi dakord të reflektojmë vlerat më të larta të shoqërive demokratike.

Më lejoni që me këtë rast të shpreh përkrahjen time për këtë projektligj dhe po ashtu të kërkoj edhe mbështetjen tuaj.

Unë jam i bindur që ka edhe shumë arsye të tjera pse ky projektligj meriton përkrahjen tonë, por ndër të tjera, unë do t'i radhis disa. Është në përputhje me Direktivën e BE-së, përkatësisht Direktivën AVMS/2018, ashtu si edhe me legjislacionin e BE-së. Projektligji, për dallim nga ai aktual që mbështetet në Direktivën e BE-së të vitin 2010, reflekton zhvillimet e reja dhe teknologjike dhe vendos një standard më të lartë në këtë fushë, vendos rregulla të qarta mbi transparencën e punës së KPM-së, me çka ngushton hapësirën për veprime eventuale të padrejta apo arbitrare të vetëm KPM-së si institucion rregullativ. Mbledhja e KPM-së duhet të jenë të hapura dhe publike.

Në përputhje me procedurat në fuqi, i sigurohet qasje e papenguar në dokumente, përderisa KPM ka detyrim ligjor t'i publikojë në ueb-faqe të gjitha lejet, vendimet a aktet nënligjore të nxjerra prej saj. Me këtë projektligj, KPM krahas promovimit të lirisë së shprehjes dhe ruajtjes së pavarësisë editoriale për informim të drejtë dhe objektiv, ka autorizimin dhe detyrën që të kujdeset për të parandaluar monopolin medial dhe të vendosë standarde në lidhje me pluralizmin dhe diversitetin e mediave.

KPM themelon fond të veçantë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbështetjen e programeve mediatike dhe mediave të licencuara apo të regjistruara në përputhje me parimet e këtij ligji në fushën e edukimit, demokracisë, arteve, sporteve dhe ekonomisë.

Projektligji përmes KPM-së siguron që publiku është i informuar mbi ngjarjet me interes të veçantë. KPM e përpilon një listë të ngjarjeve të caktuara kombëtare a jokombëtare, të cilat i konsideron me rëndësi të madhe për shoqërinë, rregullon edhe tregun e mediave online, duke u dhënë përgjegjësi editoriale platformave që shpërndajnë video e që u mungon aktualisht.

Politika e transmetimit promovon transmetimin e programeve vendore me karakter edukativ, arsimor e kulturor, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë. Siguron zbatimin e dispozitave të cilat parandalojnë diskriminimin dhe monopolizimin e transmetimit në Kosovë dhe siguron konkurrencë të drejtë për ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale.

Projektligji i përshtatet edhe zhvillimeve të reja teknologjike, duke i dhënë përgjegjësi KPM-së për pajisje me leje dhe licenca transmetuesit të këtij lloji, krijon bazën ligjore për të vendosur mbi standardet definimit tematik e transmetuesve, kanalet tematike, 'reality-show' e të tjera.

Krijon bazën ligjore që KPM të vendosë rregullat, standardet dhe procedurat mbi burimin e financimit dhe përfituesve vendorë të subjekteve që aplikojnë për leje.

Po ashtu, edhe mbi ndryshimet e pronësisë mbi dhjetë për qind. Krijohet regjistrimi i shërbimeve mediale audiovizuale online. Rregullohet çështja e ristransmetimeve nga shtetet e tjera në territorin e Kosovës. Themelohet Këshillin i ankesave, si një mekanizëm që siguron palët që trajtimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin dhe rregullat në fuqi. Vendos rregulla strikte për dhënien e lejeve televizive, duke siguruar vendime të drejta dhe objektive. Në mënyrë specifike, rregullon të gjitha format e reklamimit, duke mundësuar konkurrencë të drejtë dhe qëndrueshmëri financiare për mediat. Ndoshta, më e rëndësishmja, ka një kujdes të veçantë për të mbrojtur mediat nga ana e shërbimeve mediale audio dhe audiovizive si dhe siguron qasje të personave me aftësi të kufizuar në mediat audiovizive.

Të nderuar deputetë,

Duke u mbështetur në këto pika dhe duke e ditur rëndësinë që ka fusha e mediave, ju ftoj që ta votoni këtë projektligj.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Besim Muzaqi me kartelë të Sali Zybës.

BESIM MUZAQI: Faleminderit për fjalën e nderuar nënkryetare!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave i cili po shqyrtohet sot në lexim të parë është një ndër kërkesat ligjore, e cila përveç që është domosdoshmëri e kohës, është edhe kërkesë e përsëritur e partnerëve tanë ndërkombëtarë, konkretisht e Komisionit Evropian në raportet për vendin të vitet 2019, 2020 dhe 2021.

Qëllimi i këtij projektligji është harmonizimi i tij me AQUIS të Bashkimit Evropian në fushën e rregullimit të mediave audiovizuale, gjegjësisht përafrimi me Direktivën 2018/1808 EU.

Me këtë projektligj përcaktohen kompetencat e Komisioni të Pavarur të Mediave në rregullimin dhe zhvillimin e një tregu të shëndoshë medial. Në këtë drejtim, në linjë me direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian, projektligji në fjalë përcakton politikat e transmetimit dhe ristransmetimit, zgjeron kompetencat e KPM-së në rregullimin, rrjedhimisht mbikëqyrjen e përmbajtjes audiovizuale të paraqitura në mediat online dhe në platformat për shpërndarje të videove.

Në linjë me direktivën, projektligji vendos standarde më të larta në çështjet e sponsorizimit, vendosjes së produktit, reklamimit në televizion dhe komunikimeve komerciale. Duke shfrytëzuar rekomandimet e Komisionit Evropian, i cili thekson se ligji aktual nuk adreson një

kompetencë të mjaftueshme për licencim dhe monitorim të shërbimeve mediatike audiovizuale online, projektligji e ka adresuar këtë problematikë. Megjithatë, në projektligj nuk është propozuar licencimi i mediave online të cilat shpërndajnë ‘content’ audio dhe audiovizuel, por vetëm regjistrim i tyre.

Pra, ky ndryshim ka të bëjë me regjistrimin e platformave për shpërndarje të videomaterialeve të KPM-ja, madje edhe kjo është lënë në vullnetin e lirë të tyre.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se mediave online deri më tani u është lejuar të funksionojnë pa regjistrim në KPM apo kudo tjetër, pra pa pasur asnjë lloj rregullimi.

Ky projektligj sjell një ndryshim thelbësor, duke i obliguar ato media të cilat regjistrohen me vullnetin e tyre të plotë që të respektojnë rregullat e përcaktuara nga KPM-ja, duke garantuar një përdorim të përgjegjshëm dhe etik në shërbimet mediale, si dhe mbrojtje të qytetarëve, në veçanti të fëmijëve. Pra, vendoset dhe bëhet një rregullim i mirëfilltë dhe për mediat online me përmbajtje audiovizuale.

Projektligji adreson edhe një çështje tejet të rëndësishme me qëllim të përcaktimit të standardeve në lidhje me pluralizmin dhe diversitetin e medias dhe transparencën për pronësinë e medias. Pastaj, përcaktimin e rregullave të cilat parandalojnë koncentrimin e pronësisë në media, parandalimin e monopolit në tregun medial dhe ruajtjen e pavarësisë editoriale.

Të licencuarit dhe të regjistruarit në ligjin e ri duhet t’i nënshtrohen rregullave të përcaktuara nga KPM për parandalimin e koncentrimit të mediave. Pra, nëpërmjet këtij ligji kemi një qasje të qartë dhe transparente që obligon platformat të deklarojnë publikisht pronarët e tyre dhe të shmanget mundësia e koncentrimit të pronësisë në disa subjekte, duke garantuar kështu një konkurrencë të shëndoshë dhe të drejtë.

Ligji i hap rrugë konkurrencës së shëndoshë dhe askush nuk do të ndihet i cenuar.

Projektligji adreson edhe një çështje tjetër mjaft të rëndësishme që ka të bëjë me ruajtjen e shëndetit të qytetarëve nga reklamimet e promovimet e produkteve medicinale. Pra, me ligjin e ri do të ndalohet teleshopingu për produktet mjekësore, të cilat i nënshtrohet autorizimit për marketing sipas legjislacionit në fuqi për produktet dhe pajisjet medicinale dhe teleshopingu për trajtim mjekësor.

Gjithashtu, projektligji adreson edhe kontrollin e nevojshëm për mbrojtjen sidomos të të miturve nga reklamimi dhe teleshopingu i alkoolit, pijeve alkoolike dhe produkteve të duhanit, përfshirë edhe ato elektronike.

Projektligji për KPM-në është një hap i rëndësishëm drejt një mjedisi mediatik më të përgjegjshëm, të ndershëm dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e republikës. Andaj, ftoj secilin deputet që ta mbështesë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESJA: Nuk kemi deputetë të tjerë të paraqitur për fjalë. Gjithashtu, nuk e kemi kuorumin për vendimmarrje, kështu që kjo pikë trajtohet në seancën e radhës.

18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-277 për sport

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë e Sportit që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJRULLA ÇEKU: Faleminderit zonja nënkryetare!

Deputetë, deputete,

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës së re ligjore që e rregullon dhe fuqizon politikën sportive në vendin tonë, në fund të vitit të kaluar, në Qeveri kemi miratuar Projektligjin për sportin.

Siç e dini, ligji aktual në fuqi i sportit është hartuar në vitin 2003, dhe ka përjetuar disa ndryshime në vitet 2012 dhe 2019. Me zhvillimin që sporti ka përjetuar në njëzet vitet e fundit, duke përfshirë ndërkombëtarizimin e sportit, rezultatet sportive, ndryshimet e politikave sportive në nivel të Bashkimit Evropian dhe atë global, njëkohësisht kanë ndryshuar edhe nevojat dhe kërkesat e komunitetit sportive vendor për zhvillim.

Hartimi i një ligji të ri i cili mundëson zhvillimin e mëtejshëm të sportit në përputhje me nevojat e komunitetit vendor dhe në linjë me standardet ndërkombëtare, ka qenë më se i nevojshëm për sportin tonë.

Të nderuar deputetë,

Me këtë ligj përcaktohet dallimi ndërmjet sportistit profesionist, amator dhe atij rekreacional. Për herë të parë bëhet diferencimi ndërmjet sportit profesional dhe aktivitetit fizik.

Ligji rregullon qartë kushtet dhe kriteret që duhet plotësuar për zhvillimin e veprimtarisë së trajnerit, instruktorit, agjentit sportiv, si dhe të gjithë individëve të tjerë që janë pjesëmarrës në sistemin sportiv profesional.

Për sa i përket qeverisjes dhe mekanizmave vendimmarrës, organizatat qendrore sportive mbeten shtylla kryesore e menaxhimit të sportit në Kosovë.

Me këtë projektligj fuqizohet roli i tyre në vendimmarrje, si dhe rregullohet funksionimi efikas, duke lehtësuar procedurat burokratike dhe administrative, të cilat i përcakton ligji aktual në fuqi.

Projektligji rregullon edhe financimin e qëndrueshëm të organizatave sportive në vend, duke propozuar forma dhe kanale të reja të financimit për operim dhe zhvillim.

Në aspektin organizativ institucional, projektligji propozon themelimin e mekanizmave të rinj të cilët kanë për qëllim ndarjen e përgjegjësiave përbrenda eko-sistemit sportiv vendor, si dhe fuqizimin e rolit për secilin institucion në veçanti. Krahas kësaj, reforma institucionale parasheh themelimin e Agjencisë së Sportit, Inspektoratit të Sportit, Këshillit Shtetëror të Sportit, si dhe krijimin e Regjistrimit Shtetëror për Sport, ose digjitalizimin e sistemit të të dhënave.

Në këtë projektligj adreson edhe të drejtat e ish-sportistëve dhe trajnerëve, të cilët kanë ofruar kontributin e tyre në fushën e sportit gjatë periudhës së okupimit. Po ashtu, për herë të parë po rregullohet me kornizë ligjore planifikimi, investimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës sportive në vendin tonë.

Kosova tashmë është mikpritëse e Lojërave Mesdhetare 2030. Përmes kësaj reforme po e fuqizojmë sektorin e sportit, në mënyrë që në vitin 2030 të shpalosim potencialin e vendit tonë për të bërë punë të mëdha që kontribuojnë në mirëqenien tonë shoqërore.

Ky projektligj që kemi sot para nesh është hartuar shumë afër me komunitetin sportiv. Në këtë proces kanë qenë të përfshirë ekspertë ndërkombëtarë të fushës së sportit, ekspertë vendorë po ashtu nga sektorë të ndryshëm.

Janë zhvilluar konsultime publike me shumë organizata dhe institucione relevante me sportin, ndërsa grupi punues ka punuar krah për krah edhe me Komitetin Olimpik edhe me federatat sportive.

Dua të falënderoj të gjitha institucionet dhe organizatat sportive për punën dhe angazhimin e bërë drejt hartimit të reformës më të thellë ligjore në sektorin e sportit. Faleminderit dhe ju ftoj për miratim!

KRYESUESJA: Tani ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, deputetin Ardian Gola për ta arsyetuar raportin e komisionit.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, nënkryetare!

Më 8 shkurt të këtij viti, Komisioni për Arsim, në bazë të nenit 29, 30 dhe 74, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 08/L-277 për sport, dhe ka vlerësuar se

ky ligj i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 71 të Rregullores së Kuvendit, dhe i rekomandon këtij institucioni që ta miratojë në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Tani është deklarimi në emër të grupeve parlamentare. Nga Lëvizja Vetëvendosje është Arijeta Rexhepi.

ARIJETA REXHEPI: Faleminderit, nënkryetare!

Sporti luan një rol jetik jo vetëm në shëndetin dhe kondicionin individual, por edhe për formësimin e shoqërisë në përgjithësi.

Mund të përmirësojë mirëqenien e përgjithshme dhe të ndihmojë në tejkalimin e çështjeve më të gjëra shoqërore, si: racizmi, përjashtimi social dhe pabarazia gjinore.

Më e rëndësishmja, sporti ofron përfitime të rëndësishme në të gjithë vendin dhe është një mjet i rëndësishëm për marrëdhëniet e jashtme përmes diplomacisë si një shtytës kyç i politikave në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke marrë gjithashtu në konsideratë çështje të tilla si: arsimit, ekonomia, kultura, shëndeti dhe punësimi.

Aktualisht kuadri ligjor i sportit është ai vitit 2003, ku në ndërkohë është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2012 dhe në vitin 2019. Ndryshimet dhe plotësimet e bëra përgjatë këtyre viteve ishin të kufizuara dhe nuk adresonin kërkesat e kohës dhe ndryshimet e ndodhura përgjatë ndërkombëtarizimit.

Gjatë zbatimit të Ligjit të sportit janë evidentuar paqartësi ligjore dhe boshllëqe ligjore, në kuptim të përmbajtjes dhe procedurave të cilat janë adresuar edhe në koncept-dokumentin për sportin të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2022.

Ndër të tjera, projektligji ka përcaktuar kompetenca për të gjitha institucionet të cilat ndërlidhen me krijimin e infrastrukturës së sportit, financimin e sportit si dhe me zhvillimin e sportit në një ambient të sigurt.

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është në vazhdimësi e përkushtuar për të përmirësuar kornizën ligjore, si dhe siguruar zbatimin e dispozitave dhe rregullave të përcaktuara me Ligjin për sport, dhe të ndërlidhura me legjislacionin përkatës në fuqi.

Elementet kryesore të Projektligjit për sport kanë për synim të adresojnë çështje si në vijim: përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi për institucionet, organizatat dhe personat juridikë dhe fizikë në sport. Ministria do të jetë institucioni kryesor përgjegjës për hartimin e politikave dhe

legjislacionit në fushën e sportit, si dhe për realizimin e investimeve infrastrukturore siç përcaktohet me projektligj.

Agjencia për Sport do të jetë autoriteti kryesor për promovimin, zhvillimin e sportit në bashkëpunim me organizata e sportit, federatat sportive, federatat dhe shoqatat shumë-sportive dhe pjesëmarrësit e tjerë në sport, duke përfshirë zhvillimin e procedurës administrative të lejimit të ushtrimit të veprimtarisë të federatave sportive.

Po ashtu do të ofrojë mbështetje financiare për sportin e organizuar dhe aktivitetin fizik. Agjencia do t'i monitorojë rregullisht zbatimin e Strategjisë së sportit dhe si dhe raporton në ministrinë përgjegjëse për sport dhe autoritetet e tjera përkatëse për progresin e arritur.

Gjithashtu, agjencia do të kryej funksione të tjera të përcaktuara me projektligj.

Inspektorati i Sportit do të jetë përgjegjës për kryerjen e inspektimeve për të gjithë pjesëmarrësit në sport, përfshirë edhe njësitë përkatëse të mekanizmave institucionale në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë projektligj.

Organizatat e sportit do të kenë pavarësinë e plotë të garantuar me Ligjin për sport, Ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare dhe Ligji për shoqëri tregtare, ku të njëjtat kanë të drejtën e vetë-rregullimit, duke respektuar parimet dhe standardet e qeverisjes së mirë, transparencës dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Këshilli Shtetëror për Sport si organ këshillues me ekspertizë profesionale në fushën e sportit, do të mundësojë t'i adresojë sfidat e paraqitura nga institucionet dhe organizata në fushën e sportit dhe i njëjti do të shërbejë në mes të organizatave të përfshira në sport dhe mekanizmave institucionale për të adresuar sfidat e sektorit.

Krijimi i një ambienti të sigurt dhe promovimi i sportit do të sjellë përfitime shumëdimensionale nga ato ekonomike deri në shëndetin mendor dhe fizik. Kësisoj padyshim që vitet në vijim do të rezultojnë me ngritjen e numrit të personave që merren me sport dhe aktivitet fizik, e si rrjedhojë synimi është masiviteti në njërën anë, por edhe zhvillimi dhe ngritja e cilësisë së sportit elitare.

Gjithashtu, në këtë projektligj rregullohen edhe të drejtat e ish-sportistëve dhe trajnerëve kontributdhënës në fushën e sportit gjatë periudhës së okupimit, të cilët do të kenë të drejtë për kompensim financiar për kontributin e tyre.

Kosova ka fituar të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare që do të mbahen në Kosovë në vitin 2030. Organizimi i këtyre garave kërkon një kornizë të qartë ligjore për mekanizmat e

përfshirë në sport. Projektligji adreson mangësitë ligjore të identifikuara dhe ngrit nivelin e përgjegjësisë në zbatimin e kërkesave ligjore në sport.

Prandaj, duke e pasur në vëmendje kapacitetin e jashtëzakonshëm, talentet e sportistëve e të sportistëve tanë, nevoja për reformë legjislative, miratimi i projektligji do të jetë një ndihmesë e fuqishme në krijimin e një baze të mirë ligjore drejt një ambienti me mundësi të pafundme për zhvillim të jetës sportive.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, ju ftoj ta votoni këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë, ju që jeni të pranishëm,

Ligji për sport po na vjen pa strategjinë për sportin, ndërkohë infrastruktura sportive e mbuluar nga balta dhe bllokim të investimeve në infrastrukturë sportive ndër vite.

Stadiumi “Adem Jashari” do të duhet të përfundonte në vitin 2021, kontrata e nënshkruar në vitin 2019. Stadiumi nacional do të duhej të përfundonte në vitin 2022, projekt i gatshëm vetëm për të vazhduar punën. Stadiumi i Suharekës, i Gjilanit, i Pejës, i Ferizajt, i Podujevës do të duhej të përfundonin në vitin, gjithashtu, 2022.

Kur unë kam kërkuar llogari përmes pyetjeve parlamentare për bllokim të investimeve në infrastrukturën sportive, e mbaj mend që ministri i Sportit ishte përgjigjur: “Por, së pari duhet, tha, Strategjia, pastaj investimet dhe ligji”. Tani, ligji erdhi, por Strategjia për sportin nuk është.

Tri vjet bllokadë të investimeve në sport, dhe pyes, a është e mundur që një leje ndërtimore për renovim të stadiumit “Adem Jashari” zgjat tre vjet? Pse u bllokuan investimet në stadiumin nacional? Fizibiliteti i përfunduar, projekti në detaje i prezantuar. Për inate politike është bllokuar edhe ky projekt.

Stadiumi “Fadil Vokrri” emrin e legjendës që e mbanë, është shkatërruar dhe për fat të keq gjendja e tij dhe fushës në të cilën luanin ikonat e futbollit tonë, u bë lajm ndërkombëtar jo për kualitetin e tij, por për baltën që ishte në stadium.

Tani t’i kthehemi projektligjit me të cilin krijohen disa institucione të reja e që interferojnë drejtpërdrejt në departamentet ekzistuese të Ministrisë së Sportit, e ka përzierje kompetencash mes tyre. Fillimisht, përkufizimet e këtij projektligji. Ky Projektligj për sportin i ka të rregulluara vetëm 7 përkufizime. Nëse e lexoni ligjin paraprak që e patëm për Komisionin e Mediave, ai i kishte 46 përkufizime, po në Ligj për sportin ndonëse përcaktohen pjesëmarrësit në sport, nuk ka

përkufizime as për sportin se çka është sporti, as çka është objekti sportiv, as çka është trajneri sportiv, as kush është sportisti, as kish janë shoqatat sportive, as kush janë klubet sportive.

S'ka përkufizime për to, qysh nuk ka përkufizim as për federatat, as për KOK-un, as për Agjencinë Anti-Doping, as për Agjencinë e Sportit që pretendohet të krijohet, as ky farë Inspektorati i Sportit, çka është ky, çfarë roli ka, dhe as përkufizime të tjera që e definojnë saktë çështjen e pronësisë së objekteve sportive.

Në nenin 5 të ligjit, te ligjshmëria dhe qeverisja e mirë, pra, kemi tejkallim të Kodit Penal të Kosovës, mosrespektim të tij, sepse te kriteret e ligjshmërisë te qeverisja e mirë dhe te pajtueshmëria për të qenë në udhëheqje të federatave sportive, duhet të respektohet Kodi Penal i Kosovës.

Me ligj duhet të përcaktohen udhëheqësit e federatave sportive dhe udhëheqësit e KOK-ut, a janë persona zyrtarë? A e përfaqësojnë ata zyrtarisht shtetin e Kosovës përmes sportit? Me ligj përcaktohet se kemi vetëm një Komitete Olimpik dhe vetëm nga një federatë sportive për çdo sport. Atëherë, kemi të bëjmë me përfaqësim zyrtar të shtetit të Kosovës.

Prandaj, me ligj duhet të përcaktohet se komiteti olimpik dhe federatat bëjnë përfaqësim zyrtar të shtetit të Kosovës, dhe këta udhëheqësit e federatave dhe të KOK-ut janë persona zyrtarë që i nënshtrohen legjislacionit vendor, sepse kështu janë edhe përfaqësuesit e organizatave sportive ndërkombëtare, të gjithë i nënshtrohen legjislacionit vendor.

Po e marrë shembull, në status të FIFA-s dhe të UEFA-s është e saktësuar se regjistrohen në bazë të ligjit të Zvicrës dhe i nënshtrohet ligjit zviceran. Kush ka pasur mundësi ka mundur ta vërej që kjo çështje ka qenë temë diskutimi edhe gjatë pandemisë.

Në paragrafin 2 të nenit 19 kemi thënë se federatat sportivet përmbajnë emrin Kosovë në emërtim e saj dhe ka logon në përputhje me identitetin e Republikës së Kosovës dhe të sportit përkatës. Atëherë, paragrafi 1 duhet të ndryshohet dhe të plotësohet dhe të saktësohet se Komiteti Olimpik, federatat sportive regjistrohen sipas Ligjit të OJQ-ve dhe përfaqësojnë zyrtarisht Republikën e Kosovës.

Te kontrolli mjekësor ka një degradim. Ishte kriter që çdo gjashtë muaj sportistët të kontrollohen, tash kjo çështje bartet në kompetencën e federatave. Dhe, duke e parë organizimin e disa prej tyre, atëherë kjo normë duhet të rikthehet, duhet të jetë kriter ligjor, kontrole sistematike mjekësore çdo gjashtë muaj para fillimit sezonal. Kjo duhet të jetë normë për të mbrojtur shëndetin e sportistëve.

Pastaj njohja e certifikatës mjekësore të një shtetit tjetër mund të dëmtojë klubet tona, sepse duhet të jetë obligative që certifikata mjekësore të lëshohet në Kosovë për çdo sportist të huaj, i cili vjen për të zhvilluar aktivitet sportiv këtu, sepse me një certifikatë nga cilido vend i botës mund ta dëmtojë klubin.

Keni parë që në arenat ndërkombëtare dhe në vende të tjera, marrëveshjet mes sportistëve janë valide vetëm pasi të kalon kontrollim mjekësor në klubin përkatës ose në vendin përkatës.

Te regjistrimi i klubeve sportive, ato regjistrohen edhe si OJQ edhe si organizata tregtare, por duhet të kemi klasifikimin që kemi klube publike, kemi klube private edhe mund të ketë edhe klube publiko-private për të zhvilluar interesin e zhvillimit të sportit.

Te qendrat sportive të fitnesit duhet të obligohet dhe të saktësohet saktë me ligj, me normë ligjore që çdo qendër fitnesi duhet ta ketë dhomën mjekësore për ofrimin e ndihmës së parë, dhe kjo duhet të rregullohet me ligj, të mos lihet në dëshirën dhe vullnetin e të tjerëve.

Te neni 27, organizimi për mbrojtjen dhe avokimin për të drejtat e sportistëve dhe të personave të përfshirë në sport, duhet të përmirësohet dhe rregullohet. Duhet të jetë normë ligjore përfshirja në kuvendet e federatave sportive dhe në Komitet Olimpik përfaqësimi i sportistëve aktive, sepse ata janë bartësit kryesorë të aktivitetit.

Po e marrë shembull, nëse në statutin e universiteteve publike, përfaqësimi i studentëve është afër 15%, të paktën të bëhet kriter dhe normë ligjore që sportistët të jenë të përfaqësuar në organet vendimmarrëse të KOK-ut dhe federatave sportive me 10%. Dikush duhet ta mbrojë interesin e tyre në organet vendimmarrëse dhe jo kështu siç është.

Dhe te kodi i qeverisjes së mirë, pra, duhet të saktësohet pajtueshmëria se në federata nuk mund të ketë persona ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë. Nëse ajo lejohet me vendim të formës së prerë, kjo i bie që në krye të federatave mund të qëndrojnë njerëz të korruptuar, ata të akuzuar për drogë, për fajde, për prostitucion edhe të vazhdojnë ta përfaqësojnë zyrtarisht shtetin e Kosovës. Kjo duhet të plotësohet dhe të ndryshohet.

Te siguria e garave sportive do të duhej që ex officio Policia e Kosovës, garat me interes nacional t'i sigurojë dhe kjo duhet të jetë normë ligjore, ndërsa për sigurinë shtesë duhet të paguhet ose policia ose institucionet e tjera që ofrojnë shërbime të tilla.

Dhe, tek institucionet e reja të cilat parashihen me këtë ligj. Pra, do të duhej që ta ndalim vëmendjen për këtë. Por, para se të diskutojmë për këtë, te siguria e garave sportive, më lejoni...Kryetare, nëse mundem edhe pastaj edhe në emrin tim, po e vazhdoj edhe tre minuta?

KRYESUESJA: Mund të vazhdoni, i nderuar deputet.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Te garat sportive dhe siguria e garave sportive. Sportistët, trajnerët, pronarët e klubeve i paguajnë shtetin të Kosovës tatim. Atëherë, është e palogjikshme që për një siguri zyrtare të një aktiviteti sportiv të paguajnë tash edhe policinë e Kosovës shtesë.

Pse paguajnë ata atëherë tatim në pagë? Pse paguan tatim në TVSH një pronar i klubit, e pastaj duhet ta paguajë edhe Policinë e Kosovës që t'ia sigurojë ndeshjen. Për garat sportive të cilat organizohen nga federatat përkatëse, policia e Kosovës duhet ta bëjë sigurimin ex officio sipas detyrës zyrtare, ndërsa nëse ka nevojë për siguri shtesë, atëherë ato duhet të mbulohen nga organizatori.

Agjencitë e reja të cilat krijohen, ose të them më mirë, institucionet e reja të cilat krijohen; Agjencia e Sportit merr kompetenca të Ministrisë së Sportit, merr kompetenca të departamenteve që ekzistojnë në kuadër të Ministrisë së Sportit. Inspektorati i Sportit, gjithashtu, një trup që krijohet brenda ministrisë, e që në fakt ndërhyjnë në punët e departamentit të sportit. Këshilli për Sport, ai mund të jetë organ në kuadër të Zyrës së ministrit, ta këshillojë ministrin, por të përzihet në politikat e departamenteve brenda ministrisë, kjo është ndërhyrje e drejtpërdrejt.

Pra, këto janë organe të reja që me këtë ligj marrin kompetenca të departamenteve të Ministrisë së Sportit, dhe kjo nuk po bëhet për të përmirësuar situatën në sport, por më shumë, të themi, për të punësuar militantë politikë përmes këtyre organizatave të reja apo organeve të reja të cilat krijohen në kuadër të ministrisë.

Tek të drejtat e ish-sportistëve dhe trajnerëve janë anashkaluar kontribuuesit e tjerë, ata që kanë mbajtur klubet, që kanë punuar në administratë të tyre, në federata edhe në KOK. Ata kanë sakrifikuar për të mirëmbajtur sportin gjatë viteve të '90-ta.

Me këtë ligj parashihet ama nuk saktësohet se si do të kompensohen, po përmenden shprehimisht pa e ditur se si do të kompensohen, porse janë harruar donatorët e sportit, ata të cilët e mbajtën sportin gjallë viteve të '90-ta. As donatorët, as aktivistët e tjerë sportivë, vetëm për sportistët dhe për trajnerët, dhe kjo duhet të përmirësohet.

Pastaj periudha e caktuar data 23 mars 1989, duhet të rivlerësohet. Ka sportistë dhe trajnerë të cilët janë përjashtuar nga ish-sistemi për shkak të qëndrimeve politike edhe para kësaj date. Edhe ata duhet të përfshihen.

Tek infrastruktura sportive. Pra, licencimin për gara ndërkombëtare e bëjnë institucionet përkatëse të institucioneve sportive ndërkombëtare. Por, duhet një kujdes më i veçantë për infrastrukturën sportive për garat vendore, e cila nuk është në gjendje të mirë.

Pra, ne do të duhej të kishim ose një akt nënligjor për të rregulluar mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukturës sportive dhe kriteret për licencimin e tyre, që të paktën të përfshiheshin në ligj kriteret minimale.

Dhe, Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është çështje shumë e rëndësishme në veçanti të kontestet të cilat janë mes klubeve, federatave e aktorëve të tjerë. Dhe, duhet të saktësohet me ligj që vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv janë obligative për klubet, federatën dhe vet KOK-un. Pastaj, ata mund të vazhdojnë ankesat e tyre e në KAS, por vendimet e institucionit të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv që është pjesë, normë ligjore, duhet të jetë obligative zbatimi i tyre dhe respektimi i atyre vendimeve, sepse atëherë pse ekziston Këshilli i Arbitrazhit Sportiv, pse ekziston Gjykata e Arbitrazhit Sportiv nëse vendimet e saj nuk i zbatojnë federata?

Dhe, kjo duhet të jetë pjesë e normave ligjore dhe statuteve të federatave, që ato obligohen ta kenë në statutet dhe rregulloret e tyre edhe respektimin e Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv të Republikës së Kosovës. Dhe, e zbatojnë dhe e respektojnë këtë vendim. Janë të pakënaqur, mund të vazhdojnë pastaj në KAS çështjen e tyre.

Dhe, në fund mund të themi që ky ligj ka për qëllim që përmes disa organeve të reja që formohen t'i punësojë disa militantë politikë, porse nuk ka ndonjë vizion për ta zhvilluar sportin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Grupet e tjera parlamentare nuk i kemi këtu. Tash është radha e deputetëve. Fjalën e ka Mirlinda Tishukaj-Sadiku.

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

Përshëndetje për ministrin,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës,

Për kohëzgjatë në mbledhjen e fundit të Komisionit për Menaxhim të Financave Publike e kishim në diskutim raportin e auditimit të performancës, i cili përshkruan gjendjen më së mirë që e ka përshkruar gjendjen gjatë viteve 2017 deri në vitin 2019 se çfarë ka ndodhur me stadiumin “Adem Jashari” në Mitrovicë, çfarë ka ndodhur me stadiumin e Gjilanit, si dhe po ashtu edhe stadiumin e Gjakovës.

E keni të konfirmuar në raport të auditorit, i cili është publikuar në shtator, nëse s'gaboju, të vitit 2023.

Shumë qartë është thënë që ato stadiume nuk kanë pasur projekt. Nuk kanë qenë parcelat e shpronësuar. Nuk kanë pasur as reflektim buxhetor. Prandaj, më lejoni t'ju them se me angazhimin e plotë të ministrit, zotit Çeku, është zhbllokuar ky proces, duke bërë reflektim buxhetor, duke bërë një projekt ashtu siç duhet, e sidomos për stadiumin "Adem Jashari", ku është një stadium që duhet t'i plotësojë nevojat, sepse edhe ashtu Republika e Kosovës ka marrë obligim që në vitin 2030 t'i organizojë Lojërat Mesdhetare.

Prandaj, ju përgëzoj ministër për angazhimin për zhbllokimin e këtij procesi, jo vetëm të stadiumit të Mitrovicës, por edhe të Gjilanit, edhe të Gjakovës edhe gjithandej Kosovës. Sepse, tekefundit ato janë taksa të qytetarëve dhe duhet t'u shërbejnë qytetarëve.

Siç e thashë edhe më herët, është fakt që Kosova ka fituar të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare, të cilat do të mbahen në vitin 2023, dhe organizimi i këtyre garave kushtimisht e kërkon edhe kornizën ligjore për mekanizmat të cilët duhet të përfshihen në sport.

Më lejoni t'ju them se aktiviteti fizik është një nevojë e natyrshme e njeriut, por edhe e domosdoshme, sepse ndihmon edhe në ruajtjen e shëndetit dhe përmirësimin e shëndetit. Nuk është e tepërt të thuhet se sot 1/3 e popullsisë së botës nuk i plotësohen kriteret minimale të rekomanduara për kryerjen e aktiviteteve fizike të nevojshme për ruajtjen e shëndetit, siç është rasti me adoleshentët, ku kjo përqindje madje është edhe në nivelin 80%.

Rëndësia e këtij problemi reflektohet në faktin se kemi aktivitete të pamjaftueshëm fizik që është fakt i katërt, faktor i katërt për vdekshmërinë e përgjithshme në botë, që vijnë nga presioni i lartë arterial, rritja e indit dhjedor, e që kushtimisht ndikon edhe te nivelet e larta glukozës.

Por, edhe Kosova nuk është kursyer nga ky trend. Ekziston një hulumtim ku e dokumenton shumë qartë se fëmijët tanë kanë predispozita të rritjes së indit dhjedor.

Prandaj, më gëzon fakti që fokusi i kësaj i Qeverie, i Qeverisë Kurti, dhe po ashtu edhe i ministrit, ka bërë që Kosova me plot të drejtë, Kosovën ta bëjë edhe si shtet të xhudos. Kanë organizuar edhe aktivitete sportive, siç është aktiviteti me "Skijim drejt malit", ku kanë marrë pjesë një numër i madh i komunave në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë, e që kushtimisht u ofron mundësi fëmijëve tanë që ta mësojnë skijimin.

Është shumë e rëndësishme të thuhet se më gëzon fakti që këtij ligji i është dhënë një rëndësi e veçantë dhe në brendësi të tij për herë të parë po trajtohen dinjitetshëm sportdashësit dhe individët të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në vitet e '90-ta për ta mbajtur gjallë sportin kosovar.

Sepse, në atë kohë nuk u sfiduar vetëm arsimit edhe mbase edhe jeta jonë, mirëpo u sfidua edhe sporti.

Një aspekt tjetër i cili është elaboruar bukur shumë në këtë projektligj, është edhe dimensionimi i objekteve dhe shfrytëzimi i objekteve sportive. Forma më e mirë e menaxhimit të tyre tash mbetet edhe është në dorën tonë që nëpërmjet propozimit të amendamenteve të ndryshme nga ana e deputetëve, si të bëhet mbikëqyrja institucionale e stadioneve dhe po ashtu e palestrave sportive.

Jemi dëshmitarë që ka investime të shumta ndër vite. E kam përmendur edhe më herët, siç është rasti i palestrës sportive të Istogut, e cila zgjat mbase më shumë se 15 vjet dhe sot e kësaj dite është dashur prapë që ministri, zoti Çeku të intervenojë me buxhet shtesë, sepse atje nuk ka mundësi të zhvillohen as gara, as trajnime.

Njëjtë e kemi rastin edhe me stadiumin “Shahin Haxhiislami”, i cili është nisur me vite të tëra edhe ka pasur probleme të ndryshme.

Ministër, në kuadër të këtij ligji parashihet, siç e tha edhe kolegja Arijeta, edhe themelimi i Agjencisë së Sportit që ka një karakter ekzekutiv, dhe mendoj që për shkak se është një agjenci ekzekutive, forma e auditimit e paraparë duhet të jetë në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit për arsye se neni 18, ku e specifikon mandatin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, paragrafi 2, qartë e specifikon që çdo agjenci që merr buxhet nga Republika e Kosovës e ka obligim edhe mandat që të bëjë auditimin. Mendoj që është e udhës të trajtohet një dimension i tillë.

Një çështje me rëndësi të cilën e kam analizuar ka qenë edhe në ligjin paraprak. Ka të bëjë, ministër, me shpërblimet të cilat i fitojnë sportistët në kampionate. Janë ranguar që shpërblimet do t’ju takojnë sportistëve që marrin pjesë në gara evropiane dhe botërore, mirëpo nuk është cekur edhe kampionatet ballkanike, Lojërat Mesdhetare dhe kampionatet e tjera.

Tash, me ligjin paraprak kanë qenë të theksuara, por nëse keni mundësi të na e jepni një sqarim.

Një çështje tjetër, është paraparë në këtë ligj edhe Federata e Sportit Shkollor dhe Federata e Sportit Universitar. E keni cekur që kjo parashihet për arsimin parauniversitar dhe universitar, mirëpo ekzistojnë shkolla të shumta që janë edhe në sektorin privat. Përpos asaj publike, ekzistojnë edhe ato private.

Domethënë, a do të inkorporohen në këtë federatë me të drejta të plota, sikurse ata të sektorit publiku, kjo është te neni 31, paragrafi 1.3.

Po ashtu është edhe pezullimi dhe revokimi i lejimit të ushtrimit të veprimtarisë së federatës së sportit përkatës. Është cekur se nëse klubet sportive vazhdimisht dështojnë të raportojnë raportet financiare, unë mendoj, ministër, besoj që do të jap kontribut edhe gjatë dy leximeve, që duhet të saktësohet a është një vit ose 2 vjet radhazi.

Nëse nuk dështon një klub të raportojë për raporte financiare, duhet saktësuar periudha, sepse mendoj që lë një hapësirë apo ndoshta do ta adresoni edhe me akte të tjera nënligjore.

Këto ishin ato që pata t'i them. Përkundrazi, ju përgëzoi për punën, angazhimin edhe i keni dhënë një qasje jashtëzakonisht të mirë sportit, aktivitetit fizik edhe mbështetjes edhe financiare, siç është dëshmuar edhe me ndarjet në kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Shpresoj edhe uroj shumë që stadiumi olimpik “Adem Jashari” ta marrë një epilog, po ashtu edhe stadiumet e tjera, sepse janë një domosdoshmëri e kohës për gjeneratat e reja, por po ashtu edhe për të gjitha strukturat e shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Bekim Haxhiu ka kërkuar replikë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Unë prita që duke i dëgjuar shpeshherë prononcimet e ministrit, që ministri të na e sqarojë, sepse është arsytuar që vonesa e investimeve në stadiumin “Adem Jashari” ka ndodhur për shkak të lejes ose shpronësimit.

Për të gjithë ata të cilët janë laik në këtë fushë, stadiumi olimpik “Adem Jashari”, toka e tij për herë të parë është shpronësuar në vitin 1976. I është marrë familjes së Bajram Prekazit dhe familjes Nuka me zor nga pushtetet e atëhershme. Është shpronësua njëherë ajo.

Në vitin 2014, para ndeshjes së parë Kosova-Haiti, ndeshjes së parë miqësore, stadiumi olimpik “Adem Jashari” është shpallë me interes nacional dhe ka kaluar me vendim qeveritar në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këto nuk kanë qenë pengesa.

Tash, për ta bllokuar këtë proces është thënë që s’paska pasur leje ndërtimore, por projekti është renovimi i stadiumit olimpik “Adem Jashari”. Pra, kemi pasur të bëjmë me renovim, jo me ndërtim të ri të një objekti sportiv.

Dhe, bllokatat për objektet e tjera sportive, përfshirë edhe atë të Gjilanit, ku rritet shuma investive, por zvogëlohen ulëset e stadiumit. Pra, nuk po shohim për rritje të kapaciteteve, dhe njëjtë për stadiumin në Gjakovë, ku 3 vjet i janë nevojitur ministrisë që të vendos që ta shkëpusë kontratën me një operator ekonomik të papërgjegjshëm.

Këto janë vonesa, ku 3 vjet infrastruktura sportive, e në veçanti “Adem Jashari” ngjasonte në Kandahar. Ajo ka qenë për turp, dhe tani kjo nuk është për mburrje pse ka rifilluar, por duhet kritikuar pse është vonuar, sepse do të duhej të përfundonte në vitin 2021, me projekte buxhetore, të gjitha e kanë pasur kodin buxhetor.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, Mirlinda Tishukaj-Sadiku!

MIRLINDA TISHUKAJ-SADIKU: Unë nuk jam laike në këtë fushë të paktën, mirëpo kam të drejt t’i besoj një agjencioni kushtetues, i cili e ka konfirmuar me argumentet të metat, mangësitë të cilat kanë ndodhur në këto tri stadiume.

Më lejoni të them që ka pasur tejkalime të kontratës deri në masën 755%, që është në kundërshtim me Ligjin e prokurimit, te stadiumi i Gjilanit. Te stadiumi i Gjakovës ka pasur ndryshim të kategorisë, prej kategorisë 2 kanë tentuar ta dërgojnë në kategorinë 4, në kundërshtim të plotë me procedurat edhe doracakun qysh e kërkon UEFA.

Por, unë kam të drejtë t’i besoj këtij raporti të auditorit. Ne e kemi diskutuar edhe në komisionin, mirëpo në detaje e kam referuar edhe për seancë edhe atëherë i sheh të metat, mangësitë të cilat i ka trashëguar ministri Çeku, edhe është angazhuar që të zhbllkohet ky proces, sepse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Nuk kemi deputetë të tjerë të paraqitur për fjalë. Gjithashtu, nuk kemi kuorum për vendimmarrje. Sa i përket pikës së radhës, është votim i fshehtë, kështu që nuk kemi kushte për të proceduar tutje. Këto pika barten në seancën e radhës. Shihemi më 17 Shkurt për Ditën e Pavarësisë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*